

REAGIMI NDAJ RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE



DORACAK PËR NËNPUNËSIT E SHËRBIMEVE SOCIALE

Reagimi ndaj rasteve të Dhunës në Familje

DORACAK PËR ZYRTARËT E SHËRBIMEVE SOCIALE

MIRËNJOHJE

Doracaku është fryt i punës ekipore të Seksionit të Mbrojtjes dhe Mbështetjes së Viktimave në kuadër të Departamentit të të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të Ligjit të Misionit të OSBE-së në Kosovë.

PËRPILUESIT :

Selvete Gërxhaliu, Anton Hookes, Alma Begicevic, Anette Sikka.

KOMENTET E PRANUARA NGA :

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Departamenti i Mirëqenies Sociale, Zyra e UNICEF-it në Kosovë, Asociacioni i Hulumtimit dhe Avokimit të Trajnimit Social (ASTRA)

SHKURTESAT

DR	Drejtuesi i rastit
KEGjFDKG	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Gruas
QPS	Qendra për Punë Sociale, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
DHF	Dhuna familjare
DD	Departamenti i Drejtësisë, shtylla I, UNMIK
DMS	Departamenti i Mirëqenies Sociale, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
DPTHDV	Deklarata për Parimet Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Shpërdorimit të Pushtetit
KEDNj	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
OK	Organi i Kujdestarisë
MNDPC	Marrëveshja Ndërkombëtare për të Drejtat Politike dhe Civile
UMPE	Urdhëresë për Mbrojtje të Përkohshme Emergjente
OJQL	Organizata joqeveritare lokale
LMS	Ligji për mbrojtje sociale
LMMF	Ligji për Martesën dhe Marrëdhëniet Familjare
LSHSF	Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare
LSNS	Ligji për Skemën e Ndihmës Sociale
LPP	Ligji për Procedurën Përmbartimore
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
OJQ	Organizata joqeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
KPPK	Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës
KPPPK	Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës
IPVQ	Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes
UM	Urdhëresë për Mbrojtje
UME	Urdhëresë për Mbrojtje Emergjente
OSHS	Oficeri i Shërbimeve Sociale – që punojnë në QPS
ZS	Zyrtar Social
UE	Udhëheqësi i ekipit , Shërbimet Sociale të QPS-së
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
DUDNj	Deklarata Univerzale për të Drejtat e Njeriut
AV	Avokuesi i Viktimave
NjMNV	Njësia për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, Departamenti i Drejtësisë

Reagimi ndaj rasteve të dhunës në familje – Doracak për zyrtarët e shërbimeve sociale

Parathënie	9
1 Hyrje	9
1.1 Sfondi i botimit	9
1.2 Doracaku dhe qëllimi i tij	9
1.3 Përmbajtja e këtij doracaku	9
2 Dukuria e dhunës në familje	13
2.1 Përkufizimi i dhunës familjare	13
2.1.1 Llojet e dhunës familjare	13
2.1.1.1 Keqtrajtimi fizik	13
2.1.1.2 Keqtrajtimi seksual	13
2.1.1.3 Keqtrajtimi emocional dhe psikologjik	14
2.1.1.4 Izolimi	14
2.1.1.5 Keqpërdorimi ekonomik	14
2.1.2 Modelet e përshkallëzimit të dhunës	14
2.2 Treguesit e dhunës në familje të viktimave	15
2.2.1 Treguesit fizikë të dhunës në familje	15
2.2.2 Treguesit emocionalë të dhunës familjare	15
2.2.3 Treguesit e sjelljes të dhunës familjare	16
2.3 Dhuna familjare – kërkimi i kornizës konceptuale	16
2.3.1 Kosova përmes perspektivës ekologjike	16
2.4 Faktorët e rrezikut personal që mund t'i kontribuojnë dhunës në familje	17
2.5 Gratë dhe dhuna në familje: Pse është vështirë të zhduket dhuna?	17
2.6 Efektet e dhunës familjare tek fëmijët	18
3 Ligjet që ndërlidhet me rastet e dhunës familjare	23
3.1 Të drejtat e njeriut në Kosovë	23
3.2 Ligjet vendëse që janë të zbatueshme në lëmin e dhunës familjare	24
3.3 Detyrimet e ZSHS-ve në bazë të ligjeve vendëse	24
3.3.1 Ligji për mbrojtjen sociale (LMS)	25
3.3.2 Ligji mbi martesën dhe marrëdhëniet familjare (LMMF)	26
3.3.3 Rregullorja e UNMIK-ut 2003/12	27
3.3.4 Kodi i Procedurës Penale (KPP) dhe Kodi i Përkohshëm i procedurës Penale (KPPP)	30
3.3.5 Ligji për shërbimet sociale dhe familjare	31
3.4 Mekanizmat ligjorë për zbatimin e vendimeve	31
4. Mënyra e menaxhimit të rasteve dhe ndërhyrjeve në rastet e dhunës familjare	35
4.1 Korniza e menaxhimit të rastit	35
4.2 Planifikimi operativ i menaxhimit të rastit në rastet e DHF-së	36
4.2.1 Qëllimet e ndërhyrjes	37
4.2.2 Koordinimi dhe monitorimi i sistemit	37
4.2.3 Raportimi vjetor	38
5. Zgjidhja i rasteve individuale	41
5.1 Shqetësimet fillestare	41
5.2 Kontaktet fillestare me viktimën e DHF-së	41
5.3 Raporti për dhunën familjare	42
5.4 Drejtuesi i rastit / Plani i shërbimit	42
5.5 Strehimi	43
5.6 Urdhëresa për mbrojtje	43
5.7 Vlerësimi i rrezikut	43
5.8 Planifikimi i sigurisë	43
5.9 Vlerësimi i mundësisë për vetëvrasje	44
5.10 Qasja në mekanizmat e drejtësisë	44
5.11 Ndihma materiale	44
5.12 Këshillimi	44
5.13 Intervenimet emergjente/në kohë krizash	45
6. Udhëzues i punuar sipas praktikave të mira	49
6.1 Çështjet e sigurisë për zyrtarët socialë	49
6.2 Mbikëqyrja e rastit	49
6.3 Regjistrimi i të dhënave	49
6.3.1 Konfidencialiteti dhe çështjet private	49
6.3.2 Marrja me rastet e ndërlikuara	50
6.4 Aplikimi në gjykata për Urdhëresë për mbrojtje	50
6.5 Dhënia e dëshmisë në gjyq	50
6.6 Kryesimi i mbledhjeve	50
7. Ndërtimi i reagimit ndërinstytucional	55
7.1 Parimet e reagimit ndërinstytucional të dhunës në familje	55
7.2 Forumet për DHF-së	55
7.3 Puna e madhe në rastet individuale	56
Shtojcat	
Shtojca 1 Pyetjet dhe mjetet e intervistimit	59
Shtojca 2 Mitet dhe faktet mbi dhunën në familje	81
Shtojca 3 Rregullorja e UNMIK-ut 2003/12 mbi mbrojtjen kundër dhunës në familje	85
Shtojca 4 Format e Urdhëresave për mbrojtje	101
Shtojca 5 Pyetjet për vlerësimin e rrezikshmërisë	129
Shtojca 6 Planifikimi i sigurisë	133

PARATHËNIE

DORACAK PËR NËNPUNËSIT E SHËRBIMEVE SOCIALE

OSCE

Organization for Security and Co-operation in Europe



Ministry of Social Services of Kosovo

Prishtinë, 2008

Parathënie

Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale (MPMS) – Departamenti për Mirëqenie Sociale (DMS) ofron siguri për të gjithë pjesëtarët e komuniteteve në mënyrë që ata të jetojnë në mjedis të sigurt dhe të mbrojtur.

Ky doracak ofron informacione lidhur me reagimin ndaj rasteve të dhunës në familje dhe është përpiluar që të krijojë një proces që duhet të ndiqet nga MPMS-ja gjegjësisht nga DMS-ja dhe Qendrat për Punë Sociale (QPS) të Kosovës, lidhur me të gjitha rastet e dhunës në familje.

I tërë procesi i planifikimit, vendimmarrjes dhe zbatimit duhet të formulohet sipas nevojave të klientit dhe progresit të bërë sipas shkallëzimit kohor i cili i pasqyron ato nevoja.

1. Hyrje

1.1. Sfondi i botimit

Çdo shtet duhet ta luftojë me këmbëngulje dhunën në familje, pavarësisht nga besimet tradicionale dhe kultura. MPMS-ja (DMS-ja) e vërteton plotësisht këtë pikëpamje dhe pret nga profesionistët e vet që të punojnë në përputhje me rrethanat e dhëna.

1.2 Doracaku dhe qëllimi i tij

Shërbimi social është një shërbim profesional dhe i orientuar që si qëllim të vetin kryesor e ka ofrimin e ndihmës personave me nevoja sociale të përkohshme apo të përhershme, qoftë për shkak të shqetësimit financiar ose psikologjik apo të çfarëdo lloji tjetër të padrejtësisë sociale. Zyrtari i shërbimeve sociale (ZSHS) do të jetë profesionist dhe i suksesshëm në punë në QPS në qoftë se është në gjendje të bashkëveprojë me klientë, me të dyja palët d.m.th. me viktimën dhe keqtrajtuesin, gjithnjë duke garantuar sigurinë dhe mirëqenien e viktimës si prioritet më të lartë. Gjithashtu duhet të jetë në gjendje të kuptojë ndikimin afatshkurtër dhe afatgjatë të veprimeve të dhunës në familje dhe rreziqet fizike e psikologjike që i imponohen viktimës dhe fëmijëve të saj.

MPMS-ja e di se një sistem i integruar dhe gjithëpërfshirës për mbrojtjen e viktimave nuk mund të krijohet brenda nate. Ekzistojnë disa faktorë, ata qeveritarë dhe joqeveritarë që ndikojnë në arritjen e nevojave të viktimës së dhunës në familje. Shërbimet e ofruara viktimës apo keqbërësit të DHF humbin efektshmërinë nëse bëhen nga organizatat individuale; kjo gjë arrihet vetëm me bashkëpunim midis agjencive. Prandaj, doracaku u jep përkrahje punëtorëve socialë të krijojnë qasje të rehabilitimit në bashkësi, në vend të reagimit si organe individuale.

Të gjitha veprimet dhe shërbimet e ndërmarra nga institucionet dhe organizatat joqeveritarë duhet të bazohen në:

- Të Drejtat e Njeriut;
- Normat Ligjore;
- Ligjshmëritë, e përcaktuara nga rregullat dhe rregulloret e MPMS-së.

Në kuadër të doracakut gjendet edhe analiza e plotë e ligjeve të aplikueshme të Kosovës, rregulloret e UNMIK-ut, ligjeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë këtu lidhshmërinë e tyre në përgjegjësitë dhe obligimet e një zyrtari social modern.

Njohja e ligjit gjatë punës që lidhet me parametrat profesionalë të zyrtarit social së bashku me ecurinë e dhunës në familje, udhëzuesin praktik për intervenim dhe udhëzuesin për mbështetjen e viktimave dhe familjet e tyre janë thelbësore për rezultat më të mirë në punë.

1.3. Përmbajtja e këtij doracaku

Doracaku paraqet përvojën e ZSHS-ve dhe aftësitë profesionale të mbrojtësve profesionistë të viktimave, gjyqtarëve, policisë, dhe OJQ-ve në Kosovë dhe begaton këto njohuri me materiale dhe qasje të mbështetura nga bashkësia ndërkombëtare. Në kuadër të tekstit do të ketë koncepte që mund të jenë risi për ZSHS-të. Doracaku mëton të jetë gjithëpërfshirës, por njëkohësisht edhe i

kuptueshëm për t'u zbatuar, mjet praktik për të gjithë ZSHS-të që punojnë me viktimat e dhunës në familje.

Me qëllim të përshtatjes së njohurive dhe kërkesave kryesore të praktikës në fushën e punës sociale dhe varësisht nga sfidat e veçanta të punës me persona që përjetojnë dhunë në familje, doracaku është ndarë në dy pjesë:

- **Njohuri teorike**
- **Njohuri praktike**

Shtatë kapituj dhe gjashtë shtojca:

- **Dukuria e dhunës në familje**
- **Ligji mbi rastet e dhunës në familje**
- **Shërbimet sociale dhe dhuna në familje**
- **Mënyra e menaxhimit të rasteve dhe ndërhyrjeve në rastet e dhunës në familje**
- **Trajtimi i rasteve individuale**
- **Udhëzime të praktikës së mirë për punëtorët socialë**
- **Ndërtimi i reagimit nga shumë agjenci**
- **Shtojcat**

Shtojca 1: Pyetjet dhe mjetet për intervistim

Shtojca 2: Mitet dhe faktet për dhunën në familje

Shtojca 3: Rregullorja e UNMIK-ut nr 2003/12 mbi mbrojtjen kundër dhunës në familje

Shtojca 4: Format e urdhëresave për mbrojtje

Shtojca 5: Pyetjet që ndihmojnë vlerësimin e rrezikut

Shtojca 6 : Planifikimi i sigurisë

DUKURIA E DHUNËS NË FAMILJE

DORACAK PËR NËNPUNËSIT E SHËRBIMEVE SOCIALE



Organization for Security and Co-operation in Europe



Ministry of Social Services

Prishtinë, 2008

2. Dukuria e dhunës në familje

2.1 Përkufizimi i dhunës familjare

Dhuna familjare është një akt i keqtrajtimit fizik, seksual ose psikologjik të një anëtari të familjes nga një anëtar tjetër me qëllim të kontrollimit. Anëtarët e familjes përfshijnë dy persona që janë fejuar ose martuar njëri me tjetrin, që janë duke bashkëjetuar me njëri-tjetrin pa qenë të martuar, persona që kanë familjen parësore të përbashkët dhe që kanë lidhje gjaku, martesë ose adoptimi ose janë në marrëdhënie të përkujdesjes duke përfshirë prindërit, gjyshërit, fëmijët, nipat e mbesat, vëllezërit e motrat, hallat, axhët, nipat nga motrat, ose kushërinjtë; ose dy persona të cilët janë prindër të një fëmije të përbashkët.¹ Ky keqtrajtim brenda familjes e dëmton mirëqenien psikologjike, sociale, ekonomike, seksuale dhe psikike të viktimës.

2.1.1 Llojet e dhunës familjare

Në shumicën e rasteve, keqtrajtuesi është anëtar mashkull i familjes, kurse viktimja është femër. Në një numër të vogël të rasteve keqtrajtuesi është raportuar të ketë qenë kunat ose vjehërr, shumë më rrallë keqtrajtuese është bashkëshortja.

Ka disa forma të manifestimit të dhunës familjare (DhF), dhe ato zakonisht mund të jenë:

- keqtrajtim fizik;
- keqtrajtim seksual;
- keqtrajtim emocional dhe psikologjik;
- izolim;
- keqpërdorim ekonomik.

2.1.1.1 Keqtrajtimi fizik

Keqtrajtimi fizik nënkupton dhunën fizike jo të rastit e cila është kryer nga keqpërdoruesi. Keqtrajtimi fizik përfshin shkaktimin e lëndimeve trupore, qoftë të lehta ose të rënda, si dhe çdo lëndim fizik i cili mund t'i shkaktojë viktimës frikë për mirëqenie fizike. Ka keqtrajtim fizik edhe kur dikush detyrohet me forcë të largohet nga vendbanimi i vet. Keqtrajtimi fizik përfshin sjelljet e tilla si shtyrje, rrahje me shuplakë, me dorë, me këmbë, kafshim, përdorja e veglave ose armëve, si dhe veprime të tjera të cilat kanë për pasojë frikën, lëndimin ose vdekjen. Është një model i rëndomtë që në rastet e dhunës fizike në familje, keqpërdorimi vetëm sa bëhet më i rëndë dhe shtohet në marrëdhëniet familjare.

2.1.1.2 Keqtrajtimi seksual

Keqtrajtimi seksual do të thotë ndeshje seksuale pa pëlqim ose ndeshjet në familje kur dikush është ose nën trysni, (të shprehur ose të nënkuptuar), ose detyrohet për veprim seksual. Nëse njëri nga personat është nën moshën 16-vjeçare ose midis 16 e 18-vjeçare ose fëmijë, bir për shpirt, thjeshtër, nip ose mbesë prej motre i personit tjetër, gjithmonë merret me mend se ai ose ajo nuk mund të japë pëlqim, dhe kështu veprimi seksual përbën keqtrajtim në çdo rrethanë. Keqtrajtimi seksual përfshin sjelljet siç janë ledhatimi, felacion, ose cunnilingus, ose depërtimi anal ose vagjinal. Ai mund të përfshijë edhe shfrytëzimin duke detyruar dikë që të bëjë fotografi të natyrës seksuale(porno), ose duke e detyruar dikë për prostitucion.

Sidomos të rëndësishme për diskutimin e DhF-së është kategoria e *dhunimit me sulme fizike* si formë e dhunimit në martesë, kur lëndimi seksual kombinohet me rrahje fizike dhe keqtrajtim psikologjik. Mirëpo, ka forma të tjera të dhunës “specifike seksuale” kur lëndimi seksual nuk bëhet së bashku me lëndimin fizik, por më tepër shihet si formë parësore e detyrimit në ç’rast viktimizohet partneri. Dhuna fizike që përdoret është e tillë sa që detyron viktimën të ketë marrëdhënie seksuale, dhe duket se motivohet së pari nga dëshira për ta mbisunduar dhe kontrolluar viktimën. Në shumë raste të këtilla, vrazhdësia dhe shtrengesa mbështeten nga faktori në bindjen se ai ose ajo ka të drejtë të ketë marrëdhënie seksuale me bashkëshorten ose bashkëshortin e vet sipas kushteve që ai ose ajo i cakton vetë. Me rëndësi është të mos harrohet se pëlqimi për të pasur marrëdhënie seksuale si pasojë e frikës nga dhuna është formë e detyrimit dhe se në këto raste keqtrajtuesi konsiderohet se ka kryer akt krimi.

¹ Rregullorja e UNMIK-ut 2003/12, mbi mbrojtjen kundër dhunës në familje, (Rregullore) neni 1.1.

Poashtu është edhe një lloj tjetër i dhunimit në marrëdhëniet martesore që duhet të hetohet, në rastet kur individët me mënyrat e sjelljes së tyre devijuese bëjnë nxitjen seksuale. Kjo përfshin zakonisht seksin e sforcuar obsesiv; kur nga viktimia kërkohet të kenë një numër të jashtëzakonshëm të akteve seksuale, ose të kenë marrëdhënie seksuale si formë të sjelljes sadiste, të vrazhda ose të shfrenuara. Kështu, pa pëlqimin aktiv, akti bëhet kriminal sipas natyrës. Dhunuesi është fajtor për marrëdhënie të dhunshme seksuale kurse personi në anën tjetër të krimit është viktimia.

2.1.1.3. Keqtrajtimi emocional dhe psikologjik

Keqtrajtimi emocional mund të përkufizohet si deklaram verbal ose akt fizik që shkatërron sedrën e viktimës. Ky keqtrajtım, që manifestohet qoftë me etiketime, përqeshje, kërcënime, qoftë me forma të tjera të dhunës verbale, është formë sistematike dhe e qëllimshme e degradimit të viktimës. Partneri keqtrajtuës ushtron kontroll të fuqisë mbi viktimën e cila më vonë e humb sedrën e vet, ndihet e pasigurt por njëherësh frikësohet të jetë e braktisur, ose detyrohet të ndihet sikur e meriton atë keqtrajtım. Si pasojë e keqtrajtimit emocional të përsëritur, viktimia i nënshtrohet më vonë ndjenjës së varësisë dhe përfundimisht do të ndihet e pavlefshme.

Një formë e rëndomtë e keqtrajtimit psikologjik që duhet të ceket paraqitet në marrëdhëniet kur dhuna ka ndodhur në të kaluarën. Në këto raste, keqtrajtım emocional merr formën e kërcënimeve të përsëritura, që mund të shkaktojnë shqetësim dhe frikë të madhe. I ashtuquajtur i “shkallmim psikologjik” është tejet terrorizues sepse viktimia përjeton terror, ankth dhe pasiguri. Viktimia bëhet e paafte të parashikojë se kur mund të ndodhë dhuna, në çfarë forme, dhe nëse fare do të ndodhë. Shqetësimi i viktimës për parashikimet, që shkaktohet nga kërcënimet mund të jetë aq i mundimshëm sa edhe vetë dhuna.

2.1.1.4 Izolimi

Izolimi është karakteristik për rastet e DhF-së kur bartësit e krimit bëjnë përpjekje për t'i kontrolluar rrethanat e viktimës. Shkeljet e tilla mund të përfshijnë izolimin e viktimave nga anëtarët e familjes dhe kufizimin e lirisë së lëvizjes së saj.² Keqbërësit mund t'i kufizojnë kontaktet personale të viktimës me botën jashtë familjes, duke mos lejuar viktimën të bisedojë me dikë për problemet e keqtrajtimit duke e bërë të paafte madje edhe për ta dalluar keqtrajtımın. Me një shkallë të tillë të kontrollimit të përcaktuar nga keqtrajtuësi, ai ose ajo bëhet burim i mundshëm i ngushëllimit si dhe i poshtërimit.

2.1.1.5 Keqpërdorimi ekonomik

Po kështu, keqbërësit përveç që kontrollojnë rrethanat fizike të viktimës duke e izoluar atë nga miqtë dhe familja, ata shpesh do të gjejnë mënyra të tjera për t'ia kontrolluar paratë. Dihet që paratë i sigurojnë individit mundësi dhe pavarësi. Mohimi i qasjes në financa i jep keqbërësit më shumë mundësi të kontrollojë viktimën. Megjithatë, ky lloj i kontrollit ia largon viktimës mundësinë që të kontrollojë jetën e vet.

Meqenëse paratë dhe financat janë shpesh burim i tensioneve të përgjithshme në familje, kjo mund të shfrytëzohet nga keqbërësi si një pikë e ndezjes së dhunës. Për shembull, kur keqbërësit kontrollojnë të gjitha paratë në familje, viktimia vihet në pozitën që të detyrohet të kërkojë para për të mbajtur familjen, gjë që së pari ri-forcon mungesën e pavarësisë, dhe së dyti mund të shkaktojë konflikt të cilin keqbërësi e shtyp me dhunë.

2.1.2. Modelet e përshkallëzimit të dhunës: “Cikli i dhunës”³

Rrethanat e secilës viktimë zakonisht nuk përputhen plotësisht me grupin e kategorive të keqtrajtimit. Për shembull, ka raste kur viktimia keqtrajtohet fizikisht ose edhe seksualisht. Meqë secila gjendje e viktimës është e veçantë, kategoritë formale të keqtrajtimit mund të shihen më së miri pasi të jenë vendosur parametra të gjerë brenda të cilëve mund të kuptohet dhe përshkruhet situata e viktimës dhe nevoja e saj për ndihmë. Poashtu duhet të kihet parasysh se keqtrajtım i

² Shih Rregulloren 2003 /12 nenin 1.1(f) mbi kufizimin e paligjshëm të lirisë së lëvizjes së personit tjetër

³ Walker (1979)

viktimës rrallë mund të jetë ngjarje që ndodh “vetëm njëherë”, por më shumë është pjesë e një modeli që përsëritet në vazhdimësi.

Një metodë e rëndomtë e përshkrimit të modelit të keqtrajtimit të marrëdhënieve është “cikli i dhunës”: Së pari është një periudhë e ngritjes së tendosjes, e cila mund të përfshijë edhe keqtrajtimin verbal, keqtrajtime të vogla fizike si dhe përpjekje nga viktima që të qetësojë partnerin e vet, ndonëse rrallë me sukses. Pas kësaj shfaqet dhuna, që vijon me një periudhë të brejtjes së ndërgjegjes kur keqbërësi përpiqet të bindë viktimën për dashurinë e vet dhe premtun se nuk do të ketë telashe më tutje. Ky është një model i rëndomtë i dhunës në familje. Fatkeqësisht, është poashtu e zakonshme që viktima të ketë sulme të dhunshme të cilat bëhen më mizore në çdo cikël.

2.2 Treguesit e dhunës në familje te viktima

Ndonjëherë te viktimat mund të identifikohen dhe njihen shenjat e ndryshme të keqtrajtimit, të cilat mund të ndahen në shenja fizike, emocionale dhe psikologjike. Një zyrtar i shërbimit social (ZShS) i cili është njoftuar që një grua mund të jetë në rrezik nga DhF-ja, duhet të shikojë çdo shenjë të paraqitur me dyshim. Ai, gjithashtu është me rëndësi që t’i dallojë simptomat e tilla veç e veç në mënyrë që të depërtojë në situatën dhe të gjejë format më të mira për përkrahjen e viktimave.

2.2.1 Treguesit fizikë të dhunës në familje

shenjat fizike të keqtrajtimit mund të përfshijnë lëndime që janë të paqëllimta dhe(ose) janë shëruar dobët për shkak të mungesës së kujdesit. Llojet e rëndomta të këtyre lëndimeve janë:

- shembjet, gërvishtjet dhe gërvishtjet e vogla, si dhe ndrydhjet a përdredhjet;
- lëndimet e kokës, qafës, gjoksit;
- prerjet vetvetiu të dorës ose krahëve;
- lëndimet gjatë shtatzënësisë;
- vende të shumta të lëndimeve;
- lëndime të përsëritura ose kronike;
- dhembje kronike, dhembje psikologjike (dhimbje të shkaktuara nga ngarkesat psikologjike, zakonisht jo-specifike sipas natyrës), ose dhembje për shkak të shpërndarjes së traumave pa dëshmi fizike;
- sëmundje seksuale të bartura;
- dëmtim i organeve seksuale dhe i anusit – kjo shpesh është shenjë ose pasojë e keqtrajtimit seksual dhe e mungesës së kontrollit gjatë marrëdhënieve seksuale.

Stresi, kronik pas-traumatik, çrregullime ose depresione të tjera shqetësuese:

- çrregullim i gjumit dhe i oreksit;
- lodhje, rënie e përqendrimit;
- dhembje kronike e kokës;
- ankesa nga dhembja e stomakut dhe dhembje gastrointestinale;
- dridhje, marramendje dhe gulçim (një shqetësim jo-specifik i lëkurës, pa ndonjë shkak të qartë);
- dhembje jo-tipike e gjoksit.

2.2.2 Treguesit emocionalë të dhunës familjare

- sedër e përulur ;
- ndjenjë e izolimit dhe e pamundësisë për t’ia dalë mbanë;
- përpjekje ose gjeste për vetëvrasje;
- depresion;
- sulme panike dhe shenja të tjera shqetësuese;
- keqpërdorim i alkoolit dhe i drogës;
- reagim ose shqetësim nga stresi pas-traumatik.

2.2.3 Treguesit e sjelljes të dhunës familjare

- viktimat mund të duket e frikësuar, e turpëruar, i vë lak së vërtetës ose ndihet e zënë ngushtë;
- partneri e shoqëron viktimën, insiston që të ngelin të afërt dhe u përgjigjet të gjitha pyetjeve që i drejtohen atij;
- ngurron të flasë ose nuk pajtohet me partnerin e vet;
- ndjenjë e tepruar e përgjegjësisë personale për marrëdhënie, duke përfshirë edhe vetëfajësimin për dhunën e partnerit të vet.

2.3 Dhuna familjare – kërkimi i kornizës konceptuale

Duhet të jetë e qartë që nga fillimi kur bisedohet për karakteristikat e dhunës familjare që të kërkohen shpjegime për këtë dukuri, sepse dhuna ndaj grave ose burrave brenda marrëdhënieve familjare është e papranueshme. Pa marrë parasysh se cilat janë rrethanat; kurrë nuk ekziston gjendja që dhuna të jetë e pranueshme; nuk ka rrethana lehtësuese. Diskutimi në këtë doracak mbi shkaqet e dhunës në familje nuk është arsye për veprimet e keqtrajtimit, por më shumë qasje praktike për të kuptuar këtë dukuri në mënyrë që të punohet me keqbërësin për t'ia penguar veprimet.

Aktualisht, teoria më gjithëpërfshirëse për të kuptuar kontekstin dhe rrënjët e shkaqeve të dhunës familjare është ajo që njihet si “perspektivë ekologjike”⁴, për të cilën thuhet se është ndërveprim midis historisë personale, gjendjes sociale dhe rrethanave politike dhe kulturore që i japin mundësi keqtrajtimit, por jo thjesht vetëm njëri nga këta faktorë.

Të kuptuarit e plotë të dhunës familjare do të përfshijë marrjen parasysh të më së paku 4 faktorëve:

Së pari, ka **faktorë të rrezikut personal**, siç janë dëshmimi i dhunës familjare nga fëmija, i cili keqtrajtohet seksualisht ose mungesa e figurës së babait përgjegjës

Së dyti, ka rëndësi të vërehen **faktorët madhorë**, të cilët janë faktorë të rrethanave të keqtrajtimit në marrëdhënie me viktimën, siç janë mbizotërimi i mashkullit në marrjen e vendimeve, kontrolli ekonomik nga mashkulli, konflikti martesor dhe përdorimi i alkoolit.

Së treti, marrja parasysh e **ekzo-sistemit** do të thotë trajtimi i faktorëve brenda strukturës së institucioneve shoqërore formale dhe joformale të cilat ndikojnë në gjendjen, siç janë papunësia, izolimi shoqëror dhe shoqërimi me delinkuentë.

Së katërti, është jashtëzakonisht me rëndësi t'i kushtohet vëmendje **sistemit madhor**, grupit të gjerë të vlerave dhe besimeve kulturore që depërtojnë dhe informojnë tri shtresat e tjera të ekologjisë shoqërore dhe përfshijnë një përkufizim të njerëzimit i cili mund të përmbledhë mbisundimin dhe agresionin, aderimin në rolet tradicionale të gjinive, një kuptim i së drejtës ose i posedimit të gruas nga mashkulli, miratimi i dënimit fizik të grave dhe mbështetja kulturore e përdorimit të dhunës për t'i zgjidhur konfliktet ndër-personale.

2.3.1 Kosova përmes perspektivës ekologjike

Dhuna familjare është e pranishme në Kosovë. Në vitin 2004, në Njësinë e policisë së UNMIK-ut kundër dhunës në familje dhe QPS-të janë marrë me 223 raste. Strehimoret e rasteve të dhunës familjare janë marrë me 298 raste. Pas luftës, në vitin 2000 UNIFEM-i ka bërë një vlerësim të niveleve të dhunës që kanë pësuar gratë në Kosovë.⁵ Nga 216 gra të cilat i janë përgjigjur anketës, 23% kanë raportuar se janë keqtrajtuar brenda rrethit familjar. Grupet e diskutimit me gratë si nga vendet urbane ashtu edhe nga ato rurale kanë theksuar se dinamika e jetës familjare dhe e shoqërisë së gjerë tregojnë se një numër i rasteve kanë mbetur të pa raportuara. Vlerat kulturore ose *makro-sistemi* në Kosovë lidhet ngushtë me dinamikën e veçantë familjare ose me *mikro-sistemet* brenda marrëdhënieve, kështuqë duke i kuptuar që të dyja bashkë bëjnë të mundur që t'i kuptojmë rrënjët e shkaqeve të dhunës dhe ndihmojnë si të punohet që të zbuten këto shkaqe. Ajo që do të shtjellohet në vijim është një përpjekje për t'i kuptuar marrëdhëniet e dhunës familjare në kontekstin e Kosovës duke përdorur analizën e “perspektivës ekologjike” të theksuar më lart.

⁴ Shih për shembull Heise, L.L. (1998), Dhuna kundër grave: një kornizë ekologjike e integruar, në *Dhuna kundër grave* 4 292-290.

⁵ UNIFEM 2000 “Nuk ka vend të sigurt: një vlerësim mbi dhunën kundër grave në Kosovë”

2.4 Faktorët e rrezikut personal që mund t'i kontribuojnë dhunës në familje

Brenda kornizës së ndikimeve të jetës shoqërore, ka ndikime individuale (të veçanta,) të cilat po ashtu mund dëshmojnë të jenë faktorë që e shtojnë rrezikun e dhunës në familje. Duhet të bëhet e qartë që nga fillimi se *faktorët e rrezikut nuk janë shkaqet e dhunës në familje*, madje as që mund të përdoren për arsyetimin e dhunës. Ata e bëjnë dhunën më të mundshme për t'u paraqitur në disa rrethana prandaj këta faktorë janë të rëndësishëm që ZShS-të të bëhen të vetëdijshëm për t'i identifikuar viktimat e mundshme:

- Duke parandaluar familjen e prejardhjes për t'iu ekspozuar dhunës prindërore;
- Dhuna paraprake në marrëdhënie të tjera;
- Izolimi i viktimës nga familja dhe miqtë;
- Nivel i lartë i shprehjes së zemërimit dhe i vrazhdësisë (midis anëtarëve të familjes);
- Parashikimet jo-përkatese të fëmijëve ose të bashkëshortes/bashkëshortit;
- Përgjigje e vrazhdë ndaj stresit të vërtetë dhe të perceptuar;
- Faktorët biologjikë dhe neuro-psikologjikë, të trashëguar ose të fituar;
- Shpërdorimi i alkoolit dhe drogës.
- Përfshirja e luftës civile që përfshin vrasjen, dhunën, pastrimin etnik dhe dhunimin.

2.5 Gratë dhe dhuna familjare – pse është vështirë të zhduket dhuna?

Pyetja që shtrohet aq shpesh, “Pse ajo nuk ikën prej aty?” mbështetet në supozimin e padrejtë se ikja do t'i jepte fund dhunës. Kjo poashtu supozon se viktimat e dhunës nuk e gëzojnë drejtën të ketë shtëpinë e vet, dhe se keqbërësi ka të drejtë t'i largojë të tjerët prej aty.

Ka shumë arsye pse dikush është i shtrembë në marrëdhënie keqtrajtuese, ndonëse mund të jetë vështirë që të tjerët ta kuptojnë plotësisht për shkak se dinamika brenda marrëdhënieve është shumë më e fuqishme për ata që janë në marrëdhënie sesa për ne që mund të shohim nga jashtë. Prapëseprapë, këto dinamika janë të vërteta.

Në vijim po japim vetëm disa nga arsyet që tregojnë se sa mund të jetë e vështirë të braktiset një gjendje shkaqeshme:

- Mungesa e resurseve dhe e mbështetjes sociale janë pengesat më të rëndësishme që viktimat e gjendjes shkaqeshme të bëhet e pavarur dhe të braktisë ushtruesin e dhunës.
- Dashuria. Viktima ende mund ta dashurojë keqtrajtuesin dhe t'i kujtojë kohët e mira të marrëdhënieve të tyre.
- Shpresa. Viktima mund të shpresojë se premtimet e partnerit për të ndërprerë veprimin janë reale dhe se marrëdhëniet mund të bëhen si kanë qenë para se të fillonte dhuna.
- Turpi. Viktima mund të ndihet e turpëruar kur të dëgjojnë të tjerët se çka po ndodh në këtë marrëdhënie.
- Izolimi. Shkatërrimi i lidhjeve të dhunuesit me miqtë dhe familjen mund ta bëjë viktimën të varur ekonomikisht dhe psikologjikisht nga partneri keqtrajtues.
- Problemet praktike me rastin e braktisjes: mungesa e strehimit ose e vendit të menjëhershëm për strehim; qëndrimet e shkurtra në strehimore ku hapësira është e kufizuar — mungesa e kohës së mjaftueshme që të ndër marrë këtë hap; mungesa e ndihmës ligjore, e vendosjes, e punës, e kujdesit për fëmijën, e policisë dhe e ndihmës gjyqësore.
- Frika nga hakmarrja e sulmuesit. Më shumë viktimat të keqtrajtuara vriten derisa përpiqen të ikin nga keqbërësit e tyre sesa në çdo kohë tjetër.
- Trysni kulturore. Shumë individë u përkasin grupeve të identifikuar ose besojnë fuqishëm në disa praktika, përfshirë edhe nevojën për të mbetur në marrëdhënie martesore, pa marrë parasysh se çka ndodh. Te gratë, trysnia shpesh bëhet mbi to që të përpiqen të mbajnë familjen së bashku. Nëse nuk vepron ashtu, ose nëse ikën, mund të shkaktojnë shpërthime nga kultura.

Shumë arsye të tjera mund t'i kontribuojnë viktimës të ndihet e mashtruar në marrëdhënie dhe e paaftë “vetëm të ikën.” Për secilin individ arsyet mund të jenë të veçanta në situatat e tyre, dhe ata shpesh nuk shohin asnjë zgjidhje tjetër. Por, sa më shumë sisteme të përkrahjes që të ketë në shoqërinë tonë për t'u ndihmuar viktimave nga keqtrajtimi, aq më shumë ka të ngjarë që t'i braktisin marrëdhëniet keqtrajtuese dhe të mos kthehen.

2.6. Efektet e dhunës familjare tek fëmijët

Jeta në familjen ku mbizotëron dhuna familjare është jashtëzakonisht me strese për fëmijët. ZShS-ja duhet të jetë vigilent për të gjitha shenjat e rrezikut të cilat mund të tregojnë shqetësim, që të mund të ndërhyjnë sipas nevojës për t'i mbrojtur të gjitha viktimat e DhF-së. Të gjithë fëmijët që jetojnë në shtëpitë ku paraqitet dhuna familjare mund të ndikohen nga kjo përvojë. Fëmijët do të ndikohen në mënyra të ndryshme, në bazë të faktorëve vijues, prandaj ZShS-ja duhet të jetë i vetëdijshëm për faktorët e tillë që të punojë në mënyrë përkatëse me secilin fëmijë veç e veç. Disa nga faktorët janë:

- interpretimi i tyre i përvojës (ndikon sipas moshës);
- si janë mësuar të mbijetojnë dhe t'ia dalin me stresin;
- sa ka përkrahje (miq, farefis, të rritur të tjerë);
- mundësia e tyre për të pranuar përkrahjen dhe ndihmën nga të rriturit.

Efekti i kësaj dhune te fëmijët mund të shihet në mënyra të ndryshme. Çdo fëmijë individual mund të përjetojë diçka nga këto që vijnë, dhe ka mundësi t'i nënshtrohet vuajtjeve të ndryshme në kohë të ndryshme:

Reagimet e mundshme emocionale:

- Të ndihet fajtor/e për keqtrajtim ose pse ai nuk ndërpritet;
- Keqardhje për familjen dhe për humbjet personale;
- Konfuzion përkitazi me ndjenjat konfliktuoze midis prindërve;
- Frikë nga braktisja, nga të shprehurit e ndjenjave, nga e panjohura, ose nga lëndimi personal;
- Zemërim për dhunën dhe kaosin në jetën e anëtarëve të familjes;
- Depresion, një ndjenjë pse nuk mund të ndihmojë dhe pse i mungon fuqia;
- Keqardhje për ngjarjet dhe dinamikën e krijuar në shtëpi.

Manifestim i mundshëm kognitiv(njohës) :

- Besimi se është përgjegjës/e për dhunën;
- Fajësimi i të tjerëve për sjelljet e veta;
- Besimi se është e pranueshme të sulmohen njerëzit që kujdesen për të, vetëm që të marrë atë që do, të shprehë zemërimin e vet, të ndihet i fuqishëm, ose që t'i detyrojë të tjerët t'ia plotësojnë nevojat;
- Sedra e ulët;
- Të mos kërkojë atë që i nevojitet, e lere më atë që do;
- Mungesa e besimit;
- Bindja se të ndihesh i zemëruar është gjë e keqe, për arsye se njerëzit lëndohen;
- Stereotipat e ngurosurat se çfarë do të thotë të ishe djalë, vajzë, burrë, grua, bashkëshort, bashkëshorte;

Shenjat e sjelljes (shpesh të shikuara në skajshmëri të kundërta):

- Fëmijët mund të luajnë një rol ose të tërhiqen;
- Ata mund të arrijnë shumë ose të arrijnë shumë pak;
- Refuzimi për të shkuar në shkollë;
- Përkujdesja: më shumë brengosen për të tjerët se për vete – zëvendësimi i prindit;
- Armiqësorë ose të ngathët;
- Mbrojtje rigide (i rezervuar, sarkastik, mbrojtës, "të menduarit bardh e zi");
- Kërkojnë vëmendje të tepruar (shpesh përdorin sjellje të skajshme);
- Urinojnë në shtrat dhe kanë ankthe;
- Sjellje jashtë kontrollit, nuk janë në gjendje t'i caktojnë kufijtë e vet ose t'i ndjekin drejtimet;

Manifestimet sociale:

- Izolimi nga miqtë ose të afërmit ose përfshirja e tepruar shoqërore për të shmangur jetën në shtëpi;
- Marrëdhëniet shpesh të acaruar, fillojnë me intensitet dhe përfundojnë në mënyrë të papritur;

- Vështirësi në të besuar, posaçërisht ndaj të rriturve;
- Aftësi të dobëta të zgjidhjes së konfliktit dhe të zbutjes së zemërimit;
- Mund të jenë pasivë me shokët (kolegët), ose trembin shokët (kolegët);
- Inkuadrohen në marrëdhënie eksploatuese, qoftë si keqbërës ose si viktima;
- Loja me shokët (kolegët) bëhet jashtëzakonisht e ashpër, duke u futur në aktivitete të lojërave me rrezikshmëri të lartë.

Çrregullimet fizike:

- Ankesa somatike (trupore); kokë dhembje, dhembje të barkut);
- Nervozë, të shqetësuar dhe të papërqendruar (shumë shpesh diagnostifikohen gabimisht me çrregullime hiperaktive të mungesës së vëmendjes (Attention Deficit Hyperactivity Disorder - ADHD);
- Të lodhur, Të përgjumur;
- Shpesh të sëmurë;
- Higjienë personale të dobët;
- Ngecje në detyrat e zhvillimit (urinon në shtrat, thith gishtin e madh – varësisht nga mosha);
- Mos ndjeshmëri ndaj dhembjes;
- Lëndim i vetvetes;

LIGJET QË NDËRLIDHEN ME RASTET E DHUNËS FAMILJARE

DORACAK PËR NËNPUNËSIT E SHËRBIMEVE SOCIALE



Office for Democratic Institutions and Human Rights



Ministry of Social Services

3. Ligjet që ndërlihen me rastet e dhunës familjare

Një njohuri e hollësishme e ligjeve dhe e detyrimeve që parashihen janë me rëndësi thelbësore për QPS-të dhe ZSHS-të kur duhet t'i mbështesin interesat e viktimave të dhunës familjare. Korniza Kushtetuese e Kosovës (Korniza Kushtetuese)⁶ kërkon që institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes të veprojnë në pajtim me standardet e të drejtave të njeriut. QPS-të i takojnë kësaj kategorie, për shkak se janë pjesë e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe për këtë arsye vendimet që QPS-të i marrin duhet të jenë në pajtim me standardet për të drejtat e njeriut që parashihen për këtë gjë.

3.1 Të drejtat e njeriut në Kosovë

Korniza Kushtetuese, kreu 3 pika 3.3, thekson se të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të pranuar ndërkombëtarisht në Kosovë zbatohen drejtpërsëdrejti⁷. Kryesisht, femrat janë viktima të dhunës familjare në Kosovë.⁸ Së këndejmi, në përgjithësi, standardet e zbatueshme për të drejtat e njeriut, veçanërisht mbrojtja nga dhuna familjare, diskriminimi dhe trajtimi jo i drejtë, parashihen nga:

- *Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNj)*
- *Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Protokolleve të saj, (KEDNj)*
- *Marrëveshja Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe protokollet e saja (MNDCP);*
- *Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Gruas (KEGJFDKG)*
- *Deklarata për Parimet Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Shpërdorimit të Pushtetit (DPJV)⁹*

Me Deklaratën Universale dhe KEDNj-në ndalohet diskriminimi në baza gjinore¹⁰. DPJV-ja gjithashtu përmban një dispozitë të mos diskriminimit në nenin 3 e cila spikat të gjitha kërkesat që i ka shteti për të siguruar qasje në drejtësi, këshillimin psiko-social dhe shërbime përkrahëse, si dhe kompensimin¹¹. *KEGJFDKG-ja* parasheh që organet shtetërore të marrin përgjegjësinë për të hartuar “politikën e mënjanimit të diskriminimit ndaj gruas” përfshirë këtu edhe miratimin e dispozitave ligjore dhe marrjen e të gjitha masave të duhura në të gjitha fushat për modifikimin apo shfuqizimin e ligjeve, rregulloreve, zakoneve dhe praktikave ekzistuese të cilat diskriminojnë gratë.¹² Madje, neni 16 i *KEGJFDKG-së* thekson se shtetet janë përgjegjëse të ndërmarrin të gjitha hapat e duhur për të eliminuar diskriminimin në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet familjare dhe martesën duke siguruar barazinë e burrave dhe grave në fushat si shkurorëzimi, të drejtat e fëmijës dhe ato pronësore.

Është përgjegjësi e institucioneve të sigurojnë që në kuadër të fushave të tyre këto të drejta të njeriut që u theksuan më lart të respektohen. Çdo agjenci e IPVQ-ve dhe institucioneve të tjera kanë deleguar pushtetin për të vepruar në emër të institucioneve si agjenci qeveritare dhe për këtë arsye shfrytëzojnë përgjegjësinë e institucionit që të sigurojnë këto të drejta. Nëse IPVQ-të dështojnë që ta bëjnë një gjë të tillë atëherë ata do të veprojnë në kundërshtim me detyrimet e përcaktuara me Kushtetutë. Këto detyrime do të marrin forma përkatëse në secilin departament të IPVQ-ve në punën e tyre me gratë dhe fëmijët.

⁶ Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9, Korniza Kushtetuese e Kosovës, kreu 3, pika 3.2: Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes respektojnë dhe sigurojnë standardet e pranuar në arenën ndërkombëtare të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke përfshirë të drejtat dhe liritë që parashtrihen në

(a) Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut;
(b) Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollin e Saj;
(c) Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike të Njeriut dhe Protokollin e Saj;
(d) Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial;
(e) Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;
(f) Konventën për të Drejtat e Fëmijëve;
(g) Kartën Evropiane të Gjuhëve Rajonale dhe Minoritare dhe
(h) Konventën e Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare.

⁷ Njëllon neni 3.3.: “ të drejtat dhe liritë e parashtruara në këto instrumente zbatohen në Kosovë drejtpërsëdrejti si pjesë e kësaj Kornizë Kushtetuese.”

⁸ Për lexim të mëtejshëm për fëmijët si viktima të dhunës familjare lexo doracakun për mbrojtjen e fëmijës ku gjithashtu është e përfshirë Konventa për të drejtat e fëmijës.

⁹ Dispozitat që përfshihen në kuadër të DPJV-së janë të zbatueshme në mënyrë të tërthortë si standard i të drejtave të njeriut në kuadër të Kornizës Kushtetuese si ligj i butë edhe pse nuk citohet në mënyrë të veçantë. Lexo fusnotën 1 ku neni 3.2 thekson se “Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes respektojnë dhe sigurojnë standardet e pranuar në arenën ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

¹⁰ DUDNj neni 2 dhe neni 14 i KEDNj-së.

¹¹ Nenet 4, 14 dhe 12

¹² Shih nenin 2, KEDKG.

Në fushat e punës që mbulohe nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), kjo Ministri është përgjegjëse për sigurimin e të drejtave të paraqitura më lart në tërë Kosovën¹³, me QPS-të si agjenci implementuese në nivel komunal¹⁴, pastaj përgjegjëse për sigurimin e këtyre të drejtave në praktikë dhe në komuna¹⁵. Kjo nënkupton që në praktikë ZSHS-të duhet të sigurojnë që vendimet të mos kenë efekt diskriminues përfshirë këtu edhe faktin se duhet marrë parasysh shkaktarët themelorë të pozitës së ulët financiare dhe kulturore të gruas në shoqërinë kosovare¹⁶.

3.2 Ligjet vendëse që janë të zbatueshme në lëmin e dhunës familjare

Sistemi juridik i Kosovës ka një sërë instrumentesh të përkryera që sigurojnë mbrojtjen e individëve nga diskriminimi dhe dhuna. Dispozitat themelore që ndërlidhen me punën e ZSHS-ve përfshihen në këto dokumente :

1. *Ligji për mbrojtjen sociale*, Gazeta zyrtare 18/76. (LMS)
2. *Ligji për martesën dhe marrëdhëniet familjare*, Gazeta zyrtare 10/84, (LMMF)
3. *Rregullorja e UNMIK-ut për mbrojtjen nga dhuna familjare* (Rregullorja DHF)
4. *Kodi i përkohshëm penal*, Rregullorja e UNMIK-ut 2003/25 (KPP)
5. *Kodi i përkohshëm i procedurës penale*, Rregullorja e UNMIK-ut 2003/26 (KPPP)
6. *Ligji për shërbimin social dhe familjar*, Rregullorja e UNMIK-ut 2005/46 (LSHSF)

Krahas këtyre ligjeve ekzistojnë një numër i ligjeve të tjera që ndërlidhen kryesisht me punën e ZSHS-ve që përmbajnë procedura për administratën, procedura gjyqësore dhe mekanizma ankimore¹⁷.

3.3. Detyrimet e ZSHS-ve në bazë të ligjeve vendëse

Ekzistojnë një sërë ligjesh që qeverisin me përgjegjësinë e QPS-ve ndaj viktimave të dhunës familjare. ZSHS-të duhet t'i zbatojnë këto ligje gjatë punës së tyre në frymën e mos-diskriminimit duke marrë parasysh pozitën e gruas në Kosovë si dhe të viktimave të dhunës familjare.¹⁸

Krahas ZSHS-ve, përgjegjësinë parësore për mundësimin e qasjes në drejtësi të të gjitha viktimave të krimit dhe veçanërisht të viktimave nga dhuna me bazë gjinore e ka Njësia për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave në kuadër të Departamentit të Drejtësisë. Roli i tyre tani parashikohet me ligjin penal si përfaqësues të autorizuar të viktimave të dhunës familjare. Roli i NjMNV-së parashihet me nenin 81 dhe nenin 82 të *Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës* Rregullorja e UNMIK-ut 2003/26 (KPPP). Përfaqësuesi i NjMNV-së i Departamentit të Drejtësisë do të veprojnë si përfaqësues të DHF në bazë të nenit 206 të KPPP-së. Sa i përket ofrimit të mbrojtjes sociale, QPS-të janë përgjegjëse për t'i ndihmuar viktimat e dhunës familjare. Ligji për shërbimet sociale dhe familjare përcakton kategoritë e personave që kanë nevojë për shërbime sociale; referimi për viktimat e dhunës familjare është përcaktuar në nenin 1.3 pika 10. Dispozitat e përgjithshme të LSHSF-së theksojnë që shteti ka për detyrë t'u ofrojë shërbime sociale dhe familjare viktimave të dhunës familjare duke respektuar dinjitetin e tyre si qenie njerëzore dhe të drejtat e tyre themelore bazuar në legjislacionin kosovar dhe konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut." Përderisa QPS-të mbesin përgjegjëse për aktivitetet vepruese dhe ofrimin e ndihmës së menjëhershme, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale mbikëqyr dhe menaxhon cilësinë e punës së tyre¹⁹.

¹³ Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) është themeluar nëpërmjet shtojcës VII të Rregullores së UNMIK-ut 2001/19 mbi degën e ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë. Departamenti administrativ i shëndetësisë dhe mirëqenies sociale është themeluar nëpërmjet Rregullores së UNMIK-ut 2000/10 mbi themelimin e departamentit administrativ të shëndetësisë dhe mirëqenies sociale. Këto ligje i japin MPMS-së përmes departamentit të vet zbatues të DSHMS, pushtet për të ushtruar mbikëqyrje administrative ndaj zyrave të mirëqenies sociale.

¹⁴ Roli i QPS-së si institut i kujdestarisë shpjegohet në ligjin mbi martesën dhe marrëdhëniet familjare, neni 22 dhe ligji mbi procedurën jashtëkontestimore, neni 5.

¹⁵ Në bazë të ligjit mbi shërbimet sociale dhe familjare, neni 1.3. j i Rregullores së UNMIK-ut 2005/46 organi i kujdestarisë mbetet nën pushtetin e qendrave komunale për punë sociale që në të kundërtën paraqet organin e vetëm përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.

¹⁶ Për shembujt praktikë që sigurojnë se nuk jeni duke marrë vendime diskriminuese si ZSHS gjatë zbatimit të këtyre ligjeve ju lutemi t'i referoheni pjesës "menaxhimi i rasteve" të këtij doracak.

¹⁷ Shih për shembull: Ligjin e procedurës jashtëkontestimore (Gazeta zyrtare KSAK 42/86); Ligji mbi procedurën në administratën e përgjithshme i vitit 1986 (Gazeta zyrtare 47/86); Ligji mbi konfliktet administrative i vitit 1977 (Gazeta zyrtare RSFJ, Nr 47); Ligji mbi procedurën kontestimore (Gazeta zyrtare RSFJ 4/1977).

¹⁸ Nenet 81 dhe 82 të *Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale*, Rregullorja e UNMIK-ut 2003/26 (KPPP). Roli i Njësisë për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave pranë Departamentit të Drejtësisë tani parashihet në nenin 206 të KPPP-së si përfaqësues i autorizuar i emëruar automatikisht për viktimat e dhunës familjare. Për shembujt praktikë që sigurojnë se nuk jeni duke marrë vendime diskriminuese si ZSHS gjatë zbatimit të këtyre ligjeve ju lutemi t'i referoheni pjesës "menaxhimi i rasteve" të këtij doracak.

¹⁹ Shih LSHSF, neni 2. 2.3 mbi rolin e Ministrisë.

3.3.1 Ligji për mbrojtjen sociale (LMS)

Ligji për mbrojtjen sociale në nenin 6 përshkruan në mënyrë të përgjithshme përgjegjësinë e tërësishme të organit më të lartë të Kosovës, tani MPMS-së për mbrojtjen sociale, përfshirë këtu edhe punën e QPS-ve. Ato realizojnë veprimtari përcjellëse duke i studiuar problemet sociale, propozim planet dhe programet për zhvillimin e mbrojtjes sociale, marrin masa të kujdesit për të penguar shkaqet e rasteve të tilla sociale; përcaktojnë formën, kriteret dhe masat gjegjëse për mbrojtjen sociale të personave në kushte të çrregulluara; përcaktojnë, zhvillojnë, dhe ndërmarrin veprime përcjellëse përmes institucioneve të organizatave dhe shërbimeve të mbrojtjes sociale. Ligji për shërbimet sociale dhe familjare, në nenin 2 shpjegon rolin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale si dhe në nenin 3 përkufizon rolin e Departamentit të Mirëqenies Sociale rreth përgjegjësisë gjatë drejtimit dhe mbikëqyrjes së të gjitha funksioneve operacionale në bazë të LSHSF-së.²⁰ Sa i përket menaxhimit dhe mbikëqyrjes së qendrave komunale për punë sociale, LSHSF-ja përkufizon që personi apo familja e cila konsideron se ka nevojë për mbrojtje sociale gëzon të drejtën që rrethanat e tyre të vlerësohen nga QPS-ja në komunën ku e kanë vendbanimin apo në të cilën gjinden. QPS-të duhet t'i marrin parasysh nevojat e klientëve dhe resurset e pranishme për ofrimin e shërbimeve të duhura të mbrojtjes sociale.²¹ Neni 2 ia ngarkon Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale edhe "përgjegjësinë e përgjithshme për organizimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare në Kosovë".

Përderisa LMS-ja nuk i adreson në mënyrë specifike problemet e dhunës familjare dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës familjare, LSHSF-ja i përkufizon ato si një grup i posaçëm që kërkon mbrojtje sociale²². Zakonisht në rastet e dhunës në familje ekzistojnë faktorë shtesë që duhet trajtuar lidhur me sigurinë personale të viktimës. Nuk është e pazakonshme për gratë që të largohen nga shtëpitë e tyre për shkak të pasigurisë dhe për trajnim pas incidentit të dhunës në familje. Neni 31 i LMS-së spikat të drejtën e çdo personi, i cili, ka nevojë për mbrojtje sociale që të ketë qasje në një vend të sigurt. Për këtë arsye zyrtari social është i obliguar që të gjejë shërbimin për viktimën sipas nevojës.

Përfundimisht, ajo që duhet t'i paraprijë çdo vendimi që merret në një rast të dhunës familjare është pëlqimi i viktimës. Neni 36 i LMS-së deklaron se "mbrojtja sociale i jepet një personi (klienti) me kërkesë të tij/saj ... [apo] pëlqimin e tij apo saj [apo] personi i cili është pjesërisht apo plotësisht i privuar nga aftësia e tij për punë, mbrojtja i jepet me kërkesë ... apo pëlqimin e përfaqësuesit të tij/saj ligjor" në interes të personit dhe bashkësisë shoqërore apo nëse interesi i palës së tretë ekziston. Mund të ndodhë që viktimat të refuzojë përkrahjen e profesionistëve për shkak të frikës nga hakmarrja që mund të vijë nga keqbërësi dhe ai apo ajo nuk mund të jetë në gjendje të veprojë në dobi të fëmijëve. Në këtë rast ZSHS mund të përcaktojë vetë nëse është në interesin më të mirë të viktimës (dhe fëmijës) që të ofrojë mbrojtje sociale pavarësisht nga pëlqimi. Megjithatë kështu mund të veprohet vetëm në rastet më ekstreme kur fëmijët janë të rrezikuar fizikisht apo ekziston ndonjë shkelje e rëndë e së drejtës së individit për jetë private apo jetë familjare.

Është përgjegjësi e ZSHS-së të sigurojë që viktimat të kuptojë se çfarë lloji i mbrojtjes është në dispozicion dhe gjithashtu të japë pëlqimin që të pranojë mbrojtjen, dhe, kur rrethanat janë mjaft të rrezikshme për viktimën apo personin tjetër të ofrojë ndihmë pa pëlqim.

1. Ndihma sociale për viktimat e dhunës familjare - Ligji për skemën e ndihmës sociale

Lloji i ndihmës sociale që kërkohet nga ZSHS-ja përcaktohet me Ligjin mbi Skemën e Ndihmës Sociale (LSNS) të Kosovës, Ligji i Kuvendit të Kosovës Nr. 2003 /15²³. Sipas preambulës qëllimi i ligjit është që të ofrojë një siguri sociale brenda kontekstit të gjerë të sistemit të mbrojtjes sociale të Kosovës dhe lehtësimi i pronës duke ofruar ndihmë sociale për familjet e varfëria dhe me nevoja të rrezikuara. QPS-ve u është caktuar që të administrojnë skemën e ndihmës sociale dhe të ofrojnë

²⁰ Shih nenin 3 të LSHSF, roli i Departamentit të Mirëqenies Sociale, paragrafi 3.3, pikat (a), (b), (c), (d), (e), (f), (g), (h), (i), (j), (k).

²¹ Shih LSHSF, neni 1 paragrafi 1.4.

²² Shih nenin 10 pika 1. të LSHSF-së

²³ Rregullorja e UNMIK-ut mbi shpalljen e ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës mbi skemën e ndihmës sociale në Kosovë.

mbështetje financiare për familjet që kanë të drejtë për këtë në pajtim me kriteret e parashikuara me ligj.²⁴ Është me rëndësi që skema e ndihmës sociale të zbatohet në mënyrë jo-diskriminuese. Kështu, në një situatë kur një grua largohet nga familja për shkak të dhunës familjare, rekomandohet që ZSHS-ja të përkujdeset për rrezikueshmërinë e gruas nga të gjitha aspektet. MPMS-ja (nenin 12 të LSNS) mund të ofrojë një përkrahjeje të menjëhershme materiale për të plotësuar nevojat e jashtëzakonshme që nuk parashihen fare me LSNS. Në një gjendje të tillë, një rast i dhunës familjare mund të cilësohet me nevoja emergjente. Është përgjegjësi e QPS-së si organ i caktuar që të vlerësojë dhe administrojë ofrimin e një përkrahjeje të tillë për personat në raste emergjente.

3.3.2. Ligji mbi Martesën dhe Marrëdhëniet Familjare (LMMF)

Organi i Kujdestarisë buron nga LMMF-ja²⁵. Funkcionet e OK-së për mbrojtjen sociale të familjeve kryhen nga organi komunal që është përgjegjës për ofrimin e mbrojtjes sociale (p.sh QPS). LSHSF-ja në nenin 7.2. plotëson LMMF-në duke elaboruar që “Qendra për Punë Sociale përbën organin e kujdestarisë dhe kryen detyrat që kërkohen nga ky funksion siç parashihet me ligjet përkatëse të Kosovës.” Përgjegjësitë e posaçme të ZSHS-ve në bazë të LMMF-së ndaj dhunës familjare janë të trefishta. Njëpërmjet funksionit të vet si OK, ZSHS-ja: a) mund të mbikëqyrë të drejtat prindërore²⁶, b) mund të veprojë si përfaqësues ligjor i fëmijës kur ai është i rrezikuar seriozisht²⁷, dhe c) mund t’i rekomandojë Gjykatës Komunale që të nisë procedurën për heqjen e përkohshme të të drejtave prindërore.²⁸ LSHSF-ja në nenin 3 paragrafi 3.3 pika (g) specifikon se Departamenti i Mirëqenies Sociale mban përgjegjësinë e drejtpërdrejtë për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me kërkesat që i paraqiten Gjykatës nga Qendrat për punë sociale. Gjithashtu në rastet kur marrëdhënia familjare nuk mund të rivendoset apo nuk konsiderohet si e arritur, gjë që ndodh në shumë raste të dhunës familjare, QPS-ja ia ofron mendimin e vet prej ekspertit Gjykatave Komunale që janë përgjegjëse për shkurorëzimin apo rastet e së drejtës së kujdestarisë.²⁹

LMMF-ja thekson se QPS-ja është e obliguar që t’i hetojë si duhet rrethanat për zhvillimin fizik dhe psikik të fëmijës³⁰ mirëpo fëmija mund të merret vetëm nëse rritja dhe edukimi i tij rrezikohen në mënyrë serioze.³¹ Në zbatimin e këtyre përgjegjësisve ZSHS-ja duhet të marrë parasysh edhe faktin se profilet e viktimave të dhunës familjare zbulojnë sa i janë ekspozuar incidenteteve të izoluara të keqtrajtimit. Rezultati i stresit dhe keqtrajtimit fizik dhe mendor tregon se shëndeti mendor në mesin e grave dhe fëmijëve preket dhe depresioni klinik mund të ndikojë në aftësinë e individit që të funksionojë normalisht.

Duke ditur se gratë në shoqërinë e Kosovës e kanë përgjegjësinë kryesore për kujdesin ndaj fëmijës, një gruaje e cila përjeton dhunë familjare mund t’i zvogëlohet mundësia që të ofrojë një nivel të kënaqshëm të kujdesit për fëmijët e saj. Një gjë e tillë duhet të hetohet, mirëpo vëmendja duhet t’u kushtohet fëmijëve në familjet ku DHF ka ndodhur dhe duhet të kemi kujdes që të mos dalim me përfundime të gabuara. Në thelb, neni 339 dhe 343 dhe 345 të LMMF-së parashohin ofrimin e mbështetjes gjatë procesit të pajtimit ndërmjet bashkëshortëve. Brenga qëndron në faktin se vendosja e gruas në një mjedis ku bëhet këshillimi i çiftit bashkëshortor mund të mos parandalojë DHF-në dhe ajo mund të përsëritet. QPS-ja duhet të bëjë një vlerësim të nevojave të viktimës dhe fëmijëve të tij/saj përfshirë vlerësimin e rrezikut të mjedisit para se të ndërmerret çfarëdo kthimi i tij apo i saj në shtëpi nëse përkrah përgjegjësinë e tij në bazë të nenit 34 të LMS-së. Më tutje, kur QPS-ja e përcjell një viktimë në OJQ-në gjegjëse për këshillim prej specialisti apo për strehim, ende ruan detyrimin për aktivitete përcjellëse dhe për të monitoruar përparimin e ndryshimeve që mund të ndikojnë në fëmijët e tij apo saj.³²

²⁴ Reg. UNMIK 2003/28, neni 3.

²⁵ OK gjendet gjithashtu në nenin 22 të Ligjit mbi Familjen dhe Marrëdhëniet Familjare (Gazeta Zyrtare 10/84), dhe neni 5 i Ligjit të procedurës jashtëkontestimore, OK 86 (LNCP). OK duhet të marrë të gjitha veprimet për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e të miturve.

²⁶ LFMR neni 118.

²⁷ LFMR neni 122.

²⁸ LFMR neni 126.

²⁹ LFMR neni 111 dhe 339.

³⁰ LFMR neni 116.

³¹ Shih shënimin si më lart 28.

³² Duke marrë parasysh se QPS-të kanë përgjegjësi të përgjithshme në bazë të LMS-së dhe LMMF-së ndaj viktimave dhe familjeve të viktimave; kjo përfshin përcaktimin se ç’farë lloje të mbrojtjeve nevojiten në rast të ndryshimit të rrethanave sikur në nenin 37 të LMS-së.

3.3.3. Rregullorja e UNMIK-ut 2003/12 për mbrojtjen nga dhuna familjare (Rregullorja e DHF-së)

Rregullorja e DHF-së është burimi kryesor ligjor që qeveris me përgjigjen ndaj viktimave të dhunës familjare dhe për këtë arsye është e rëndësishme për ZSHS-të që të kuptojnë në mënyrë të plotë përkufizimet në kuadër të ligjit dhe procedurave të përgjigjes. LMS-ja, LMMF-ja dhe LSHSF-ja janë ligje që i japin ZSHS-ve autoritet dhe përgjegjësi për kujdesin ndaj viktimave të DHF-së në kuadër të familjes dhe rregullorja e DHF-së është legjislacion që ofron detaje se si një mbështetje e tillë duhet të ofrohet. Rregullorja e DHF-së mbulon dy tema kryesore: 1) Urdhëresat për mbrojtje 2) Përgjigjen e organeve për zbatimin e ligjit dhe të ndjekjes.

1. Urdhëresat për mbrojtje

Dhuna në familje përkufizohet si cilido nga aktet që kryhen në kontekstin e “marrëdhënies familjare” si: shkaktimi i lëndimit trupor, aktet seksuale që kryhen pa pëlqim të palës tjetër shkaktimi i frikës për mirëqenie fizike, emocionale apo ekonomike, kidnapimi, shkaktimi i dëmit pronëso- juridik, kufizimi i paligjshëm i lirisë së lëvizjes së personit tjetër, hyrja me dhunë në pronën e personit tjetër, heqja me dhunë e personit tjetër nga vendbanimi tjetër, ndalimi i personit tjetër për të hyrë apo lëshuar vendbanimin e përbashkët apo çfarëdo forme e sjelljes me qëllim të degradimit të personit tjetër³³. Një marrëdhënie familjare ekziston kur dy persona janë të fejuar, martuar, bashkëjetojnë, apo kanë një familje të përbashkët apo janë të lidhur ndërmjet veti me gjak, martesë, apo adoptim apo janë në marrëdhënie të kujdestarisë njëri me tjetrin³⁴. Këto përkufizime zbatohen me qëllim që gjykatat të lëshojnë urdhëresat për mbrojtje (kjo gjë do të shpjegohet më pas). Ekziston një përkufizim tjetër i DHF-së që vlen për veprat penale të cilat do të shqyrtohen më pastaj në pjesën që vijon.

Për qëllime të urdhëresave për mbrojtje, ky përkufizim është veçanërisht i rëndësishëm që ZSHS-ja ta kuptojë atë plotësisht. Duke marrë parasysh rolin tuaj me ligjin ekzistues që është ofrimi i ndihmës dhe mbrojtja e familjeve dhe viktimave në bazë të LMS-së dhe LMMF-së, kuptimi i përkufizimit ligjor të DHF-së mund të ndihmojë gjatë marrjes së vendimit përkitazi me gjendjen e viktimës për nevojën speciale të saj. Përkufizimi është gjithashtu i rëndësishëm në mënyrë që ZSHS-ja të mund t’ia paraqesë kërkesën gjykatës me lloje të ndryshme të urdhëresave (nënvizuar në paragrafin e ardhshëm) dhe së këndejmi nga ata kërkohet që t’i dinë kushtet që duhet të plotësohen gjatë paraqitjes së një kërkesë të tillë. Urdhëresat për mbrojtje nxirren sipas kushteve të lartpërmendura në kuadër të përkufizimit.

Ekzistojnë tri lloje të ndryshme të urdhëresave për mbrojtje që parashihen në rregulloren e DHF-së, urdhëresat e rregullta për mbrojtje, urdhëresat për mbrojtje emergjente dhe urdhëresat për mbrojtje të përkohshme emergjente.

Procedura e kërkesës dhe e lëshimit të urdhëresave për mbrojtje

Një viktimë e dhunës familjare apo përfaqësuesit e tij/saj ligjorë mund të paraqesin kërkesë për urdhëresë për mbrojtje (UM). Kërkesa mund t’i paraqitet me shkrim apo me gojë³⁵ gjykatave komunale që janë kompetente në komunat ku paraqitësi i kërkesës e ka vendbanimin e përhershëm ose të përkohshëm³⁶, pastaj gjykata duhet të marrë vendim për të lëshuar urdhëresën brenda 15 ditëve³⁷.

Me qëllim të mbrojtjes së viktimës³⁸, Gjykata mund të urdhërojë marrjen e këtyre masave:

Urdhëresa për mbrojtje mund:

- (a) T’ia ndalojë të pandehurit të mos kryejë ose të mos kërcënojë se do të kryejë ndonjë veprë të dhunës në familje ndaj palës së mbrojtur apo personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare;
- (b) T’ia ndalojë të pandehurit që të mos e trazojë, të mos e ngacmojë, të mos kontaktojë apo të mos komunikojë drejtpërdrejt a tërthorazi me palën e mbrojtur ose me personin me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare;

³³ Rregullorja e UNMIK-ut 2003/12 mbi mbrojtjen nga dhuna familjare, neni 1.2.

³⁴ Reg. e UNMIK-ut 2003/12, neni 1.1.

³⁵ Reg. e UNMIK-ut 2003/12, neni 6.3.

³⁶ Reg. e UNMIK-ut 2003/12, neni 5.1.

³⁷ Reg. e UNMIK-ut 2003/12, neni 7.1.

³⁸ Reg. e UNMIK-ut 2003/12, neni 2.1.

- (c) T'ia ndalojë të pandehurit që të mos i afrohet brenda një largësie të caktuar palës së mbrojtur ose personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare;
- (d) T'ia ndalojë të pandehurit qëndrimin në vendin e punës së palës së mbrojtur ose në ndonjë vend të caktuar;
- (e) T'ia kufizojë të pandehurit që të mos takohet me fëmijën e palës së mbrojtur sipas kushteve të cilat mund të jenë të përshtatshme;
- (f) T'ia ndalojë të pandehurit hyrjen ose qëndrimin në banesën e përkohshme a të përhershme të palës së mbrojtur, ose në ndonjë pjesë të saj, pavarësisht nga të drejtat pronësore apo të drejtat e banimit të të pandehurit;
- (g) Të urdhërojë ndonjë person të autorizuar që ta shoqërojë palën e mbrojtur ose të pandehurin deri në banesën e palës së mbrojtur dhe të mbikëqyrë largimin e pasurisë personale që i takon atij personi apo ndonjë personi tjetër të caktuar;
- (h) Të urdhërojë konfiskimin e armëve (siç është përcaktuar me Rregulloren nr. 2001/7 të UNMIK-ut të datës 21 shkurt 2001 për Autorizimin e posedimit të armëve në Kosovë), duke përfshirë edhe armët e gjuetisë dhe ato të rekreacionit;
- (i) Ta urdhërojë të pandehurin që të lejojë palën e mbrojtur të shfrytëzojë banesën të cilën e përdorin së bashku i pandehuri dhe pala e mbrojtur ose ndonjë pjesë të saj;
- (j) Ta urdhërojë të pandehurin që të paguajë qiranë ose hipotekën e banesës së përkohshme a të përhershme të palës së mbrojtur ose të paguajë alimentacionin për palën e mbrojtur dhe për ndonjë fëmijë për të cilin i pandehuri ka obligim ta mbajë;
- (k) Ta urdhërojë palën e mbrojtur që t'i kthehet fëmija;
- 4
- (l) T'ia japë palës së mbrojtur kujdestarinë e përkohshme për fëmijën e palës së mbrojtur;
- (m) T'ia ndalojë të pandehurit ose palës së mbrojtur shitjen e çfarëdo pasurie brenda një periudhe të përkohshme ose të caktuar;
- (n) T'ia mundësojë palës së mbrojtur që vetëm ajo ta posedojë dhe ta shfrytëzojë pasurinë e caktuar personale të palës së mbrojtur;
- (o) Ta urdhërojë komisarin e policisë që të pezullojë ose të tërheqë lejen për armëmbajtje të lëshuar në bazë të Rregullores nr. 2001/7 të UNMIK-ut të datës 21 shkurt 2001 për autorizimin e posedimit të armëve në Kosovë ose
- (p) Të caktojë ndonjë masë tjetër që është e domosdoshme për të mbrojtur sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur apo të personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare.

Ankesa kundër vendimit mbi kërkesën për urdhëresën për mbrojtje ose kundër vendimit për vërtetimin e urdhëresës për mbrojtje emergjente duhet të parashtrohet brenda tetë (8) ditëve nga dita kur është lëshuar urdhëresa³⁹

Urdhëresat për mbrojtje emergjente

Urdhëresat për mbrojtje emergjentë (UME) ofrojnë një mjet më të shpejtë por të përkohshëm juridik për viktimat e dhunës familjare. Dallimet në procedurën dhe kërkesat e ankesës janë përshkruar si vijon. Krahas viktimës apo përfaqësuesit ligjor të saj, edhe personat e tjerë mund të paraqesin kërkesë për urdhër mbrojtje emergjente, si: personi me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare, përfaqësuesi i qendrës për punë sociale në komunën ku banon përherë ose përkohësisht pala e mbrojtur, personi i cili është në dijeni të drejtpërdrejtë për një vepër ose më shumë vepra të dhunës në familje ndaj palës së mbrojtur.⁴⁰

Për të lëshuar një UME gjykata duhet të konstatojë, krahas kërkesave për lëshimin e UM, se i pandehuri paraqet kërcënim të drejtpërdrejtë dhe të pashmangshëm për sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur dhe personi me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare dhe se ai duhet të mbrohet me anë të urdhëresës për mbrojtje⁴¹. Gjykata vendos përkitazi me

³⁹ Rregullorja e UNMIK-ut 2003/12, neni 11.

⁴⁰ Reg.e UNMIK-ut 2003/12, Neni 6.2 DV.

⁴¹ Reg.e UNMIK-ut 2003/12, Neni 10.1.

kërkesën për mbrojtje emergjente brenda njëzet e katër (24) orëve pas parashtrimit të kërkesës.⁴² UME-ja mund të përmbajë masat e numëruara në nenin 2.1 prej (a) deri në (h) të rregullores së DHF-së së lartë shënuar.

Urdhëresat për mbrojtje të përkohshme emergjente

Komandanti kujdestar ose ushtruesi i detyrës së komandantit të njësitit rajonal të policisë së UNMIK-ut për dhunë në familje mund të lëshojë urdhëresën për mbrojtje të përkohshme emergjente, jashtë orarit të punës së gjykatës.⁴³ Jashtë orarit të punës së gjykatave, kërkesa për këtë urdhëresë mund t'i paraqitet organeve të zbatimit të ligjit (policisë)⁴⁴. Nuk ekziston ndonjë afat kohor i përcaktuar për komandantin rajonal të njësitit për dhunë familjare kur do të lëshojë një UMPE. Sidoqoftë masat merren si një zgjidhje e përkohshme e menjëhershme jashtë orarit të punës së gjykatave dhe së këndejmi një vendim i menjëhershëm duhet të pritet.

Vetëm masat e parapara me nenin 2.1 (a) në (c) të Rregullores së DHF-së mund të ofrohen nëpërmjet të UMPE-së⁴⁵. Urdhri vlen deri në fund të ditës së ardhshme gjatë të cilës gjykata punon⁴⁶. Për të lëshuar një UMPE, komandanti i njësitit rajonal të dhunës familjare duhet të gjejë të njëjtat kushte ekzistuese për një UME që përputhen me ato që u paraqitën më lart⁴⁷

Një kopje e UME-së dhe UMPE-së duhet t'i dërgohet QPS-së. Nuk ka gjasa që QPS-ja të mos ketë njohuri për ndonjë rast të dhunës familjare në kohën kur UM-ja të jetë kërkuar. Nëse viktimja është e moshës nën tetëmbëdhjetë vjeçe (18) ose nuk ka zotësi të plotë juridike, apo kur veprat e dhunës në familje janë aq të rënda sa ndikojnë në qetësinë a sigurinë e personit të moshës nën tetëmbëdhjetë vjeçe (18), ose që nuk ka aftësi të plotë juridike dhe jeton në banesën e njëjtë, organet e zbatimit të ligjit duhet të raportojnë për rastin menjëherë në Qendrën për Punë Sociale të komunës ku jeton ai person përherë ose përkohësisht.⁴⁸

Nëse ZSHS-ja vëren se një person ka kryer ndonjë rast nga veprat e parashkruara në nenin 1.2 të Rregullores së DHF-së dhe ai person është i lidhur me viktimitë siç parashihet në nenin 1.1, atëherë ai duhet t'ia ofrojë viktimitë mundësinë që të paraqesë kërkesën për urdhëresë për mbrojtje në dobi të viktimitë.

2) Sanksionet penale dhe zbatimi i ligjit

Zyrtarët e shërbimeve sociale duhet të kenë dijeni për dallimin ndërmjet DHF-së siç parashihet me nenin 1.2 për qëllime të urdhëresave për mbrojtje, dhe DHF-së siç parashihet me ligjin penal. Përkufizimi sipas nenin 1.2 përfshin të gjitha veprat që paraqesin dhunë familjare por që nuk i takojnë ligjit penal prandaj nuk janë vepra penale. Megjithatë në shumë raste këto vepra gjithashtu paraqesin vepra penale në bazë të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPP)⁴⁹, ndërsa të dyshuarit mund të arrestohen dhe mund të fillojë ndjekja penale. Sipas ligjit penal, dhunë familjare është çdo vepër penale siç parashihet me KPP dhe që kryhet në kontekst të marrëdhënies familjare. Nocioni mbi marrëdhënien familjare për qëllime të ligjit penal përputhet me atë për qëllime të urdhëresave për mbrojtje: "Lidhje familjare" do të thotë lidhja ndërmjet dy personave të cilët janë të fejuar ose të martuar me njëri-tjetrin apo bashkëjetojnë me njëri-tjetrin pa qenë të martuar, të cilët përdorin një shtëpi të përbashkët dhe janë në lidhje gjaku, martesore ose birësimi apo janë në lidhje "kujdestarie."⁵⁰

Zyrtarët e shërbimeve sociale duhet të jenë të vetëdijshëm se juridikisht në të gjitha rastet e DHF-së organet për zbatimin e ligjit do t'i përgjigjen çfarëdo raportimi për kryerjen e veprave apo kërcënimeve për të kryer vepra të dhunës familjare apo shkelje të UM-së apo UME-së pavarësisht

⁴² Reg.e UNMIK-ut 2003/12, Neni 9.1.

⁴³ Reg. UNMIK 2003/12, Neni 13.2.

⁴⁴ Reg. UNMIK 2003/12, Neni 13.1.

⁴⁵ Reg. UNMIK 2003/12, Neni 13.2.

⁴⁶ Reg. UNMIK 2003/12, Neni 13.3(b).

⁴⁷ Reg. UNMIK 2003/12, Neni 13.2.

⁴⁸ Reg. UNMIK 2003/12, Neni 14.5.

⁴⁹ Rregullorja e UNMIK-ut 2003/25. Për shembull shkaktimi i lëndimit trupor është si bazë për urdhrin mbrojtës në bazë të nenit 1.2 të Rregullores së DHF-së ashtu edhe vepër penale e "shkaktimi të lëndimit të lehtë trupor" në bazë të nenit 154(3). Megjithatë "shkaktimi i frikës" apo "angazhimi në një formë të sjelljes me qëllim të degradimit të personit tjetër" nuk janë vepra penale kështuqë kryesit e veprave penale nuk mund të arrestohen për këto vepra mirëpo këto vepra mund të shfrytëzohen që të mbështesin kërkesat për urdhra mbrojtës.

⁵⁰ Rregullorja e UNMIK-ut 2003/12, neni 1.1.

se kush e raporton atë. Policët për këtë arsye janë të detyruar të arrestojnë personin e dyshuar për kryerje të dhunës familjare apo shkelje të UM-së apo UME-së. Duke pasur parasysh këto detyrime policia është rregullisht e përfshirë në intervenimet në dhunën familjare dhe QPS-ja duhet të ketë marrëdhënie të plota pune me drejtuesin e njësitit rajonal të dhunës familjare dhe hetuesit kryesorë të dhunës familjare në secilin stacion policor⁵¹.

3.3.4 Kodi i procedurës penale (KPP) dhe Kodi i përkohshëm i procedurës penale (KPPP)

Në fillim duhet të pranohet se përgjegjësinë parësore për të gjitha viktimat e krimit, veçanërisht për dhunën me bazë gjinore e ka Njësia për Ndihmë dhe Mbrojtje të Viktimave të Departamentit të Drejtësisë, shtylla I. Roli i saj parashihet me Ligjin Penal dhe është përfaqësuese e autorizuar dhe emëruar automatikisht për viktimat e dhunës familjare.⁵²

Në kuadër të KPP-së dhe KPPP-së ekzistojnë një sërë dispozitash që ndërlidhen drejtpërdrejt me krimet e kryera në kontekst të marrëdhënies familjare. Siç është përmendur më lart, dhuna familjare është një veprë penale e përkufizuar edhe me KPP mirëpo që kryhet nga dikush me të cilin viktimja ka marrëdhënie familjare.

Ekziston një numër i veprave penale që lidhen zakonisht me rastet e DHF-së dhe ZSHS-ja duhet të di për to. Nëse një ZSHS është i vetëdijshëm për veprat e DHF-së, ai duhet të ketë parasysh se ka njohuri për kryerjen e veprës penale dhe duhet të veprojë sipas KPP-së. Të gjitha këto krime gjithashtu marrin dënime të larta nëse kryhen në kontekst të marrëdhënies familjare. Më të zakonshmet janë: neni 137(3): Vendosja e skllavërisë, kushteve të ngjashme me skllavërinë dhe punën e detyruar; neni 153(4) Lëndimi i lehtë trupor; neni 154(3) lëndimi i rëndë trupor; neni 160(2) shtrëngimi; neni 161(3) kërcënim; neni 193(3)8) përdhunimi⁵³; neni 195(3)8) sulmi seksual⁵⁴. Ju lutem të vëreni se që nga janari 2003 veprat penale kundër integritetit seksual përfshirë përdhunimin vlejnë për të gjithë personat përfshirë këtu edhe rastet nëse kryesi i veprës është i martuar me viktimën.⁵⁵

KPPP-ja pranon trysinë që i bëhet viktimave të DHF-së nga partnerët e tyre dhe për këtë arsye nuk lejon që prokurori publik të pezullojë ndjekjen penale në bazë të nenit 226 në rastet e dhunës familjare siç mund të bënte në rastet e tjera.⁵⁶ Megjithatë në shumë vepra të ndërlidhura me pronën në bazë të nenit 275 të KPP-së nëse krimi kryhet në kontekst të marrëdhënies familjare viktimja duhet të paraqesë propozim dhe veprat e tilla nuk ndiqen penalisht sipas detyrës zyrtare që në rrethanat si këto një gjë e tillë do të bëhej.

Mekanizmat e rinj mbështetës gjithashtu parashihen me KPP-në dhe KPPP-në dhe sipas tyre viktimat e dhunës familjare do të kenë përfaqësues të autorizuar prej momentit të inicimit të procedurës penale.⁵⁷ Siç është përmendur më parë, këta përfaqësues janë identifikuar si avokues të viktimave nga Njësia për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave pranë Departamentit të Drejtësisë me të cilët ZSHS-të duhet të komunikojnë rregullisht.

QPS-të kanë përgjegjësi t'u ndihmojnë gjithashtu viktimave të DHF-së në kontekst të marrëdhënieve familjare dhe duhet të bashkëpunojnë ngushtë me institucionet e tjera përgjegjëse siç është NjMNV-ja dhe organet për zbatimin e ligjit për të siguruar që të gjitha aspektet e dhunës janë adresuar si duhet.

⁵¹ Këta hetues janë caktuar në bazë të buletinit operacional të policisë së UNMIK-ut 0073 të 29 janarit 2004. Nga çdo stacion kërkohet që të ketë dy oficerë të trajnuar të DHF-së të nga të cilët kërkohet që të përgjigjen në të gjitha rastet e DHF-së 24 orë në mënyrë kujdestare. QPS-të duhet të kenë një listë të oficerëve në komunën e tyre.

⁵² Nenet 81 dhe 82 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Rregullores së UNMIK-ut 2003/26.

⁵³ Dënimi për këtë krim do të jetë më i lartë nëse personi është në marrëdhënie familjare dhe nëse viktimja është ndërmjet moshës 16 dhe 18 vjeçare.

⁵⁴ Si më lart.

⁵⁵ Rregullorja e UNMIK-ut 2003/1 mbi ndryshimin e ligjit të zbatueshëm për veprat penale që përfshijnë dhunë seksuale, neni 1.1(1) në kombinim me paragrafin 4 të preambulës.

⁵⁶ Neni 226 KPPP: "(1) Prokurori publik, me pëlqimin e të dëmtuarit mund të pezullojë ndjekjen për veprë penale

të dënueshme me gjobë ose me burgim deri në tre vjet duke pasur parasysh natyrën, rrethanat dhe rëndësinë e veprës penale dhe të kryerësit, nëse i pandehuri zotohet se do të sillt siç është udhëzuar nga prokurori publik dhe se do t'i përmbushë detyrimet e caktuara që pakësojnë ose mënjanojnë pasojat dëmshme të veprës penale

, ... (5) Në rastet e dhunës familjare ose dhunës seksuale ky nen nuk zbatohet.

..

⁵⁷ Neni 82 i KPPP-së

3.3.5. Ligji për shërbimet sociale dhe familjare

Ky ligj përkufizon shërbimet sociale dhe personat me nevoja si persona që përfitojnë nga mbrojtja sociale. Personi nevojtar mund të jetë çdo person që mund të vijë nga ndonjë familje e çrregulluar, që është i rrezikuar nga shfrytëzimi apo keqtrajtimi ose që ka përjetuar dhunë familjare. Organi i kujdestarisë mbetet në përgjegjësinë territoriale të qendrave komunale për punë sociale⁵⁸. QPS-të janë përgjegjëse për mbrojtjen e viktimave të dhunës familjare në bazë të dispozitës ligjore për mbrojtjen e të rriturve të rrezikuar, neni 13 i LSHSF-së, sipas të cilit këta persona s'mund të kujdesen për veten për shkak se shfrytëzohen apo keqtrajtohen nga të tjerët, QPS-ja e komunës gjegjëse ku personi e ka vendbanimin do të ndërmarrë të gjithë "hapat e nevojshëm për sigurinë e tyre pa vonesë." QPS-ja ka përgjegjësi të kërkojë urdhëresë për mbrojtje emergjente për të garantuar sigurinë e klientit⁵⁹.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Departamenti i Mirëqenies Sociale është përgjegjës për të promovuar një zhvillim koherent dhe zbatim të politikave të mirëqenies sociale në Kosovë. Së këndejmi Departamenti i Mirëqenies Sociale rezervon të drejtën e përcaktimit të natyrës së shërbimeve që duhen ofruar përfituesve që pranojnë këto shërbime. Në rrethanat kur një QPS apo organizatë tjetër e cila ofron shërbime sociale dështon që t'u përmbahet standardeve minimale profesionale siç përcaktohen nga Ministria e Punës dhe Shërbimeve Sociale, Ministria mban përgjegjësinë për ofrimin e shërbimeve të tilla. Instituti i Politikës Sociale mbetet Departament i pavarur në bazë të autoritetit të MPMS-së. Në bazë të nenit 4 të LSHSF-së IPS-ja luan rolin e promovimit të hulumtimit dhe zhvillimit profesional në fushën e shërbimeve sociale.

Sipas LSHSF-së, OJQ-të luajnë një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve sociale viktimave të dhunës familjare. Në Kosovë ka mjaft OJQ të cilat kanë ofruar strehim dhe shërbime të tjera sociale grave apo fëmijëve të tyre që janë viktimat e dhunës familjare. Ligji për shërbimet sociale dhe familjare, në nenin 8 parasheh që OJQ-të mund të vazhdojnë të ofrojnë shërbime sociale, mirëpo duhet të regjistrohen dhe licencohen nga Departamenti i Mirëqenies Sociale dhe të kenë kontratë me QPS-në.

3.4 Mekanizmat ligjorë për zbatimin e vendimeve

Për shkak se ZSHS-të janë përgjegjëse për marrjen e vendimeve në bazë të LSHSF, LMMF, dhe LMS, dhe madje edhe Rregullorja e UNMIK-ut 2003/12 mbi mbrojtjen nga dhuna familjare janë përgjegjës edhe për shfrytëzimin e të gjitha mjeteve në dispozicion që sigurojnë se vendimet e marra dhe veprimet e ndërmarra do të zbatohen në mënyrën më të mirë.

Çdo vendim i QPS-së që merret në bazë të LMMF-së zbatohet sipas "*Ligjit të procedurës përmbartimore*"⁶⁰ (LPP) duke nxjerrë vendime që dalin në pajtim me LMMF-në⁶¹. LPP-ja i parasheh vetëm gjobat dhe nuk flet shumë për procedurat përmbartimore lidhur me fëmijët. LMMF parashohin përmbartimin e dhunshëm të vendimeve⁶², që nënkupton largimin fizik të fëmijës nga njëri prind dhe dorëzimi i tij prindit tjetër.

Shpesh për shkak të kërcënimit, njëri prind i familjes pengon prindin tjetër të gëzojë të drejtën e tij apo të saj në bazë të vendimit të marrë nga QPS-ja. Në rastet e tilla mjetet juridike civile të përshkruara më lart mund të mos jenë të përshtatshme dhe koha që nevojitet për të zbatuar këto vendime nëpërmjet gjykatave mund të nënkuptojë një periudhë kohore tepër të gjatë kështu që fëmija nuk ka mundësi të ketë qasje në prindin tjetër. Në rastet e tilla ZSHS-ja ka nevojë të dijë se pengimi i përmbartimit të vendimit të QPS-së trajtohet si vepër penale në bazë të KPK-së⁶³. Duke pasur njohuri mbi dhunën dhe parandalimin e përmbartimit të vendimit mbi kujdestarinë apo qasjen, oficeri i ZSHS-së së këndejmi është në gjendje të ketë njohuri në lidhje me veprën penale. Nëse ZSHS-ja merr vendim, atëherë ai duhet të jetë në dobi të fëmijës⁶⁴. Mszbatimi i vendimit nuk

⁵⁸ Shih LSHSF, neni 7, paragrafi 7.2.

⁵⁹ Shih Rregullorja e UNMIK-ut 2003/12, neni 6, paragrafi 6.2 pika (d).

⁶⁰ Ligji mbi procedurën përmbartimore (LPP): LU/1369/SE/ED

⁶¹ Neni 373.

⁶² Neni 377 LMMF: "Pasi gjykata të ketë marrë parasysh të gjitha rrethanat e zbatueshme, vendos nëse përmbartimi do të bëhet në formë të gjobës kundër personit që mban fëmijën apo duke e marrë fëmijën nga ai. Nëse qëllimi i përmbartimit nuk mund të arrihet me gjobë, atëherë realizohet duke marrë fëmijën nga personi dhe dhënie e tij prindit"

⁶³ Neni 214 KPK.

⁶⁴ Neni 116 LMMF.

është në interesin më të mirë të fëmijës përderisa në anën tjetër parashihet si vepër penale. Në këto raste ZSHS-ja duhet t'i informojë organet për zbatimin e ligjit me qëllim të zbatimit të plotë të vendimeve. QPS-ja duhet të bashkëpunojë ngushtë me komunat për të krijuar lidhje me oficerët e trajnuar në punën me fëmijët me nevoja të posaçme për të shmangur çfarëdo traume shtesë tek ai. Faza e zbatimit të vendimit është po aq e rëndësishme sa edhe marrja e këtij vendimi prandaj nga ZSHS-të kërkohet që t'i shfrytëzojnë të gjitha mjetet që i kanë për ta realizuar një gjë të tillë.

MËNYRA E MENAXHIMIT TË RASTEVE DHE NDËRHJRJEVE NË RASTET E DHUNËS FAMILJARE

DORACAK PËR NËNPUNËSIT E SHËRBIMEVE SOCIALE

osce

OSCE Mission in Kosovo



Ministria e Shërbimeve Sociale të Kosovës

Prill 2008

4. Mënyra e menaxhimit të rasteve dhe ndërhyrjeve në rastet e dhunës në familje

Qëllimi i përgjithshëm i ndërhyrjes në ndonjë rast të DhF-së është që t'i ndihmohet viktimës së DhF-së për t'u rimëkëmbur dhe të jetë në gjendje të kontrollojë jetën e vet duke i dhënë zemër që të veprojë për të mirën dhe sigurinë e vet. Megjithatë, në kohë të krizës, ndërhyrja bëhet menjëherë duke e zhvendosur viktimën dhe ndonjë anëtar të rrezikuar të familjes në një vend të sigurt me qëllim të parandalimit të ndonjë keqtrajtimi të mëtejshëm dhe që të ndërpriten pasojat e tërthorta të një keqtrajtimi të tillë, p.sh. ndikimi në fëmijë.

Intervenimi profesional në rastet e DhF-së ngarkon ZShS-në që të ndër marrë veprime ndaj viktimës, familjes së viktimës, keqbërësit dhe shoqërisë. Në këto veprime përfshihen:

- detyra e përkujdesjes;
- detyra për të mbrojtur tani dhe për të parandaluar dhunën në të ardhmen;
- detyra për të paralajmëruar;
- detyra për të raportuar.

Një qasje me të cilën zyrtari i shërbimit social mund t'i mbështesë këto detyra dhe të sigurojë shërbime efikase dhe konsekuente është menaxhimi i rasteve. Menaxhimi i rasteve është qasje përgjithësuese që në vete përmban një strukturë organizative të punës me rastet, me gjashtë faza metodike dhe ku hyn një grup i formave të menaxhimit të rasteve për dokumentimin e informacionit dhe të përparimit nëpër këto faza. Kjo është qasje që i trajton çështjet e klientëve që shpesh janë tejet të ndërlikuara dhe që kërkojnë mbështetje jo vetëm nga një, por nga shumë burime për të arritur nivelin e mirëqenies. Menaxhimi i rasteve është metodë dhe proces i punës me klientë në mënyrë individuale, në çifte ose familje nga pika e referimit e deri te përmbyllja e shërbimeve. Kjo kërkon përfshirje dhe partneritet midis të dyja palëve, si të ZShS-së, ashtu edhe të klientit. Kështu identifikohen qëllimet dhe objektivat, pastaj përcaktohen pritjet e qarta lidhur me punën që duhet të realizohet së bashku. Menaxhimi i rasteve kërkon që së pari të shikohen anët e forta të klientit duke i jetësuar ato dhe në fund bëhen përpjekje për të përfituar nga ndihma e ofruar nga të tjerët në kuadër të 'sistemit' të klientit, duke u mbështetur në rrjetet individuale të përkrahjes së familjes, të shokëve dhe komunitetit. Kjo kornizë njih dhe pranon ndihmën e cila mund të gjendet jashtë mjedisit të vetë klientit dhe se është e nevojshme qasja shumë disiplinore që përfshin shërbimet e tjera profesionale drejt përmbushjes së nevojave të klientit.

Duke zbatuar qasjen e menaxhimit të rastit, ZShS-të marrin përsipër rolin e 'drejtuesit të rastit'. ZShS-ja dhe klienti punojnë së bashku duke formuar një pako të veçantë të shërbimeve që përmbushin nevojat specifike të klientit. Drejtuesi i rastit ndihmon këtë proces me anë të identifikimit dhe bashkërendimit të punës lidhur me qëllimet e përcaktuara, grumbullimin dhe përhapjen e informatave dhe ofrimin e shërbimeve. Menaxheri i rastit është pika e caktuar e përgjegjësisë për klientin, e poashtu edhe pika kontaktuese për ofruesit e tjerë të shërbimeve që punojnë me klientin. Prandaj, puna e menaxherit të rastit kërkon zhvillimin dhe mbajtjen e një marrëdhënieje të vazhdueshme dhe reciproke me klientin dhe njëherësh merr rolin e koordinatorit që u përgjigjet ofruesve të tjerë të shërbimeve, në përpjekje për t'i ndihmuar klientit duke u futur kështu në një rrjet të përkrahjes për të rifituar nivelin e stabilitetit dhe/ose për të zvogëluar rrezikshmërinë për jetën e vet.

Derisa ekzistojnë shumë aspekte specifike të rëndësishme që mund të merren parasysh në rastet e dhunës familjare, menaxhimi i rasteve, si një qasje që fokusohet në klientin dhe që merr parasysh tërë spektrin e nevojave të klientit, mund të jetë një kornizë e dobishme me të cilën ZShS-ja ecën hap pas hapi nëpërmjet procesit të dhënies së ndihmës klientëve të DhF-së. Në lidhje me qasjen e menaxhimit të rasteve, kur ZShS-të punojnë me klientë të cilët janë viktimë të DhF-së, në thelb ekzistojnë tri elemente kryesore që një ZShS duhet t'i arrijë: mbrojtja, hetimi dhe përkrahja.

4.1 Korniza e menaxhimit të rastit

- Detyrat operacionalizohen sipas përgjigjes ndaj punës sociale në secilin rast me detyra specifike, si vijon:

- *Referimi i klientit* – grumbullimi i informatave që të fitohet një pasqyrë e plotë e nevojave të klientit (intervistat, mbledhjet, mbledhjet e strategjisë, leximi i dosjeve, etj.)
- *Krijimi i një plani të shërbimit* – shndërrimi i nevojave në qëllime dhe objektiva konkrete dhe reale (plani i mbrojtjes, plani i punës, marrëveshjet, etj.)
- *Zbatimi i një plani të shërbimeve* – të punuarit së bashku për të përkrahur ndryshimin e pritur (vizitat, takimet, puna me klientin, gjetja e burimeve, lidhja e klientit me shërbimet e tjera, etj.)
- *Koordinimi dhe monitorimi i sistemit* – puna në rrjet dhe mbikëqyrja e procesit (takimi me shërbimet e tjera, takimet e rishikimit, koordinimi i punës, etj.)
- *Avokimi për klientë* – vënia në pah e nevojave të klientit para syve të palëve përgjegjëse (gjykatave, policisë, avokatëve të viktimave, shëndetësisë, OJQ-ve, etj.)
- *Shqyrtimi dhe vlerësimi i rasteve* – rishikimi i qëllimeve dhe i objektivave në baza periodike për të vlerësuar nivelin e përparimit, rishikimin e mundshëm të qëllimeve dhe objektivave në bazë të rrethanave të reja ose ndryshimeve domethënëse në jetën e klientit dhe vlerësimi i mbylljes së mundshme të rastit nëse qëllimet dhe objektivat e përcaktuara janë përmbushur duke e zvogëluar vulnerabilitetin e klientit.

Gjatë secilës fazë të rastit të DhF-së, ZShS-ja duhet t'i ketë parasysh të gjitha aspektet e rëndësishme të hetimit, të cilat mund të konsiderohen si pjesë e fazës së vlerësimit të klientit duke zbatuar qasjen e menaxhimit të rastit, dhe ata duhet t'i përfshijnë çështjet e mëposhtme të rëndësishme kur punojnë në çdo rast të DhF-së:

- Aranzhimet e bashkëveprimit me policinë;
- Informatat që duhet të merren nga profesionistët e tjerë;
- Personat që duhet të intervistohen, radhën e tyre, dhe vendin;
- Aranzhimet e mundshme për trajtimet mjekësore;
- Aranzhimet për përkujdesje ndaj klientit në rastet e papritura;
- Aranzhimet për sigurinë personale të personelit, nëse kjo është e nevojshme;
- Korniza kohore dhe aranzhimet e raportimit;
- Data dhe koha e mbledhjes së ardhshme të grupit operativ;
- Udhëheqësit e ekipeve duhet të bëjnë një raport të shkurtër për këtë mbledhje;
- Aranzhimi i mbledhjeve me profesionistë të tjerë dhe informimi i tyre paraprakisht.

Lista e mësipërme është minimumi që duhet bërë, por në secilin rast do të ketë faktorë plotësues që janë të rëndësishëm, e edhe këto duhet të diskutohen gjatë planifikimit të hetimit.

4.2 Planifikimi operativ i menaxhimit të rastit në rastet e DhF-së

Për hir të efikasitetit operativ në rastet e DhF-së, rolet dhe përgjegjësitë e personelit të ndryshëm të përfshirë duhet të përkufizohen qartë, në mënyrë që secili anëtar i personelit të dijë saktësisht përgjegjësinë e vet në hetim, në planin e shërbimit dhe në ofrimin e shërbimeve.

Nëse rasti i përcillet drejtpërsëdrejti Udhëheqësit të Ekipit (UE), ai i cakton dy zyrtarë të shërbimit social për të zhvilluar hetimin. Në kuadër të natyrës së keqtrajtimit të dyshuar ndaj viktimës, duhet t'i kushtohet vëmendje gjinisë së zyrtarit(es) që bën hetimin. Njëri do të caktohet si drejtues i rastit (DR), ndërkaq ZShS-ja i dytë do t'i ofrojë përkrahje DR-së.

ZShS-ja e dytë gjithmonë emërohet nëse rasti është serioz dhe/ose i ndërlikuar (nëse fëmija/fëmijët janë pjesë e viktimizimit, kur ka nevojë të mblidhen më shumë informata, si dëshmitar i të dhënave të grumbulluara, si mbështetje praktike për DR-në që e bën hetimin ose për baraspeshim gjinor gjatë ndërhyrjes).

Në kurrfarë rrethanash, DR-ja ose ZShS-ja e dytë nuk duhet të përfshihet në hetimin e një familjeje me të cilën njihet ose është e lidhur personalisht. Nëse është e nevojshme, duhet të angazhohet personeli nga një QPS tjetër për të mënjanuar ndonjë njëanshmëri ose mundësi për njëanshmëri. Në kushte të caktuara, si p.sh. kur është i përfshirë ndonjë anëtarë i bashkësisë, hetimi mund të

zhvillohet edhe nga personeli i një QPS-je tjetër, që është larg nga zona e atyshme. Nuk është e paarsyeshme që nga policia të kërkohet përcjellja e hetuesit për t'i siguruar mbrojtje. Kjo gjë nuk duhet të anashkalohej si masë e mundshme e sigurisë nga drejtuesit e shërbimeve sociale.

Udhëheqësi i ekipit duhet të mbajë mbledhje me DR-në dhe punëtorin ndihmës me qëllim të planifikimit të hetimit. Mbledhja duhet të mbahet në ditën kur është bërë referimi fillestar. Mbledhja duhet të planifikohet për të siguruar që të merren parasysh të gjitha rreziqet e mundshme për veten dhe individin(ët) të cilët janë identifikuar si dëshmitarë. Me policinë duhet të bëhen kontrollime të përgjithshme të familjes për të përcaktuar ndonjë rrezik të njohur të mundshëm. Natyrisht, ka të ngjarë që policia të përfshihet drejtpërdrejt në fazën e vizitës së parë, nëse dyshohet për ndonjë akt të dhunës.

4.2.1 Qëllimet e ndërhyrjes

Qëllimi parësor i ndërhyrjes për viktimat e DhF-së është ndalja e dhunës së keqbërësit, ndërsa ndalja e dhunës do t'u ofrojë siguri viktimave dhe fëmijëve të tyre. Në thelb janë tri elemente: mbrojtja, hetimi dhe përkrahja, që mund të kuptohen si ndërhyrje, hetim dhe përkrahje e krizës.

ZShS-ja nuk duhet të përpiqet të bëjë pajtimin e çiftit si teknikë e menaxhimit të krizës. Siguria e viktimës duhet të ketë përparësi ndaj të gjitha fazave të tjera gjatë periudhës së krizës. Bashkëpunimi i ngushtë me agjencitë e ofrimit të shërbimeve mbrojtëse (policinë, gjykatat, avokatët për viktimat dhe OJQ-të e specializuara, duke përfshirë ofruesit e strehimit) është tepër i rëndësishëm që viktima të mbetet e sigurt. Ky qëllim ka përparësi krahas ribashkimit të familjes ose zgjidhjes së "çështjeve të marrëdhënieve të tyre", dhe duhet të jetë baza mbi të cilën duhet të merren të gjitha vendimet për trajtimin e keqbërësve.

Ushtruesit e DhF-së duhet të japin llogari për sjellje të dhunshme. Kjo u mbetet gjykatave të gjykojnë pasi që policia të bëjë hetimin e veprës penale të keqbërësit. Natyrisht, dhuna konsiderohet përgjegjësi e individit i cili vendos ta ushtrorë atë. Nëse zyrtari social vëren dhunë, shkalla e përgjegjësisë së tij është të raportojë për të në polici. Ose të sigurohet se viktima e di me kë mund të bisedojë nëse dëshiron të ngrejë padi penale, siç është Njësitë për Mbrojtjen e Viktimave.

Po ashtu, shërbimet për trajtimin e viktimave të DhF-së duhet të bazohen në pohimin se viktimat nuk kontrollojnë, NUK janë përgjegjëse për viktimizimin e tyre dhe duhet të këshillohen se ato nuk duhet ta fajësojnë veten për dhunën që është ushtruar ndaj tyre.

Siguria e personelit që ofron shërbime ndaj DhF-së është prioritet i lartë dhe duhet të merret parasysh gjatë gjithë kohës dhe pas procesit të vlerësimit dhe të trajtimit.

4.2.2 Koordinimi dhe monitorimi i sistemit

Qasja moderne e menaxhimit të rasteve parasheh që disa raste të shërbimeve sociale mund të jenë të ndërlikuara dhe si rrjedhojë klientët do të kërkojnë lloj-lloj shërbimesh me qëllim të plotësimit të nevojave të tyre. Në hartimin e Planit të Shërbimeve, ZShS-ja dhe klienti së bashku i identifikojnë objektivat dhe i shqyrtojnë personat në kuadër të sistemit të klientit, si dhe institucionet sociale, të cilat mund të jenë në gjendje t'i ndihmojnë klientit që t'i përmbushë këto objektiva të deklaruara. Dukuria e DhF-së është shumë e ndërlikuar dhe nuk janë të gjitha shërbimet për viktimat dhe keqbërësit e DhF-së në dispozicion të drejtpërdrejtë nga QPS-ja. Megjithatë, ekzistojnë shërbimet e tjera të komunitetit, siç janë strehimi, përkujdesja shëndetësore, këshillimi dhe format e tjera të përkrahjes, e që të gjitha këto mund të ofrohen nga një numër i OJQ-ve të femrave, të cilat janë të specializuara për trajnime rreth DhF-së. Derisa organizatat e tjera mund t'i ofrojnë këto shërbime, është obligim i DR-ve nga QPS-ja që t'i monitorojnë shërbimet dhe të sigurojnë që shërbimi të jetë në përpjesëtim me nevojat e individit dhe të familjes. Duhet të bëhet rregullisht shqyrtimi i planit të shërbimit ndërmjet ZShS-së dhe klientit që të vlerësohet përparimi dhe të bëhen ndryshimet e nevojshme në qëllime dhe objektiva në përputhje me nevojat dhe gjendjen aktuale të klientit. Kjo duhet të shkruhet në shënimet e rasteve që janë një detyrë shtesë në vazhdim e sipër në raportin e dhunës familjare.

4.2.3 Raportimi vjetor⁶⁵

Detyrë e udhëheqësit të ekipit dhe e ekipit të shërbimeve sociale është që të përpilojnë dhe të raportojnë çdo vit në DMS për të gjitha të dhënat e grumbulluara nga rastet e DhF-së. Në raportin vjetor, ndër të tjera, duhet të përfshihen:

- numri i përgjithshëm i rasteve të pranuar;
- numri i raporteve ose i kërkesave që janë bërë nga viktimat e secilës gjini;
- numri i rasteve të hetuara (policia, numri i krimeve, sa u është dhënë ndihma, sa janë këshilluar, sa prej tyre u është dhënë strehimi (lloji i strehimit, kohëzgjatja, etj...);
- mesatarja e intervalit kohor të reagimit ndaj secilit raport;
- lloji i shërbimeve të ofruara;
- rezultatet e rasteve brenda vitit.

⁶⁵ Me qëllim të grumbullimit të statistikave çdo vit, QPS-ja / ekipi i Shërbimeve Sociale duhet të përpilojë raport vjetor duke përfshirë statistikën. Koordinator i Dhunës në Familje në Divizionin e Shërbimeve Sociale të DMS-së duhet të përpilojë të gjitha të dhënat dhe shifrat që vijnë nga QPS-ja nga të gjitha komunat. Raporti përfundimtar dhe statistikën duhet të hartohen nga Koordinator i Dhunës në Familje.

ZGJIDHJA E RASTEVE INDIVIDUALE

DORACAK PËR NËNPUNËSIT E SHËRBIMEVE SOCIALE



Organization for Security and Co-operation in Europe



Qeveria e Shqipërisë
Ministria e Punëve Sociale dhe Shërbimeve Sociale

Prill 2008

5. Zgjidhja e rasteve individuale

5.1. Shqetësimet fillestare

Me të marrë të[informatës fillestare referuese, Zyrtari për Shërbime Sociale (ZShS) duhet të vlerësojë nëse, në bazë të informatës që e ka momentalisht në dispozicion, ka arsye për iniciimin e hetimeve zyrtare në rastin e dyshuar për Dhunë në Familje (DhF).

- Arsyet përse nuk fillohet me hetime zyrtare në këtë fazë janë:
- Mungesa e informatave të mjaftueshme për marrjen e vendimit;
- Rasti dhe shqetësimi i ngritur nuk i përmbush kriteret, ndonëse nëse ka pretendime të vazhdueshme të kësaj natyre kjo mund të krijojë bazë të mjaftueshme për hetime të mëtejme;
- Viktima e tërheq akuzën e tij/ saj për dhunë familjare, (ngase ndaj viktimave mund të ushtrohet trysni nga familja dhe të tjerët për ta mohuar raportin për DhF, mirëpo ky rast duhet të konsiderohet si i dyshimtë dhe si rast i mundshëm për monitorim nga ZShS-ja).
- Në rastet kur nuk ka bazë për të nisur hetimet, mbase do të ishte e udhës që të kërkohen informata të mëtejme nga profesionistët, të cilët e njohin, si viktimën, ashtu edhe familjen e viktimës: fjala vjen, nga policia, punonjësit profesionalë shëndetësorë dhe mësimdhënësit. Nëse ZShS-ja konsideron se ka bazë për të nisur hetime zyrtare për DhF, atëherë ZShS-ja duhet t'i parashtrijë (adresojë) këto dy pyetje:
- A ka ndonjë indikacion/ provë se krimi vërtet ka gjasa të jetë kryer?
- A mund të jetë viktima drejtpërsëdrejti e rrezikuar nga ndonjë dëmtim serioz?
- Nëse përgjigjja në të dy këto pyetje është po, atëherë ZShS-ja, pa humbur kohë, duhet të këshillohet me Policinë⁶⁶ me qëllim që:
- Të raportojë për krimet e dyshuara;⁶⁷
- Të kërkojë ndihmën e tyre nëse paraqitet nevoja për të vepruar menjëherë;
- T'i bashkërendojë hetimet.

5.2. Kontaktet fillestare me viktimën e DhF-së

Mënyra dhe vendi ku zhvillohet intervista varet nga rrethanat e intervistës fillestare. Kështu , intervista që zhvillohet menjëherë pas sulmit fizik nga keqtrajtuesi dhe që vjen si rezultat i një thirrjeje urgjente dallon nga vizita që punonjësi social ia bën dikujt për të cilin ka dëgjuar se ka qenë viktimë në të shkuarën dhe me rastin e të cilit është duke u marrë ekipi. Kur një gjë e tillë është e mundur, përmbajtja e intervistës duhet të përgatitet paraprakisht nga Drejtuesi i Rastit (DR) , ashtu që ta ketë të qartë se në cilat fusha duhet të përqendrohet dhe në pyetjet nga të cilat kërkon përgjigje. Duhet të bëjmë përpjekje që të mos i përsërisim vizitat e panevojshme, të cilat do të mund të ndikojnë sado pak në traumatizimin e serishëm të viktimës.

Në asnjë mënyrë intervista nuk duhet ta rrezikojë viktimën. Nëse kontakti i parë duhet të bëhet në shtëpi, viktima duhet të jetë vetëm, larg nga sytë dhe veshët e kryesit të veprës dhe nga ndonjë dashamir i tij, i cili mund të ndikojë apo edhe shtrembërojë përgjigjet e saja apo t'i shfrytëzojë informatat e marra për të shkaktuar edhe më shumë dëm. Nëse zhvillohet në zyrat e ndonjë institucioni apo diku tjetër, atëherë ky duhet të jetë një mjedis privat dhe i qetë me derë të mbyllur, ku askush nuk mund të dëgjojë apo të ndërhyjë në mes të bisedës apo ta frikësojë viktimën.

DR-ja fillimisht klientit duhet t'i shtrojë pyetje jo të drejtpërdrejta, jo-kërcënuese dhe me një mirëkuptim të theksuar si fjala vjen:

- A është çdo gjë në rregull në shtëpi?

⁶⁶ Në stacionin e policisë ku ekziston njësia për DhF, rasti duhet t'i raportohet drejtpërsëdrejti Njesisë; ndërsa, në stacionet policore ku njësia për DhF ekziston, atëherë rasti duhet t'i referohet Njesisë Policore për Komunitete.

⁶⁷ Gjyqi mund të lëshojë një urdhëresë urgjente për mbrojtje nëse konstaton se: (a) ka dyshime të bazuara që keqtrajtuesi ka kryer ose është kërcënuar se do të kryejë një akt të DhF, (b) keqtrajtuesi përbën rrezik të drejtpërdrejtë ndaj sigurisë shëndetësore apo mirëqenies së personit, i cili ka marrëdhënie familjare ... (Shih Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2003/12 Për Mbrojtjen ndaj Dhunës Familjare, Seksioni 10: paragrafi 10.1.).

- Si po ndiheni?
- A keni përkrahje të mjaftueshme në shtëpi?
- Pas këtyre pyetjeve, DR vazhdon të parashtojë pyetje më të drejtpërdrejta, më të hollësishme dhe jo-kërcënuese. Kështu, ai do të fillojë të kuptojë, në sajë të disa të dhënave, se çfarë po ndodh:
- Të vërtetojë nëse ekziston apo jo DhF;
- Të vërtetojë përmasat e problemit;
- Të formulojë një ide fillestare se çfarë masash duhet të ndërmerren për ta mbrojtur viktimën.

Kur klienti të jetë i gatshëm t'u përgjigjet pyetjeve të tjera, atëherë do të ketë nevojë për një vlerësim të thellë profesional nga DR-ja me qëllim që të përcaktohet lloji, natyra dhe rrethanat e keqtrajtimit, të cilat mbase mund të jenë të domosdoshme për të mbështetur Urdhëresën për mbrojtje. DR hetues mund të gjejë edhe 'listën e pyetjeve në fund të këtij doracaku në pjesën që mban titullin "Një shënim shtesë për fushat, të cilat duhet të mbulohen gjatë hetimit të rasteve me sulmeve fizike dhe seksuale". Kjo pjesë mund të gjendet në Shtojcën (në fund) e këtij doracaku.

DR-ja apo ZShS-ja nuk duhet në asnjë mënyrë ta detyrojë viktimën që të largohet nga shtëpia apo edhe të marrë vendime me të cilat ajo/ai nuk pajtohen. Në Kosovë aktualisht shërbimet e veçanta afatgjate për viktimat e DhF-së janë në zhvillim e sipër. Së këndejmi, ka të ngjarë që edhe nëse viktima vendos të shkojë në strehimore për një periudhë të caktuar, ajo/ ai prapëseprapë do të detyrohet të kthehet në familje dhe të ballafaqohet me kryesin e veprës përsëri. Viktima duhet të pajtohet plotësisht me planin e përcaktuar dhe me çdo masë që merret përkitazi me rastin e dhunës në familje.

5.3 Raporti për dhunën familjare

DR-ja dhe ZShS-ja, pas paraqitjes së rastit të dhunës familjare, duhet ta përgatisë raportin mbi DhF-në, i cili do të jetë pjesë e dokumentacionit. Raporti për dhunën familjare duhet të shkruhet sipas udhëzimeve të Institutit për Politika Sociale dhe duhet të përfshijë, (por të mos jetë i kufizuar) këto të dhëna:

- Emrin e viktimës ;
- Adresën e viktimës ;
- Marrëdhëniet e palëve;
- Gjininë e palëve;
- Informatën lidhur me nivelin e përgatitjes profesionale dhe shkollore të palëve;
- Orën dhe datën kur është pranuar ankesa;
- Kohën kur DR i ka filluar hetimet lidhur me ankesën;
- Nëse janë përfshirë fëmijët dhe nëse DhF ka ndodhur në prani të fëmijëve;
- Llojin dhe përmasat e keqtrajtimit;
- Numrin dhe llojet e armëve që janë përdorur;
- Datën e hyrjes në fuqi dhe e kushteve të urdhëresës së lëshuar lidhur me palët;⁶⁸
- Çdo të dhënë tjetër që nevojitet për një analizë të plotë të të gjitha rrethanave që kanë shkaktuar incidentin e dhunës familjare.

Raporti fillestar duhet të shkruhet brenda (5) pesë ditëve të punës, mirëpo ideale do të ishte nëse do të shkruhej brenda 24 orëve nga koha kur është pranuar ankesa. Raporti gjithnjë duhet të nënshkruhet nga drejtuesi i rastit.

5.4 Drejtuesi i i rastit/ Plani i shërbimit

Formulimi i Planit të Shërbimit mund të bëhet në disa mënyra. Preokupimi kryesor në të gjitha këto situata është që të mbështetet një individ për të zvogëluar çdo mundësi për vazhdimin e dhunës si dhe të minimizohet çdo faktor tjetër që do të mund ta vinte viktimën apo familjen e viktimës "në rrezik". Në secilin rast plani duhet të bëhet sipas dëshirës së viktimës. Kjo do të kërkojë diskutime të thella të mëtejme lidhur me dinamikën e DhF dhe dëshirat e saj për të

⁶⁸ P.sh.: çdo urdhëresë për mbrojtje të lëshuar nga Gjyqi.

ardhmen. Gjatë përpilimit të një Plani të shërbimeve, DR-ja gjatë bisedës me viktimën do t'i shqyrtojë disa çështje (s' do mend se këtyre mund t'u shtohen edhe çështje të tjera të rëndësishme):

5.5 Strehimi

DR-ja duhet të diskutojë me viktimën mbi disa opsione të ndryshme të sigurisë si:

- Ku mund të qëndrojë ai/ajo⁶⁹?
- A ka ai/ ajo të afërm apo miq tek të cilët mund të qëndrojë?
- Apo mbase klienti ka nevojë të strehohet në njërin nga strehimoret e viktimave, që ekzistojnë në rajonet e Kosovës?
- Në strehimore, DR-ja lipset të jetë aktiv:
- Duke drejtuar aktivisht rastin dhe duke ndihmuar rreth përmirësimit të gjendjes së viktimës dhe duke bashkëpunuar me siguruesin e strehimit;
- Përmes përgatitjes së një plani tok me klientin për përmirësimin e gjendjes së viktimës dhe përmes komunikimit me siguruesin e strehimit lidhur me përparimin rreth përmirësimit të gjendjes së viktimës.

5.6 Urdhëresa për mbrojtje⁷⁰

Kërkesën për urdhëresën për mbrojtjeje, për mbrojtje urgjente, apo për mbrojtje urgjente të përkohshme zyrtari social mund ta kërkojë me shkrim nga QPS -ja.

Në pajtim me Rregulloren 2003/12 mbi dhunën në familje, peticioni për urdhëresë për mbrojtje apo urdhëresë për mbrojtje urgjente duhet të dorëzohet me shkrim apo me gojë dhe duhet të përfshijë këto elemente:

- a) Emrin e gjyqit;
- b) Emrin, adresën dhe profesionin e parashtruesit dhe personit përgjegjës ose të cilitdo përfaqësues gjyqësor;
- c) Emrin (emrat) e personit (personave) që duhet mbrojtur me urdhëresën për mbrojtje apo me urdhëresën për mbrojtje urgjente dhe marrëdhënien e individit (individëve) me parashtruesin dhe personin përgjegjës;
- d) Përshkrimin e qartë të mosmarrëveshjes në fjalë, përfshirë edhe arsyen (arsyet) frikën e parashtruesit se siguria e tij/saj është rrezikuar nga ana e personit përgjegjës;
- e) Një arsye të qartë për masave specifike mbrojtëse të kërkuara; dhe
- f) Kur kjo është e mundur, duhet të jepet edhe dëshmi që përkrahin kërkesën.

5.7. Vlerësimi i rrezikut

Vlerësimi i rrezikut është element thelbësor i planifikimit të sigurisë dhe i planit të shërbimit për klientin në përgjithësi. Të gjitha strategjitë duhet të udhëhiqeshin nga ky vlerësim.

5.8 Planifikimi i sigurisë

Vendosja në strehimore mund të jetë pjesë e masës afatshkurtër që do të largojë përkohësisht viktimën nga vendi i dhunës. Çfarëdo që të jetë vendimi i viktimës, është përgjegjësi e zyrtarit që punon në këtë rast që të sigurojë se viktima ka qenë e përfshirë në planifikimin dhe ndërmarrjen e masave të sigurisë. Planifikimi dhe ndërmarrja e masave të sigurisë përfshin analizën e situatës në shtëpi dhe ndarjen e strategjive për t'u marrë më tutje me situatën. Është e zakonshme që në këtë proces të ketë edhe periudha të diskutimeve të gjata për të përpiluar planin e skenarëve të ndryshme të mundshme dhe gjërave që ajo (viktima) dëshiron t'i bëjë. Referimi të bëhet në shtojcën 5, planifikimi i sigurisë dhe vlerësimi i rrezikut për shembujt e listave dhe deklaratave joformale që mund të përdoren për të ndihmuar dhe përkrahur viktimën për të menduar për sigurinë e saj.

⁶⁹ Sipas rregulloreve të UNMIK-ut 2003/12, Neni 2 Masat pranë urdhrit për mbrojtje ..., paragrafi 2.1 (f), Ndaloje personin përgjegjës të hyjë apo qëndrojë në vendin e banimit të palës së mbrojtur, apo në një pjesë të caktuar, pa marrë parasysh pronën e personit përgjegjës apo të drejtën e banimit.

⁷⁰ Sipas rregulloreve të UNMIK-ut 2003/12 për Mbrojtjen nga dhuna në familje në paragrafin 6, Peticionet për urdhëresën për mbrojtje apo urdhër urgjent për mbrojtje, nën 6.1 (d) përfaqësues i QPS-së në komunën ku pala e mbrojtur banon vazhdimisht apo përkohësisht; sugjerohet që kjo të bëhet me pëlqimin e viktimës, po qe se është e mundur.

5.9. Vlerësimi i mundësisë për vetëvrasje

Kur hetohet ndonjë brengë për shëndetin mental të viktimës rasti duhet t'i referohet zyrtarit social për shëndet mental që punon në Qendrën për Shëndetin Mental (ekziston nga një për secilin rajon), i cili do të ndërmarrë një vlerësim me dikë tjetër që ka njohuri profesionale për të bërë një vlerësim të tillë. Zyrtari që punon në këtë rast duhet të aranzhojë dhe lehtësojë këtë punë. Nëse klienti dëshiron të kthehet në shtëpi, zyrtari duhet të sigurohet se klienti nuk ka shenja se dëshiron të bëjë vetëvrasëse.

5. 10. Qasja në mekanizmat e drejtësisë

Nëse klienti ka nevojë/dëshiron të ketë qasje tek mekanizmat e drejtësisë, atëherë ZSHS duhet të dijë :

- a) Për rolin e saj/tij dhe përfshirjen, afatin kohor dhe ecurinë e procedurave dhe gjendjen e rasteve të tyre, posaçërisht kur kemi të bëjmë me krimet e rënda dhe në rastet kur kërkohen informata të tilla;
- b) Duke lejuar që brengat dhe pikëpamjet e klientit të paraqiten dhe merren parasysh në fazat e duhura të procedurave varësisht nga interesi personal i saj/i tij;
- c) Duke u ofruar asistencë viktimave gjatë tërë procesit gjyqësor.⁷¹

(Kjo mund të bëhet duke e drejtuar viktimën te Njësia për mbrojtje dhe ndihmë viktimave (NJMNV) që vepron në atë rajon).

5. 11. Ndihma materiale

Roli i zyrtarit social është që të riparojë kushtet që ndërlidhen me dhunën në familje dhe t'u mundësojë individit dhe fëmijëve të saj që të rimëkëmbin jetën e tyre brenda familjes, ose jashtë familjes sipas zgjedhjes së saj. Strategjia e përkrahjes duhet të ndërtohet mbi fuqinë e qenësishme të individit, qoftë edhe nëse kjo nuk do të ishte e dukshme në fillim të ndërhyrjes. Për ato gra të cilat nuk janë të arsimuara dhe nuk kanë aftësi të gjenerimit të të ardhurave, përkrahja materiale do të jetë e nevojshme për një kohë më të gjatë.

Në rastet kur vështirësitë financiare janë burim i stresit në njësinë familjare, duhet të mirret parasysh sigurimi i përkrahjes materiale në mënyrë që të zvogëlohet burimi i mundshëm i konfliktit . Kjo nuk duhet të nënkuptohet si miratim apo arsyetim për veprat e keqbërësit, por si mënyrë për të zvogëluar rrezikun e episodeve të mëtejme të dhunës në rast se viktimat vendos të qëndrojnë në të njëjtin mjedis. Përkrahja materiale për viktimën dhe fëmijët e saj mund të jetë afatshkurtër apo afatgjatë.

5. 12. Këshillimi

Këshillimi është aspekt shumë i rëndësishëm i përkrahjes që i ofrohet viktimës së dhunës në familje. Qëllimi i këshillimit është që të ndihmohet viktimat gjatë përballjes me krizën menjëherë pas viktimizimit. Qëllimi është që të ndihmohet klienti për arritjen e mirëqenies dhe mund të jetë këshillim krize menjëherë pas aktit të dhunës në familje apo seanca të vazhdueshme këshillimi derisa klientët janë duke kaluar nëpër cikle të dhunës. Gjithashtu qëllimi i këshillimit është që të fuqizojë viktimën dhe t'i ndihmojë asaj/atij të vendosë për strategjitë afatshkurtra dhe afatgjata të mbrojtjes së vetvetes nga dhuna e mëtuqeshme duke e vënë jetën e saj/tij në një normalitet. Kjo arrihet përmes ZSHS-së apo profesionistëve me përvojë këshillëdhënëse (këshillues, psikologë, psikiatër, pedagogë) të përkushtuar që flasin me klientin; duke u marrë me këtë çështje përmes komunikimit të drejtpërdrejtë.

Klientit i jepet rasti që në rrethana të sigurta dhe të besueshme të shprehë dhe vlerësojë situatën dhe të gjejë zgjidhje të mundshme. Pos kësaj, klienti duhet të këshillohet edhe përmes programeve të ndryshme / organizatave që ofrojnë shërbime të specializuara këshillëdhënëse, posaçërisht për viktimat e dhunës në familje.

- Këshillat për intervenim në kriza;
- Përkrahja emocionale; këshillimi përkrahës individual dhe grupor;
- Këshillimi afatgjatë dhe intervenimi për shëndetin mental si përgjigje ndaj traumës.
- Trajnimi për mbrojtje të viktimës

⁷¹ Koordinimi dhe bashkëpunimi me Avokatët e Viktimave në këtë rast është më shumë se i nevojshëm. Avokatët e Viktimave do të kenë mundësi që në këto raste të ofrojnë më shumë ndihmë profesionale. "Avokat i viktimës" është personi i autorizuar nga autoriteti përkatës për të avokuar për interesin e viktimës si përfaqësues i autorizuar dhe t'i ofrojë mbrojtje dhe asistencë viktimës.

Nëse QPS-ja ka kontraktuar kryerjen e ndonjë shërbimi siç janë këshillimet për ndonjë individ duke përdorur fonde nga QPS-ja apo Departamenti për Punë Sociale, ZSHS-ja do të duhej të përfshihej në mbikëqyrjen dhe vlerësimin e kontraktuesit për mbarëvajtjen e këshillimit.

Duhet të thuhet gjithashtu se viktimat e dhunës në familje shpesh i nënshtrohen një cikli të dhunës në shtëpi, me ç'rast skenat e dhunshme përsëriten. Ndodh që keqtrajtuesi premtan se nuk do të jetë i dhunshëm prapë, apo premtan edhe më shumë dhe kjo shpesh e sjell viktimën në situatë që të vazhdojë të qëndrojë në një marrëdhënie keqtrajtuese për shkak të ndjenjës së fajit, dashurisë apo/edhe për arsye të tjera. Prandaj, shumë viktima qëndrojnë në marrëdhënie të tilla për një kohë ose në mënyrë ciklike largohen nga shtëpia për t'u kthyer disa herë radhazi gjatë një periudhe kohore. Përderisa këshillimi gjatë krizës kryhet për një kohë të shkurtër, këshillimi i vazhdueshëm duhet të paramendohet si shërbim afatmesëm deri në shërbim afatgjatë për viktimën. Shumë shpesh ndodh të organizohen grupet për këshillim të viktimave të keqtrajtimit me të tjerët në pozitë të ngjashme të cilat ndikojnë që ngadalë viktima të fuqizohet për ta lënë marrëdhënien keqtrajtuese, duke marrë guxim nga përpjekjet e viktimave të tjera. Është thelbësore për ZSHS-të dhe të gjithë të tjerët të përfshirë në seancat këshillëdhënëse me viktimat e dhunës në familje që të mos e detyrojnë atë për ta lënë marrëdhënien pa ndonjë plan sigurie siç e kemi diskutuar në artikullin 7.5.5.

5.13 Intervenimet emergjente/ në kohë krizash

Ndodh që nga QPS-ja të kërkohet intervenimi në raste të dhunës në familje pa ndonjë paralajmërim apo me paralajmërim të shkurtër. Është me rëndësi që ka fleksibilitet brenda ekipeve të zyrtarëve socialë gjë që ndodh shpesh. Në këto raste, mund të mos ketë përparim gjatë procesit të intervistës, planifikimit të shërbimit dhe përkrahjes së vazhdueshme. Mund të ketë pak kohë për të planifikuar hulumtimin dhe sugjerohet që intervenimi i mëtejshëm të kryhet ashtu që zyrtari social të diskutojë paraprakisht me liderin e ekipit. Procesi i hetimit do të vazhdojë normalisht siç e kemi dhënë më sipër me caktimin e zyrtarit që do të merret me rastin dhe ndihmësit e tij/saj. Natyrisht që në raste të tilla urgjente duhet përqendruar vëmendjen në sigurinë e zyrtarit social gjithashtu.

Kur viktima përjeton një sulm të dhunshëm, kryesi është objekt i arrestimit të detyrueshëm nga policia që zakonisht do të rezultojë me dërgimin e kryesit në stacionin policor gjatë tërë kohës së ai/ajo është i/e akuzuar. Mirëpo, si rezultat i vlerësimit fillestar të rrethanave që ndërlidhen me dhunën, ende mund të vlerësoni se është në interes të viktimës që të gjendet një përkrahje për strehim, ndihmë psikologjike apo mjekësore. Përveç në rastet kur viktima pamundësohet për shkak të shëndetit të rëndë, mental apo tjetër, ajo mund të largohet në një vend të sigurt po që se pajtohet. Vendi më i përshtatshëm për strehim të përkohshëm është përkrahja e ofruar nga shtëpitë e sigurta për gra që udhëhiqen nga OJQ-të që gjenden nëpër qendra të ndryshme nëpër tërë Kosovën.

UDHËZUES I PUNUAR SIPAS PRAKTIKAVE TË MIRA

DORACAK PËR NËNPUNËSIT E SHËRBIMEVE SOCIALE

osce

OSCE Mission in Kosovo



Ministria e Shërbimeve Sociale të Kosovës

Prill 2008

6. Udhëzues i punuar sipas praktikave të mira

6.1. Çështjet e sigurisë për zyrtarët socialë

Intervenimet duhet të planifikohen kurdo që është e mundur. Mirëpo, duke pasur parasysh natyrën emergjente të ngjarjeve të tilla, është e mundur që zyrtari social t'i referohet rastit të dhunës në familje që është duke vazhduar apo që është në përfundim e sipër.

Këshillat ofrohen bie fjala kështu:

- Gjithmonë informoni dikë se ku jeni duke shkuar dhe në çfarë kohe pritët të ktheheni;
- Sigurohuni, që ua keni dhënë në zyrë numrin e telefonit tuaj celular. Sigurohuni të keni kontura dhe bateri të mbushur. Programoni një kod një shifror për numrin e policisë;
- Mos hyni vetëm vetë në shtëpi;
- Posa të hyni, hetoni rrugët e mundshme për ikje, për ju, viktimën dhe atë, që mund ta përdorë kryesi i krimit.
- Kur jeni në shtëpi/vend të ndonjë ngjarjeje të DHF-së, vini re objektet, të cilat mund të jenë të rrezikshme për ju, apo viktimën. Pozita e objekteve të rënda, siç janë tenxheret, shishet dhe taketuket si dhe thikat, duhet të hetohen dhe të largohen me kujdes apo së paku të vihen në pozitë më pak të dukshme;

Nëse vihet re ky veprim:

- Kurrë mos bëni përpjekje ta bllokoni rrugën për dalje të keqbërësit, ngase ata përpiqen të dalin. Kontrollimi dhe arrestimi është çështje vetëm e policisë.
- Nëse jeni të shqetësuar për sigurinë tuaj, largohuni menjëherë nga vendi i ngjarjes dhe thirreni policinë.

6.2. Mbikëqyrja e rastit

Mbikëqyrja shërben për tri funksione kryesore: mbështetje teknike dhe monitorim të asaj varësisht sa u janë përmbajtur procedurave korrekte; një hapësirë për të menduar në mënyrë kreative mbi intervenimin, që të përkrahet praktika më e mirë; dhe mbështetje për individët e ZSHS-ve të përfshirë.

Rastet e DHF-së mund të jenë jashtëzakonisht shqetësuese. Drejtuesi i Rastit (DR) gjatë hetimit dhe mbështetjes së viktimës mund të dëshmojë për ngjarjet aktuale të mosmarrëveshjeve familjare, t'i vrojtojë pasojat fizike të sulmit të dhunshëm ndaj viktimës siç janë: dëmtimi traumatik dhe informimi për të dhënat shqetësuese të viktimës gjatë intervistës. Ndikimet e thella, për shkak të përfshirjes së këtillë, në rastet kur mund të ketë rritje të nivelit të stresit të ZSHS-së ato nuk duhet të nënvlerësohen. Mbikëqyrja është mjedis i përshtatshëm për zyrtarin hulumtues, që t'i diskutojë emocionet që i janë shfaqur gjatë punës. Stresi është pasojë e 'konsumimit profesional' në mesin e zyrtarëve të shërbimit social. Është obligim i stafit drejtues ta mbështesë stafin e tyre. Është poashtu e pashmangshme për të gjithë zyrtarët socialë të përballen me stresin e vërtetë në mjedisin ku punohet dhe kërkohet ndihma e nevojshme.

6.3. Regjistrimi i të dhënave

Regjistrimi i të dhënave është pjesa thelbësore e drejtimit të mirë të rastit. Nevojat e klientit nuk mund të negcin shkakun i mungesës fatkeqe nga puna e DR-së. Mbajtja e mirë e të dhënave i lë hapësirë zyrtarit tjetër social, që të merret me punën kryesore që nuk mund të presë, siç është Kërkesa për urdhëresë për mbrojtje apo raporti i gjykatës i përdorur nga gjyqtari për vendimin nëse do t'i pranohet apo jo urdhëresa për mbrojtje.

Çdo kontakt me klientin, çfarëdo të jetë ai, me telefon, vizitë apo takim, apo diskutim me ndonjë njeri profesional, që është i përfshirë në rast, duhet të regjistrohet, duke e shënuar datën dhe kohën. Çdo rast kontakti, përmbajtje takimi apo ndonjë veprimi, që do të ketë dalë nga këto kontakte duhet të regjistrohet me një gjuhë të qartë dhe të mos ketë paqartësi.

6.3.1. Konfidencialiteti dhe çështjet private

Në fillim të çdo hetimi DR fillimisht duhet të flasë me klientin për kufizimet dhe kufirin e pranueshëm të konfidencialitetit që ndërlidhjet me kodin e etikës për zyrtarët e shërbimeve sociale.

Gjithashtu, të gjitha informatat e siguruara gjatë hetimit duhet të mbahen në fshehtësi. Nuk do t'i zbulohen askujt, përveç :

- Nëse viktimi ngul këmbë për të mbajtur në fshehtësi të dhënat askush nuk duhet të informohet përderisa viktimi nuk gjendet në rrezik për jetë. Në këto raste, policia gjithmonë është ajo që duhet të informohet; si dhe
- Personat në kuadër të kabinetit (Udhëheqësi i ekipit dhe Departamenti i Mirëqenies Sociale) me interes legjitim apo përgjegjësi lidhur me rastin;
- Personeli tjetër si ai mjekësor, psikologjik, edukativ dhe personeli korrigjues apo agjencia për zbatimin e ligjit me interes legjitim të rastit, gjithnjë bazuar në pëlqimin e viktimës;
- Zyrtarët e autorizuar nga gjykata (d.m.th. prokurori). (Në të gjitha rastet parashihet ndjekje penale publike (siç është rasti me lëndimet e rënda trupore), është obligim i detyrueshëm i stafit, që ta informojë policinë menjëherë për rastin. Në rastet më pak të rënda, varet nga vlerësimi profesional i ZSHS-së, nëse raportohet për rastin në polici apo duhet t'i lihet viktimës të vendosë.)

Në mënyrë, që të sigurohet mbajtja në fshehtësi e rastin, dosja duhet të mbahet në vend të fshehtë dhe të sigurt, larg nga sytë e njerëzve.

Diskutimet me viktimën, brenda ekipit apo me njerëzit e tjerë profesionalë duhet të bëhen në ndonjë vend privat. Rastet nuk duhet të diskutohen në vendet publike, ku të tjerët mund të dëgjojnë dhe të kuptojnë për rastin pa ndonjë arsye.

Nëse ka ndonjë dyshim lidhur me çështjet private ose të mbajtjes në fshehtësi të të dhënave, të klientit, atëherë zyrtarëve të shërbimeve sociale u rikujtohet seksioni 1.07 Konfidencialiteti dhe çështjet private të Kodit të Etikës për zyrtarët e Shërbimeve Sociale, lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale / Instituti për Politikë Sociale.

6.3.2. Marrja me rastet e ndërlikuara

Në rastet kur më shumë se një anëtar i familjes është i përfshirë dhe i prekur nga dhuna në familje, rekomandohet që çdo individ që ka nevojë t'i caktohet një zyrtar i veçantë i shërbimeve sociale. Kjo është posaçërisht e rëndësishme kur kryesi i krimit dihet se ka nevojë për ndihmë shkakut i çështjeve të shëndetit mental si shpërdorimi i substancave apo vështirësitë në të mësuar.

6.4. Aplikimi në gjykata për Urdhëresë për mbrojtje

Kur përpiloni urdhëresën për mbrojtje, përdorni gjuhë të qartë. Të jeni specifik për incidentet. Informatat tuaja do ta pajisin gjykatën me të dhënat e kërkuara për marrjen e vendimit. Ka tregues të qartë për llojin e kriterit që duhet të përmbushet. Jepni hollësi, që përmbushin kriteret e tilla.

6.5. Dhënia e dëshmisë në gjyq

Është e mundur, që mund t'ju parashtrohen pyetje apo të merreni në pyetje rreth Kërkesës për Urdhëresën për mbrojtje urgjente. Ligji mbi shërbimet sociale dhe familjare, si dispozitë mbi këshillin e ekspertëve ndaj gjykatave, neni 14 shpjegon që nga QPS-ja kërkohet që gjykata të dëshmojë në rastet që lidhen me fëmijët apo të rriturit me nevoja në ngjarjet kriminale apo civile. Mund të kërkohet nga QPS-ja të kryejë hetime dhe të ofrojë vlerësim special të rrethanave sociale të personit në fjalë dhe të bëjë rekomandime mbi mirëqenien e saj/tij. Siguroni që jeni të njoftuar me raportin tuaj, dhe mund t'i arsyetoni haptas komentet që i keni bërë. Siguroni, që keni një kopje për ju që të mund t'i referoheni asaj. Poashtu mund të jepni shpjegime dhe vërtetoni ndonjë koment tuajin të bërë. Parapëlqehet, që t'i mbështetni pohimet që mund t'i keni bërë për ndikimet e keqtrajtimit apo dhunës ndaj viktimës me të gjeturat profesionale dhe akademike apo konceptet psikologjike të punës sociale. Siguroni se, nëse veproni ashtu atëherë ju jeni të njoftuar me të dhënat të cilave u referoheni.

6.6. Kryesimi i mbledhjeve

Si institucion kryesor për çështjet që lidhen me mbrojtjen sociale, është obligim për ju ta hulumtoni plotësisht një rast. Kjo do të thotë marrëdhënie me agjenci të tjera, që mund të kenë informata me vlerë përmes kontaktit të tyre me familjen. Konferenca e rastit është e padobishme

për arritjen e perspektivave dhe specializimin profesional të të tjerëve gjatë hulumtimit që përfshin edhe përpilimin e Planit të Shërbimit.

Kryesuesi duhet të ketë parasysh gjëra të rëndësishme gjatë sigurimit dhe të ushtruarit efikas të kësaj pozite si:

- Të bëjë paralajmërim të duhur për mbledhjen;
- Nëse nuk mund t'i mbledhë të gjitha institucionet e rëndësishme në kohën e caktuar, atëherë duhet të ketë parasysh shtyrjen e saj deri në kohë të caktuar, nëse veprimi i tillë nuk shkakton ngecje dramatike të ndonjë ndërhyrjeje të rëndësishme;
- Duhet të jetë i saktë dhe të njëjtën gjë ta kërkojë edhe nga të tjerët. Organizimi i mirë është gjëja parësore;
- Konsultoni të tjerët, që të siguroni njohuri për kohën e tyre. Për ndonjë takim të ngutshëm që mund të kenë ata duhet t'i lejonit ta lëshojnë mbledhjen më herët dhe me këtë rast prej jush pritët të ndryshoni pikat e rendit të ditës dhe t'i përmbushni nevojat e tyre. Gjithashtu ju mund të përfitoni nga pikëpamjet e tyre;
- Mbani rend dite për mbledhje. Diskutoje atë që nga fillimi me të tjerët, që të jeni i sigurt se i shkon për shtati nevojave të të gjithëve. Nëse kjo mënyrë del e përshtatshme, atëherë filloni mbledhjen duke i cekur dhe qëllimet e saj. Mbledhja duhet të jetë e përqendruar në çështjet e parapara. Mos u pajtoni me përfshirjen e ndonjë pike, që konsiderohet të jetë sekondare. Sugjeroni se në mbledhjen e radhës do të diskutohet për atë çështje;
- Përpiquni, që mbledhja të mbetet në binarë dhe përmbajuni kohës, pra ajo duhet të zgjasë aq sa është paracaktuar;
- Nëse mbledhja ngec në arritjen e marrëveshjes së një pike të caktuar, përpiquni të gjeni një zgjidhje të përkohshme, ku do të bëhej plan i veprimit, dhe pastaj të shqyrtohej në mbledhjen vijuese. Mos e lini këtë për ditën e nesërme dhe merreni si vendim të vështirë. Jeta e viktimës mund të varet nga kjo;
- Përfundoni mbledhjen me përmbledhjen rreth çështjeve me të cilat jeni pajtuar;
- Mos dominoni në mbledhje. Ka gjasa të ngjallni mos vullnet tek agjencitë dhe t'i bëni ata të ndihen të mos respektuar. Kërkohej reagim nga agjencitë e shumta për qasjet moderne në punën sociale.

NDËRTIMI I REAGIMIT NDËRINSTITUCIONAL

DORACAK PËR NËNPUNËSIT E SHËRBIMEVE SOCIALE



7. Ndërtimi i reagimit ndërinstitucional

7.1 Parimet e reagimit ndërinstitucional të dhunës në familje

Si u cek në pjesën e parathënies së këtij dokumenti, MPMS-ja e ka të qartë se shërbimet e ofruara viktimave dhe /apo ushtruesve të dhunës humbasin elementin e efektshmërisë kur të jenë siguruar nga agjencitë individuale (të veçanta).

Legjislacioni i tanishëm lidhur me DHF (Rregullorja e UNMIK-ut 2003/12 Mbrojtja kundër Dhunës në Familje), ia ofron rolin e intervenimit në raste të dhunës në familje katër agjencive të njohura me ligj: policisë, gjyqësisë, njësiteve për mbrojtje të viktimave dhe departamentit për mirëqenie sociale. Organizatat dhe agjencitë që ofrojnë shërbime janë të shumta. Aty përfshihen shumë OJQ, të cilat ofrojnë përkrahje psikologjike dhe strehim, pastaj qendrat vendore mjekësore dhe shkollat.

7.2 Forumet për DHF-së

Zgjidhjet efikase për ata që përjetojnë DHF në shoqëri kërkojnë bashkëpunim të mirë midis institucioneve të ndryshme vendore.

Ndërtimi i këtyre bashkëpunimeve kërkon jo vetëm bashkëpunim të ngushtë por edhe mirëkuptim për dallimet që ekzistojnë në mes institucioneve të ndryshme dhe OJQ-ve dhe fokusit të punës së tyre. Vlerësimi i realiteteve operacionale të cilat janë brumi i institucioneve ose OJQ-ve të caktuara, është i domosdoshëm për qasjen e tyre për të kuptuarit dhe mësuar se si mund të përkufizohet hollësisht reagimi ndaj rasteve të veçanta.

Sugjerohet që çdo bashki të ketë forumin ku të gjithë përfaqësuesit mblidhen rregullisht për t'i diskutuar praktikatat e mira dhe çështjet madhore.

Nuk ekziston model standard për forumet e DHF-së apo punën e tyre, por paramendohet që ajo përfshin:

- Ndërlidhjen, bashkërendimin dhe rrjetin;
- Bashkërendimin e shërbimeve vendore;
- Përmirësimin dhe shtimin e shërbimeve vendore, përfshirë këtu edhe financimin e ardhshëm të shtëpive të sigurta dhe qendrat e grave sipas Nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave. Bazuar në Ligjin mbi shërbimet sociale dhe familjare të MPMS-së lejohet lidhja e kontratës me OJQ-të për sigurimin e shërbimeve të veçanta sociale dhe familjare;
- Ndërmarrja e trajnimeve të standardizuara për të gjitha agjencitë, përfshirë edhe ato të cilat mund të kontaktojnë me viktimat, si mjekët dhe mësuesit;
- Angazhimi rreth vetëdijesimit publik;
- Krijimi i metodave të standardizuara të mbledhjes së të dhënave në mënyrë që statistikatat të mund të krahasoheshin.

Anëtarësia e forumit nuk përfshin pjesëmarrjen në konferencat e rasteve individuale meqë kjo mund ta prishte mbajtjen në fshehtësi të të dhënave, por në vend të saj të përcaktohen vendet ku mund të paraqiteshin reagimet strategjike. Këtu, duhet të marrë pjesë personeli që gëzon autoritet dhe që mund të ndikonte në ndryshimin e politikave në organizatat e tyre.

Parashikohet që faza fillestare e ndërlidhjes të jetë tranzicionale kur Forumi do të zhvillojë qasje më të përqendruar në përpunimin e pjesëve të veçanta të punës së mëtejme. Për të qenë me të vërtetë efektiv, forumi duhet të bëjë një hap më përpara se “Zyra e bisedave” dhe puna e shumë agjencive të njihet si mjet përfundimi dhe jo të përfundojë vetë. Punët, si protokollat midis agjencive duhet të bëhen kryesore për përgjegjësitë e ndara të forumit.

Siç është cekur, grupet e mëdha të organizatave të ndryshme mund të kenë mospajtime mendimesh. Forumet e agjencive të ndryshme mund të përfitojnë prej kushteve të punës që krijohen nga përfaqësuesit në vazhdim. Kjo i ndihmon çdo organizatë të kuptojë rolin e vet në diskutime dhe kufijtë e përfshirjes të tij në ndërhyrje.

Pengesë e përbashkët janë përkimet e përgjegjësive që shkojnë drejt pozitave përkrahëse, lufta territoriale apo konflikte interesash. Forumi mund t'u sigurojë mbështetje të gjithëve për të kuptuar kufirin e pjesëmarrjes së tyre.

Natyrisht se, në fillim këto mund të paraqesin pengesë më vete. Zhvillimi i shërbimeve, mbi të gjitha, është evolucion. Forumi duhet të pasqyrojë praktikën e vet dhe njëkohësisht të monitorojë dhe vlerësojë rezultatet si pjesë e rregullt e rishikimeve të punës së vet.

7.3. Puna e madhe në rastet individuale

Shpresohet se rishikimi strategjik i rolit të pjesëmarrësve të ndryshëm do të ndikojë në përmirësime gjatë ofrimit të shërbimeve për viktimat individuale dhe të mbijetuarit e DHF.

Për të mbaruar një punë të tillë kërkohen lidhje të mira të komunikimit midis profesionistëve në nivelin bazë.

Drejtuesit e rastit duhet të mbajnë kontakte të rregullta me personelin e qendrave të grave, refugjatët(shtëpitë e sigurta), policinë dhe njësitet e mbrojtësve të viktimave. Informacioni që ndikon në sigurinë e individëve apo të tjerëve brenda QPS-së duhet të ndahet sipas nevojës së paraqitur. Është praktikë e mirë që kjo të bëhet me pëlqimin e individit, por duhet theksuar se informacioni nuk do të mbahet në fshehtësi nëse të tjerët i vë në rrezik. Prapë, këshillohen të gjithë ZSHS që t'i njohin kushtet e punës dhe protokollet sipas kodit të etikës për zyrtarët e shërbimeve sociale kur vendosin për klientin gjatë ndërhyrjeve të posaçme.

SHTOJCA I PYETJET DHE MJETET E INTERVISTIMIT

DORACAK PËR NËNPUNËSIT E SHËRBIMEVE SOCIALE



Organization for Security and Co-operation in Europe



Ministry of Social Services of Albania

Shtojca I

Mjetet për mbështetjen e ndërhyrjeve dhe vlerësimi i pasojave të rrezikut për viktimat e dhunës në familje

1. Pyetjet për ekzaminim: Memorandum i rajoneve që sigurohet gjatë hetimit të sulmit fizik dhe seksual
2. Cikli i dhunës
3. Cikli i pushtetit/forcës
4. Cikli i barazisë
5. Spiralja e përmirësimit dhe vendimmarrja

Pyetjet për ekzaminim: Të sigurohet memorandum i rajoneve gjatë hetimit të sulmit fizik dhe seksual.

1. E detyron të bëjë seks
2. E detyron të bëjë seks[me objekte
3. E detyron të bëjë seks me kafshë
4. E detyron të bëjë seks me persona të tjerë
5. E detyron të kryejë praktika seksuale që nuk i pëlqejnë asaj
6. Kryen seks me të kur është shumë e dehur/e droguar për të thënë jo
7. Bën seks me të ndërsa ajo fle
8. Ia heq rrobat kundër vullnetit të saj
9. E bën të shfaqet në pornografi përkundër vullnetit të saj
10. E detyron në prostitucion përkundër vullnetit të saj
11. E lë shtatzënë duke ia refuzuar qasjen në mjete kontraceptive
12. E detyron të ndërpresë shtatzëninë
13. E sulmon gjatë shtatzënisë

A ju kanë ndodhur ndonjëra prej këtyre shpesh dhe /apo më saktësisht kohëve të fundit?

Po/Jo

Nëse po, cilat:

- 1.
- 2.
- 3.

1. E gjuan me objekte
2. E përplas për muri apo për ndonjë objekt tjetër
3. E mban të nënshtruar
4. E shqelmon, kafshon apo e pickon
5. E rrah me shuplakë, e godet me duar apo ndonjë objekt
6. Ia zë frymën apo e tund
7. E djeg me cigare, hekur, furrë apo e vë në zjarr
8. E qëllon me grusht
9. Ia fut kokën nën ujë
10. E lidh, ia lidh duart prapa shpine
11. E detyron ta lëndojë veten
12. Ia zë frymën
13. Ia përplas kokën për dysheme apo muri
14. E sulmon me armë

A ju kanë ndodhur ndonjëra prej këtyre shpesh dhe /apo më saktësisht kohëve të fundit?

Po/Jo

Nëse po, cilat:

- 1.
- 2.
- 3.

Taktikat e pushtetit dhe të kontrollit

Taktika 1 – Përdorimi i shtrëngimit dhe kërcënimet

Kurrë Njëherë Shpesh

1. E ka kërcënuar fizikisht apo me dhunë seksuale
2. E ka kërcënuar me vrasje ose ka thënë se dikush tjetër do ta vrasë
3. E ka kërcënuar të dashurin tjetër
4. E ka kërcënuar me vrasje/ lëndim të gruas apo kafshës shtëpiake të fëmijës
5. E ka kërcënuar se do të lëndojë vetveten apo do të bëjë vetëvrasje nëse nuk pajtohet
6. E ka kërcënuar se do ta bëjë ta humbasë punën
7. E ka kërcënuar se do ta raportojë tek autoritetet
8. E ka kërcënuar se do ta dëbojë
9. E ka kërcënuar se do t'i marrë fëmijët
10. E ka kërcënuar me dëbim(përrjashtim) nga familja apo komuniteti
11. Ia ka kërcënuar familjen ose miqtë e saj
12. E ka kërcënuar se do të kthehet dhe do ta lëndojë
13. E ka kërcënuar se do të tregojë për gjërat me të cilat ajo turpërohet prej të tjerëve
14. E ka kërcënuar se do t'ia shkatërrojë pasurinë

A ju ka ndodhur ndonjëra prej këtyre shpesh dhe /apo më saktësisht kohëve të fundit?

Po/Jo

Nëse po, cilat:

- 1.
- 2.
- 3.

1. E ka nënvlerësuar keqtrajtimin
2. E ka nënvlerësuar lëndimin e shkaktuar
3. Ka mohuar se ka ndodhur ndonjë keqtrajtim
4. I ka thënë se askush nuk do t'i besojë
5. E ka fajësuar se ka shkaktuar ose nxitur keqtrajtimin
6. Ka pohuar se ajo e ka kërkuar keqtrajtimin
7. Ka thënë se ajo e ka kërkuar atë kaherë sepse nuk ka thënë jo, ose nuk ka kundërshtuar
8. Ka thënë se ajo ka mundur t'i thotë atij të ndalet
9. Ka thënë se ishte faji i saj që gjendet atje
10. Ka thënë se ajo dëshiron të qëndrojë
11. Ka thënë se ajo e ka tradhtuar ose e ka shtyrë të bëjë këtë gjë

A ju ka ndodhur ndonjëra prej këtyre shpesh dhe /apo më saktësisht kohëve të fundit?

Po/Jo

Nëse po, cilat:

- 1.
- 2.
- 3.

1. E ka frikësuar me shikime, veprime apo gjeste
2. Ka shkatërruar dhe thyer objekte, pasuri të vlefshme personale
3. E ka sharë ose i ka bërtitur
4. Ka mbajtur armë apo i ka vendosur ato në mënyrë kërcënuese
5. Ka ngritur dorën apo objektet sikur po e godet atë
6. Ka vozitur makinën në mënyrë të rrezikshme kur ajo ka qenë aty brenda
7. Ka qenë i dhunshëm me të tjerët si mësim për të
8. Ka treguar ngjarje se si i ka lënduar të tjerët
9. E ka ndjekur pas
10. E ka vëzhguar në shtëpi dhe punë
11. I ka telefonuar dhe e ka bërë të frikësohet
12. I ka frikësuar shumë miqtë ose familjen e saj që të mos e takojnë
13. E ka kërcënuar që të mos i tregojë askujt
14. Ka folur për mënyrat me të cilat do të dëshironte ta lëndonte
15. Ka folur për mënyrat me të cilat do të mund ta lëndonte nëse nuk do t'i nënshtrohej
16. Ka dërguar dhurata të padëshirueshme
17. E ka rikujtuar se ajo nuk ka asnjë të drejtë të qëndrojë në atë vend

A ju ka ndodhur ndonjëra prej këtyre shpesh dhe /apo më saktësisht kohëve të fundit?

Po/Jo

Nëse po, cilat:

- 1.
- 2.
- 3.

1. E ka kërcënuar se do t'ia marrë fëmijët
2. E ka kërcënuar se do ta paraqesë në shërbimin social (mbrojtja e fëmijëve)
3. E ka kërcënuar se do t'i lëndojë fëmijët e saj
4. E ka përdorur kontaktin me fëmijën që ta sulmojë pas ndarjes
5. I ka përdorur fëmijët që të dërgojë porosi kërcënuese dhe manipuluese
6. I ka drejtuar fëmijët kundër saj
7. E ka keqtrajtuar atë në prani të fëmijëve
8. I ka keqtrajtuar fëmijët në prani të saj
9. Ka marrë informata prej fëmijëve
10. I ka trajtuar fëmijët ndryshe
11. I ka bërë fëmijët të mendojnë se nëna e tyre e di lidhur me këtë
12. Incesti (keqtrajtimi seksual)
13. I ka thënë asaj se është nënë e keqe
14. E ka kërcënuar që do t'u tregojë fëmijëve se punon si prostitutë

A ju ka ndodhur ndonjëra prej këtyre shpesh dhe /apo më saktësisht kohëve të fundit?

Po/Jo

Nëse po, cilat:

- 1.
- 2.
- 3.

1. E ka penguar që të takohet me familjen dhe miqtë
2. E ka drejtuar familjen dhe miqtë kundër saj
3. Ka ndërhyrë në lidhjen e saj
4. Ia ka vështirësuar shkuarjen në shkollë/punë/kolegj
5. Vëzhgim xheloz
6. E ka penguar të mësojë gjuhën e vendit
7. Ia ka marrë dokumentet (pasaportën)
8. Ka kontrolluar kohën e saj
9. E ka mbajtur të mbyllur në dhomë apo shtëpi
10. E ka përjashtuar nga komuniteti
11. E ka dërguar në një vend ose qytet tjetër
12. E ka detyruar të punojë gjatë
13. Ia ka ndaluar të hollat për të dalë
14. Ka kontrolluar qasjen në transport dhe informata
15. E ka shoqëruar çdo kund (përfshirë edhe vizitat mjekësore, etj)
16. Ia ka kufizuar lëvizjet
17. Ka matur kohën e mungesës së saj nga shtëpia

A ju ka ndodhur ndonjëra prej këtyre shpesh dhe /apo më saktësisht kohëve të fundit?

Po/Jo

Nëse po, cilat:

- 1.
- 2.
- 3.

1. I ka thënë se është e çmendur
2. E ka bërë të mendojë se ajo është e çmendur
3. E ka etiketuar, e ka nënçmuar
4. E ka luhatur besimin e saj
5. Ndërrim i papritur i disponimit
6. Sjellje e paparashikueshme
7. I ka thënë se ndjenjat apo reagimet ishin të paarsyeshme ose të krisura
8. Ka kritikuar kujdesin e saj ndaj fëmijëve
9. Ka kritikuar punën e saj (të paguar apo në shtëpi)
10. Është mbyllur në vete
11. Ka refuzuar të flasë me të ose nuk e ka përfillur
12. Ka shfaqur ndjenja raciste kundër saj
13. Ka përdorë paaftësitë e saja kundër saj
14. I ka thënë se e keqtrajton sepse e do
15. I ka bërë komente negative lidhur me dukjen ose paaftësinë e saj
16. E ka akuzuar për shkatërrimin e nderit familjar
17. E ka ndaluar që të vizitohet te mjeku ose të mjekohet

A ju ka ndodhur ndonjëra prej këtyre shpesh dhe /apo më saktësisht kohëve të fundit?

Po/Jo

Nëse po, cilat:

- 1.
- 2.
- 3.

1. E ka trajtuar si qytetare të dorës së dytë apo shërbëtore
2. Ka marrë vendime në vend të saj
3. Ka kërkuar që ajo t'i bindet
4. Ka refuzuar t'i ndihmojë në përkuqdesjen ndaj fëmijëve apo të kryejë ndonjë punë shtëpie
5. Ka zbatuar standarde të dyfishta
6. Ia ka bërë të qartë se ai nuk i pëlqen ose respekton femrat
7. Ka zbatuar rregulla të jashtëzakonshme lidhur me rolet gjinore
8. Ka ngul këmbë se meshkujt kanë të drejtë të bëjnë seks sa herë që donë
9. Ka përdorur pozitën e tij superiore në bashkësi apo familje kundër saj

A ju ka ndodhur ndonjëra prej këtyre shpesh dhe /apo më saktësisht kohëve të fundit?

Po/Jo

Nëse po, cilat:

- 1.
- 2.
- 3.

1. E ka ndaluar të punësohet apo të punojë
2. Ia ka marrë të hollat
3. Ka refuzuar t'i japë të holla
4. I ka kërkuar vërtetim për të gjitha shpenzimet
5. E ka detyruar të kërkojë të holla
6. Me paramendim e ka keq informuar për të drejtat e saja
7. I ka refuzuar të dhënat e saja lidhur me gjenden e të ardhurave familjare(financat)
8. E ka detyruar të fitojë të holla për të që t'i mbajë ose shpenzojë
9. Ka marrë borxhe dhe ka pritur që ajo t'i paguajë
10. Ka marrë borxhe në emër të saj
11. Ka refuzuar t'i mbështesë ambiciet dhe pavarësinë ekonomike të saj
12. Ka përdorur të holla në mënyrë që ta bëjë atë të bindur (shpërblim me pajtim)
13. E ka detyruar të kryejë vepra mashtrimi

A ju ka ndodhur ndonjëra prej këtyre shpesh dhe /apo më saktësisht kohëve të fundit?

Po/Jo

Nëse po, cilat:

- 1.
- 2.
- 3.

1. E ka përqeshur
2. E ka keqtrajtuar në prani të të tjerëve
3. E ka nënçmuar në prani të të tjerëve
4. E ka mbyllur brenda
5. E ka lënë natën përjashta dhe /apo të zhveshur
6. Vazhdimisht i ka kritikuar aftësitë e saja
7. Ka thënë gjëra që ai e di se e lëndojnë
8. I ka thënë se është e shëmtuar, e marrë, turp i familjes
9. E ka quajtur lavire/pise/ etj.
10. I ka thënë se asnjë mashkull tjetër s'do ta donte
11. E ka detyruar të bëjë seks me meshkuj të tjerë kundër vullnetit të saj
12. E ka detyruar të shikojë, të pozojë apo të pozojë për pornografi kundër vullnetit të saj
13. Ka përdorur aspekte të identitetit të saj (racë, religjion, paaftësi)si mënyrë të nënvlerësimit të përsëritshëm
14. E ka detyruar të cenojë ligjin që ta vërtetojë dashurinë e saj
15. Grindje me të
16. E ka detyruar të bëjë gjëra për të cilat ajo turpërohet
17. Nuk i ka lejuar hapësirë (të shkojë në tualet, të bëjë dush)
18. E ka detyruar të kërkojë më qëllim që të lëndohet
19. E detyron të thotë se i pëlqen(e do, kënaqet me të)
20. E detyron të bëjë gjëra për të cilat e di se janë seksualisht degraduese
21. Urinon mbi të

A ju ka ndodhur ndonjëra prej këtyre shpesh dhe /apo më saktësisht kohëve të fundit?

Po/Jo

Nëse po, cilat:

- 1.
- 2.
- 3.

1. E ka mashtruar
2. I ka thënë se do të këtë punë të ligjshme pasi të jetë marrë me prostitucion
3. I ka thënë se vetëm dëshiron ta pijë një kafe me të apo të bisedojë me të dhe pastaj e sulmon
4. E ka lutur ta përcjellë me makinë për në shtëpi si mënyrë që t'i afrohet më lehtë
5. I ka premtuar se do të ndryshojë vetëm që të qëndrojë në lidhje me të
6. E ka bërë të besojë se agjencitë zyrtare nuk do ta mbështesin dhe nuk do t'i besojnë
7. Ka trilluar ngjarje që ta arsyetojë keqtrajtimin
8. Ka gënjyer familjen(miqtë, të tjerët).

A ju ka ndodhur ndonjëra prej këtyre shpesh dhe /apo më saktësisht kohëve të fundit?

Po/Jo

Nëse po, cilat:

- 1.
- 2.
- 3.

1. E ka penguar të hajë dhe të pijë
2. E ka penguar të flejë
3. Ia ka mohuar qasjen në trajtim mjekësor
4. E ka penguar të mësojë gjuhën e vendit ku ajo jeton

A ju ka ndodhur ndonjëra prej këtyre shpesh dhe /apo më saktësisht kohëve të fundit?

Po/Jo

Nëse po, cilat:

- 1.
- 2.
- 3.

1. Ka kritikuar trupin e saj dhe mënyrën e bërjes së seksit
2. Ka publikuar fotografi pornografike të saj
3. Ia ka mohuar ndonjë zgjidhje lidhur me klientët që i takon
4. Ia ka mohuar ndonjë zgjidhje lidhur me llojet e seksit që ajo i bën
5. E ka quajtur me emra si “lavire e ndyrë” dhe “pise”
6. Ka insistuar se ai ka të drejtë për seks sipas kërkesës
7. Ka kërkuar apo ngulur këmbë që ta ndryshojë trupin sipas kërkesës së tij
8. Ka kërkuar apo ngulur këmbë që të vishet me rroba të veçanta për të
9. E trajton vetëm si objekt për seks
10. Kurrë nuk ka qenë i interesuar për kënaqësitë e saja seksuale
11. Ka refuzuar të bëjë seks të sigurt
12. Ka pasur afera që ta poshtërojë
13. Ka pritur nga ajo të bëjë seks pasi ta këtë sulmuar fizikisht


A ju ka ndodhur ndonjëra prej këtyre shpesh dhe /apo më saktësisht kohëve të fundit?

Po/Jo

Nëse po, cilat:

- 1.
- 2.
- 3.

Cikli i Dhunës



Cikli i fuqisë dhe i kontrollit



Cikli i barazisë



SHTOJCA II MITET DHE FAKTET MBI DHUNËN NË FAMILJE

DORACAK PËR NËNPUNËSIT E SHËRBIMEVE SOCIALE



Shtojca Dy

Mitet dhe faktet për dhunën në familje

Miti #1 Rrahja është e rrallë.

FAKTI: Dhuna në familje në Kosovë është shumë e zakonshme. Në periudhën korrik 2002 deri më korrik 2003 janë shënuar 743 raste të dhunës në familje që janë raportuara në polici. Sipas një studimi që është bërë nga UNIFEM-i në vitin 2000, 23% të grave të intervistuar kanë thënë se janë rrahur nga partnerët e tyre. Duke e ditur se raportimi i dhunës në familje nuk është kulturë, ky është mbase një vlerësim jo i saktë.

Miti #2 Dhuna në familje ndodh vetëm në familjet e varfra, të paarsimuar, tek minoritetet apo në familjet “jofunksionale”. Ajo nuk i ndodh askujt që unë njoh.

FAKTI: Ekzistojnë mjekë, ministra, psikologë, policë, dhe profesionistë të tjerë që i rrahin partneret e tyre. Dhuna në familje ndodh në familjet dhe lidhjet familjare të pasura, të arsimit dhe të respektuara. Sulmi nga partneri intim është më i mundshëm se sa nga një i huaj.

Miti #3 Dhuna në familje ka të bëjë me çiftet që futen në grindje gjatë fundjavave./ rrehen dhe plotësisht përçajnë fqinjësinë.

FAKTI: Te keqtrajtimit familjare, njëri partner rrah, frikëson, terrorizon tjetrin në vazhdimësi. Nuk është “luftë e ndërsjellë” kur dy persona grushtohen. Në këto raste njëri person mbisundon dhe kontrollon tjetrin.

Miti #4 Problemi nuk qëndron në keqtrajtimin e gruas; por në keqtrajtimin e çiftit. Gratë janë po aq të dhunshme sa edhe meshkujt.

FAKTI: Në më se 95% të dhunës familjare, mashkulli është autor i krimit. Ky fakt na bën shumicën prej nesh të mundimshëm, por është i vërtetë për shkak të shqetësimit. Për t'i dhënë fund dhunës në familje, ne duhet të shqyrtojmë me kujdes pse meshkujt janë zakonisht të dhunshëm në partneritet. Duhet ta shqyrtojmë lejen historike dhe juridike që e kanë meshkujt për të qenë të dhunshëm në përgjithësi dhe të dhunshëm ndaj grave e fëmijëve të tyre në veçanti.

Ekzistojnë raste kur gruaja rrah mashkullin. Rrahjet ndodhin edhe te lesbianet, në lidhjet e meshkujve homoseksualë dhe biseksualë. Të mbijetuarve të keqtrajtitimit në lidhje të tilla duhet t'ua vëmë veshin, sepse situatat e tyre janë të rralla, për shkak se ata janë në një lidhje të përbuzur nga shoqëria, por kjo NUK e bën përvojën e tyre më të pavlefshme apo më pak serioze.

Miti #5 Kur ndodh dhuna në familje, të gjithë anëtarët e familjes janë pjesëmarrës, prandaj të gjithë duhet të ndryshojnë për ta ndaluar dhunën.

FAKTI: Vetëm autori i krimit ka aftësinë për ta ndaluar dhunën. Shumë gra të rrahura bëjnë përpjekje që t'i ndryshojnë sjelljet duke shpresuar se kjo do ta ndalë keqtrajtimin. Kjo nuk funksionon. Ndryshimet në sjelljet e anëtarëve të familjes nuk do të ndikojnë që autori i krimit të heqë dorë nga dhuna.

Miti #6 Autorët e krimit të dhunës në familje janë të sëmurë mentalë.

FAKTI: Një përqindje jashtëzakonisht e vogël e autorëve të krimit janë të sëmurë mentalë. Shumica prej tyre janë tërësisht normalë, magjepsës, bindës, dhe të arsyeshëm. Dallimi kryesor në

mes tyre dhe të tjerëve është se ata përdorin forcën dhe kërcënimin që të kontrollojnë partneret e tyre. Rrahja është zgjidhje e mënyrës së sjelljes.

Miti #7 Dhuna në familje është zakonisht ngjarje e rastit, incident i izoluar.

FAKTI: Dhuna në familje është model, sundim i forcës dhe terrorit. Kur të fillojë dhuna në një lidhje, ajo përshkallëzohet, shpeshtohet dhe, me kalimin e kohës bëhet gjithnjë e më e ashpër. Rrahja nuk është vetëm sulm fizik. Ajo përmban një numër taktikash si: frikësimi, kërcënimi, shpërdorimi ekonomik, keqtrajtimi psikologjik dhe seksual, që përsëriten. Dhuna fizike është vetëm njëra prej atyre taktikave. Ekspertët kanë krahasuar metodat e autorëve të krimit me ato që përdorin terroristët për t'ua ndërruar pikëpamjet pengjeve.

Miti #8 Viktimat e DHF gjithmonë qëndrojnë në lidhje të dhunshme.

FAKTI: Shumë viktime braktisin partnerët e tyre të dhunshëm përgjithmonë dhe pas shumë pengesave arrijnë të ndërtojnë një jetë pa dhunë. Gati të gjitha viktimat largohen, së paku njëherë. Autori i krimit, pasi ta ketë braktisur viktimën ose të jetë përpjekur të largohet, e shton dhunën në mënyrë dramatike, sepse ai ka nevojë të ripohojë kontrollin dhe zotërimin. Viktimat e rrahura janë shpesh aktive dhe qëndrojnë larg rrezikut. Përpjekjet e tyre mund të dështojnë sepse autori i krimit vazhdon t'i sulmojë dhe institucionet refuzojnë t'u ofrojnë mbrojtje të duhur.

Miti #9 Dhuna në familje është çështje private e familjes dhe nuk është punë e institucioneve të Kosovës

FAKTI: Kjo pikëpamje është tërësisht e gabuar. Është obligim i zyrtarëve të policisë t'i hetojnë të gjitha çështjet e konfliktit familjar. Aty ku ka ndodhur dhuna, rregullorja 2003/12 kërkon që gjykatat të ndjekin penalisht autorët e krimit, pavarësisht lidhjeve të tyre me viktimat. Zyrtarët socialë obligohen të hyjnë në procesin e mbrojtjes sociale të gruas dhe fëmijëve të saj të cilët janë keqtrajtuar nga bashkëshorti apo ndonjë anëtarë i familjes me të cilin jetojnë si pjesë a bashkësi familjare.

SHTOJCA III
REGULLORJA E UNMIK-ut
2003/12 MBI MBROJTJEN
KUNDËR DHUNËS
NË FAMILJE

DORACAK PËR NËNPUNËSIT E SHËRBIMEVE SOCIALE



Shtojca Tre

Rregullorja e UNMIK-ut Nr 2003/12 mbi Mbrojtjen kundër dhunës në familje

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission in
Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

UNMIK/RREG/2003/12
7 maj 2003

RREGULLORE NR. 2003/12

MBROJTJA KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në përputhje me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të datës 25 korrik të vitit 1999 mbi Autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Duke marrë parasysh, mes tjerash, Konventën ndërkombëtare mbi të drejtat civile dhe politike, Konventën evropiane mbi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe Konventën ndërkombëtare mbi të drejtat e fëmijëve,

Duke ditur se dhuna në familje, në të gjitha format e saj, nuk mund të tolerohet dhe se duhet të ekzistojë mbrojtja ligjore efektive dhe mekanizmat e ndihmës për viktimat e dhunës në familje,

Me anë të kësaj shpall si vijon:

KAPITULLI I: Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Përkufizimet

Sipas kësaj Rregulloreje:

1.1 “Lidhje familjare” do të thotë lidhja ndërmjet dy personave:

- (a) Të cilët janë të fejuar ose të martuar me njëri-tjetrin apo bashkëjetojnë me njëri-tjetrin pa qenë të martuar;
- (b) Të cilët përdorin një shtëpi të përbashkët dhe janë në lidhje gjaku, martesore ose

birësimi apo janë në lidhje kujdestarie, duke përfshirë prindërit, gjyshërit, fëmijët, nipat, vëllezërit e motrat, hallat e tezet, xhaxhallarët e dajallarët, ose kushërinjtë ose

(c) Të cilët janë prindër të një fëmije të përbashkët.

1.2 “Dhunë në familje” do të thotë një ose më shumë vepra apo lëshime të qëllimshme që i bën një person personit tjetër me të cilin është ose ka qenë në një lidhje familjare si këto:

(a) Shkaktimi i lëndimit trupor;

(b) Marrëdhënia seksuale ose keqtrajtimi seksual pa pëlqim;

(c) Qitja e personit tjetër në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen e tij apo të saj fizike, emocionale dhe ekonomike;

(d) Rrëmbimi;

(e) Shkaktimi i dëmeve pasurore;

(f) Kufizimi i kundërligjshëm i lirisë së lëvizjes ndaj personit tjetër;

(g) Hyrja me dhunë në pronën e personit tjetër;

(h) Largimi me dhunë i personit tjetër nga banesa e përbashkët;

(i) Ndalimi i personit tjetër për të hyrë ose për të dalë nga banesa e përbashkët ose

(j) Përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qëllim të përluljes së personit tjetër.

1.3 “Viktimitë” do të thotë personi i cili i është nënshtruar dhunës në familje të përcaktuar në nenin 1.2.

1.4 “Kërkues” do të thotë personi i cili paraqet kërkesë për urdhërmbrojtje ose urdhër për mbrojtje emergjente.

1.5 “I paditur” do të thotë personi i cili supozohet se ka kryer një vepër ose më shumë vepra të dhunës në familje kundër të cilit kërkohet urdhri për mbrojtje ose urdhri për mbrojtje emergjente.

1.6 “Pala e mbrojtur” do të thotë personi i cili i është nënshtruar dhunës në familje dhe në të mirë të të cilit është kërkuar urdhëri për mbrojtje ose urdhëri për mbrojtje emergjente.

1.7 “Organi për zbatimin e ligjit” do të thotë Policia Civile e Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, e njohur po ashtu si Policia Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara ose Policia e UNMIK-ut dhe Shërbimi Policor i Kosovës.

1.8 “Avokat i viktimës” do të thotë personi i cili është i autorizuar nga organi kompetent për të mbrojtur interesat e viktimës në cilësinë e përfaqësuesit të autorizuar dhe për t’iu siguruar përkrahje dhe ndihmë viktimave.

1.9 “Fëmijë” do të thotë personi i cili nuk i ka mbushur tetëmbëdhjetë (18) vjet.

Neni 2

Masat e urdhëresave për mbrojtje, urdhëresat për mbrojtje emergjente dhe urdhëresat për mbrojtje emergjente të përkohshme

2.1 Urdhëresa për mbrojtje mund:

(a) T'ia ndalojë të pandehurit që mos të kryejë ose të mos kërcënojë se do të kryejë ndonjë vepër të dhunës në familje ndaj palës së mbrojtur apo personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare;

(b) T'ia ndalojë të pandehurit që mos e trazojë, të mos e ngacmojë, të mos kontaktojë apo të komunikojë drejtpërdrejt a tërthorazi me palën e mbrojtur ose me personin me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare;

(c) T'ia ndalojë të pandehurit që mos t'i ofrohet brenda një distance të caktuar palës së mbrojtur ose personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare;

(d) T'ia ndalojë të pandehurit qëndrimin në vendin e punës së palës së mbrojtur ose në ndonjë vend të caktuar;

(e) T'ia kufizojë të pandehurit që të mos takohet me fëmijën e palës së mbrojtur sipas kushteve të cilat mund të jenë të përshtatshme;

(f) T'ia ndalojë të pandehurit hyrjen ose qëndrimin në banesën e përkohshme a të përhershme të palës së mbrojtur, ose në ndonjë pjesë të saj, pavarësisht nga të drejtat pronësore apo të drejtat e banimit të të pandehurit;

(g) Të urdhërojë ndonjë person të autorizuar që ta shoqërojë palën e mbrojtur ose të pandehurin deri në banesën e palës së mbrojtur dhe të mbikëqyrë largimin e pasurisë personale që i takon atij personi apo ndonjë personi tjetër të caktuar;

(h) Të urdhërojë konfiskimin e armëve (siç është përcaktuar me Rregulloren nr. 2001/7 të UNMIK-ut të datës 21 shkurt 2001 për Autorizimin e posedimit të armëve në Kosovë), duke përfshirë edhe armët gjuetisë dhe ato të rekreacionit;

(i) T'i urdhërojë të pandehurit që të lejojë palën e mbrojtur të shfrytëzojë banesën të cilën e përdorin së bashku i pandehuri dhe pala e mbrojtur ose ndonjë pjesë të saj;

(j) T'i urdhërojë të pandehurit që të paguajë qiranë ose hipotekën e banesës së përkohshme a të përhershme të palës së mbrojtur ose të paguajë alimentacionin për palën e mbrojtur dhe për ndonjë fëmijë për të cilin i pandehuri ka obligim për ta mbajtur;

(k) T'i urdhërojë palës së mbrojtur që t'i kthehet fëmija i saj;

(l) T'ia jep palës së mbrojtur kujdestarinë e përkohshme për fëmijën e palës së mbrojtur;

(m) T'ia ndalojë të pandehurit ose palës së mbrojtur shitjen e çfarëdo pasurie brenda një periudhe të përkohshme dhe të caktuar;

(n) T'i munëdojë palës së mbrojtur që vetëm ajo të posedojë dhe të shfrytëzojë pasurinë e caktuar personale të palës së mbrojtur;

(o) T'i urdhërojë komisarit të policisë që të pezullojë ose të tërheqë lejen për armëmbajtje të lëshuar në bazë të Rregullores nr. 2001/7 të UNMIK-ut të datës 21 shkurt 2001 për autorizimin e posedimit të armëve në Kosovë ose

(p) Të caktojë ndonjë masë tjetër që është e domosdoshme për të mbrojtur sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur apo personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare.

2.2 Urdhri për mbrojtje emergjente mund të caktojë një ose më shumë prej masave të përcaktuara në paragrafët (a) – (h) të nenit 2.1.

2.3 Urdhri për mbrojtje të përkohshme emergjente mund të caktojë një ose më shumë nga masat e përcaktuara në paragrafët (a) – (c) të nenit 2.1.

Neni 3

Ndërlidhja me urdhrat tjerë

3.1 Pavarësisht prej ndonjë urdhri tjetër të lëshuar nga gjykata apo ndonjë organ tjetër kompetent, urdhri për mbrojtje, urdhri për mbrojtje emergjente ose urdhri për mbrojtje emergjente të përkohshme mund të lëshohet në përputhje me këtë Rregullore.

3.2 Lëshimi i urdhrin për mbrojtje, urdhrin për mbrojtje emergjente ose urdhrin për mbrojtje emergjente të përkohshme nuk i cenon të drejtat pasurore ose të kujdestarisë së asnjë personi pas skadimit të urdhrin.

Neni 4

Ndihma e përfaqësuesit ligjor

Viktimës dhe të pandehurit mund t'i ndihmojë përfaqësuesi ligjor në të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me urdhrin për mbrojtje, mbrojtjen emergjente ose mbrojtjen e përkohshme emergjente.

KAPITULLI II: Urdhrat për mbrojtje dhe urdhrat për mbrojtje emergjente

Neni 5

Juridiksioni i gjykatës

5.1 Gjkata komunale e cila e ka juridiksionin në komunën ku parashtruesi i kërkesës banon në mënyrë të përhershme ose të përkohshme është gjykatë kompetente për të shqyrtuar kërkesën për urdhër të mbrojtjes ose urdhër të mbrojtjes emergjente dhe për të lëshuar urdhrin.

5.2 Çdo gjykatë komunale është kompetente për të shqyrtuar kërkesën për urdhër të mbrojtjes ose urdhër të mbrojtjes emergjente dhe për të lëshuar urdhrin, nëse gjykata kompetente sipas nenit 5.1 e ka paraqitur kërkesën për urdhër të mbrojtjes ose urdhër të mbrojtjes emergjente në atë gjykatë dhe nëse ajo gjykatë ka juridiksion në komunën në të cilën pala e mbrojtur e ka ndërruar vendbanimin, ka marrë vendqëndrim të përkohshëm apo nëse kjo bartje i shërben interesit më të mirë të palës së mbrojtur.

5.3 Nëse në gjykatën kompetente është parashtruar lutja në bazë të ligjit për familjen dhe marrëdhëniet martesore, ajo gjykatë është kompetente për të shqyrtuar kërkesën për urdhërmbrojtje ose për urdhërmbrojtje emergjente dhe për të lëshuar urdhrin.

5.4 Shqyrtimin e kërkesës për urdhërmbrojtje ose për urdhërmbrojtje emergjente dhe për lëshimin e urdhrin e bën gjykatësi.

5.5 Gjkata e cila e lëshon urdhrin për mbrojtje ose urdhrin për mbrojtje emergjente është kompetente për të vendosur rreth shkeljes së këtij urdhri sipas nenit 15.

Neni 6

Kërkesat për urdhëmbrojtje ose urdhëmbrojtje emergjente

- 6.1 Kërkesën për urdhëmbrojtje mund ta paraqesë:
- (a) Pala e mbrojtur ose
 - (b) Përfaqësuesi ligjor i palës së mbrojtur.
- 6.2 Kërkesën për urdhëmbrojtje emergjente mund ta paraqesë:
- (a) Pala e mbrojtur;
 - (b) Përfaqësuesi ligjor i palës së mbrojtur;
 - (c) Personi me të cilën pala e mbrojtur ka lidhje familjare;
 - (d) Përfaqësuesi i qendrës për punë sociale në komunën ku banon përherë ose opërkohësisht pala e mbrojtur;
 - (e) Personi i cili është në dijeni të drejtpërdrejtë për një vepër ose më shumë vepra të dhunës në familje ndaj palës së mbrojtur ose
 - (f) Avokati i viktimës me pëlqimin e palës së mbrojtur.
- 6.3 Lutja për urdhëmbrojtje ose urdhëmbrojtje emergjente paraqitet me shkrim ose gojarisht sipas ligjit të procedurës kontestimore dhe përfshinë:
- (a) Emrin e gjykatës;
 - (b) Emrin, adresën dhe profesionin e kërkuesit dhe të pandehurit;
 - (c) Emrin dhe adresën e palës së mbrojtur dhe (ose) të personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare me palën e mbrojtur i cili duhet të mbrohet me anë të urdhrorit për mbrojtje ose urdhrorit për mbrojtje emergjente dhe lidhja e person(ave)it të tillë me të pandehurin;
 - (d) Një përshkrim të qartë të materies së kontestit, duke përfshirë arsyen(t) e caktuar se për çka lutësi ka frikë se i pandehuri e ka rrezikuar sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur ose të personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare, i cili duhet të mbrohet me anë të urdhrorit për mbrojtje ose urdhrorit për mbrojtje emergjente;
 - (e) Masat mbrojtëse të posaçme që kërkohen dhe
 - (f) Sipas mundësisë, dëshminë për mbështetjen e kërkesës.
- 6.4 Lutja e urdhrorit për mbrojtje ose urdhrorit për mbrojtje emergjente mund të paraqitet bashkë me kërkesën e parashtruar sipas ligjit mbi familjen dhe marrëdhëniet martesore.
- 6.5 Kërkuesi lirohet nga taksat e gjykatës.
- 6.6 Interesat e kërkuesit duhet t'i përfaqësojë avokati i viktimës, me pëlqimin e tij apo të saj, duke përfshirë edhe procesin gjatë ankesës.
- 6.7 Nëse zbulimi i adresës së përhershme a të përkohshme të kërkuesit të palës së mbrojtur a të personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare, e i cili duhet të mbrohet me anë të urdhrorit

për mbrojtje ose urdhrin për mbrojtje emergjente do ta rrezikonte atë person(a), atëherë mund të merret një masë ose më shumë masa të mëposhtme:

- (a) Kërkesa duhet sigurojë një adresë alternative;
- (b) Adresa tjetër e siguruar në kërkesë duhet të jetë adresa e vetme që paraqitet në dokumentet dhe dosjet publike të gjykatës ose
- (c) Nëse gjykatësi vendos se zbulimi i adresës në dosjet e gjykatës është i domosdoshëm, ato dosje në të cilat shkruhet adresa duhet të jenë të mbyllura.

Neni 7

Shqyrtimi i kërkesave për urdhërmbrojtje

7.1 Gjykata vendos përkitazi me kërkesën për mbrojtje brenda pesëmbëdhjetë ditëve pas pranimin të kërkesës.

7.2 Gjatë shqyrtimit të kërkesës për urdhërmbrojtje, gjykata e mban seancën e dëgjimit në mënyrë që t'i dëgjojë personat në vijim:

- (a) Pala e mbrojtur ose përfaqësuesi i autorizuar;
- (b) I pandehuri ose përfaqësuesi i autorizuar;
- (c) Kërkuesi;
- (d) Përfaqësuesi nga qendra për punë sociale e komunës në të cilën jeton përherë ose përkohësisht personi i përmendur më poshtë në rastin kur:
 - (i) Kërkuesi është i moshës nën tetëmbëdhjetë vjet (18) ose i mungon aftësia juridike ose
 - (ii) Veprat e supozuara të dhunës në familje kanë ndikim në personin i cili është i moshës nën tetëmbëdhjetë vjet (18) ose nuk ka zotësi juridike; dhe
- (e) Dëshmitarë të cilët gjykata i konsideron të domosdoshëm.

7.3 Gjykata i thërret menjëherë personat e përmendur sipas nenit 7.2 në bazë të ligjit për procedurën kontestimore. Nëse thirret përfaqësuesi nga qendra për punë sociale, atëherë gjykata po ashtu kërkon nga ky person që ta paraqesë mendimin e tij me shkrim, duke vlerësuar gjendjen e palës së mbrojtur.

7.4 Dëgjimi bëhet në mungesë të të pandehurit nëse individi është thirrur në mënyrën e duhur dhe nëse lutja është mbështetur me dëshmi të mjaftueshme.

7.5 Lutja konsiderohet si e tërhequr nëse në seancën e dëgjimit nuk paraqiten as pala e mbrojtur e as përfaqësuesi i autorizuar i palës së mbrojtur dhe nëse këta individë janë thirrë në mënyrën e duhur, ndërsa nuk e kanë njoftuar gjykatën për arsyet e mungesës së tyre. Tërheqja e kërkesës nuk parandalon paraqitjen e kërkesës tjetër.

Neni 8

Lëshimi i urdhërave për mbrojtje

8.1 Gjykata e lëshon urdhrin për mbrojtje për të caktuar një ose më shumë prej masave të parapara në nenin 2.1, nëse vërteton se:

(a) Ekzistojnë bazat për të besuar se i pandehuri ka kryer ose është kërcënuar se do të kryejë ndonjë vepër të dhunës në familje dhe

(b) Lëshimi i urdhrin për mbrojtje është i domosdoshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur apo të personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare dhe i cili duhet të mbrohet me anë të urdhrin.

8.2 Pavarësisht se a ekziston apo jo ndonjë procedurë penale kundër të pandehurit, ajo nuk duhet të paragjykojë vendimin për lëshimin e urdhrin për mbrojtje.

8.3 Në urdhrin për mbrojtje duhet të ceket:

(a) Masa e caktuar nga gjykata;

(b) Kohëzgjatja e urdhrin për mbrojtje, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se dymbëdhjetë (12) muaj;

(c) Vërejtja se shkelja e urdhrin për mbrojtje është vepër penale;

(d) Njoftimi për të drejtën e ankesës kundër urdhrin për mbrojtje brenda tetë (8) ditëve prej marrjes së tij dhe

(e) Njoftimi se të pandehurit mund t'i ofrojë ndihmë përfaqësuesi ligjor.

8.4 Urdhri për mbrojtje i lëshuar nga gjykata duhet t'i dërgohet menjëherë të pandehurit në bazë të ligjit për procedurën kontestimore.

8.5 Gjykata u dërgon personave në vijim nga një kopje të urdhrin për mbrojtje brenda njëzet e katër (24) orëve pas lëshimit të tij:

(a) Palës së mbrojtur dhe personave të tjerë emrat e të cilëve janë shënuar në urdhrin për mbrojtje;

(b) Kërkuesit;

(c) Stacionit lokal të policisë në lokalitetin ku jetojnë përherë ose përkohësisht pala e mbrojtur dhe personat tjerë të përmendur në urdhrin për mbrojtje dhe

(d) Qendrës për punë sociale në komunën ku pala e mbrojtur dhe personat tjerë të përmendur në urdhër për mbrojtje jetojnë përherë ose përkohësisht.

8.6 Urdhri për mbrojtje hyn në fuqi menjëherë pas lëshimit nga ana e gjykatës dhe fillon të zbatohet ndaj të pandehurit pasi t'i jetë dorëzuar personalisht atij në bazë të ligjit për procedurën kontestimore.

Neni 9

Shqyrtimi i kërkesave për urdhresa të mbrojtjes emergjente

9.1 Gjykata vendos përkitazi me kërkesën për mbrojtje emergjente brenda njëzet e katër (24) orëve pas parashtrimit të kërkesës.

9.2 Me rastin e shqyrtimit të kërkesës për një urdhërmbrojtje emergjente, gjykata duhet të mbajë një seancë që të dëgjohen personat vijues:

- (a) Pala e mbrojtur ose përfaqësuesi i autorizuar;
- (b) I pandehuri ose përfaqësuesi i autorizuar;
- (c) Këkuesi dhe
- (d) Çfarëdo dëshmitarësh të cilët gjykata i konsideron të domosdoshëm.

9.3 Sipas nevojës, gjykata mund ta bëjë dëgjimin në mungesë të të pandehurit.

9.4 Gjukata i thërret menjëherë personat e përmendur sipas nenit 9.2, konform ligjit mbi procedurën kontestimore.

Neni 10

Lëshimi i urdhrave për mbrojtje

10.1 Gjukata e lëshon urdhrin për mbrojtje për të caktuar një ose më shumë prej masave të parapara në paragrafët (a) – (h) të nenit 2.1 nëse vërteton se:

(a) Ekzistojnë baza për të besuar se i pandehuri ka kryer ose është kërcënuar se do të kryejë ndonjë vepër të dhunës në familje;

(b) I pandehuri paraqet kërcënim të drejtpërdrejtë dhe të pashmangshëm për sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur dhe personi me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare dhe i cili duhet të mbrohet me anë të urdhrin për mbrojtje dhe

(c) Lëshimi i urdhrin për mbrojtje emergjente është i domosdoshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur ose të personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare, e të cilët duhet të mbrohen me anë të urdhrin për mbrojtje.

10.2 Pavarësisht se a ekziston apo jo ndonjë procedurë penale kundër të pandehurit, ajo nuk duhet të paragjykojë vendimin për lëshimin e urdhrin për mbrojtje emergjente.

10.3 Në urdhrin për mbrojtje duhet të ceket:

(a) Masa e caktuar nga gjykata;

(b) Kohëzgjatja e urdhrin për mbrojtje emergjente, e cila skadon në fund të dëgjimit për vërtetimin e urdhrin për mbrojtje emergjente;

(c) Vërejtja se shkelja e urdhrin për mbrojtje emergjente është vepër penale dhe

(d) Data e dëgjimit për vërtetimin e urdhrin për mbrojtje emergjente, e cila duhet të jetë brenda njëzetë (20) ditëve prej lëshimit të urdhrin për mbrojtje emergjente;

(e) Njoftimi se të pandehurit mund t'i ofrojë ndihmë përfaqësuesi ligjor.

10.4 Urdhri për mbrojtje emergjente i lëshuar nga gjykata duhet t'i dërgohet menjëherë të pandehurit në bazë të ligjit për procedurën kontestimore.

10.5 Gjukata u dërgon personave të mëposhtëm nga një kopje të urdhrin për mbrojtje emergjente brenda njëzet e katër (24) orëve pas lëshimit të tij:

]

(a) Palës së mbrojtur dhe personave të tjerë, emrat e të cilëve janë shënuar në urdhrin për mbrojtje emergjente;

(b) Kërkuesit;

(c) Stacionit lokal të policisë në vendin ku pala e mbrojtur dhe personat tjerë të përmendur në urdhër për mbrojtje emergjente jetojnë përherë ose përkohësisht dhe

(d) Qendrës për punë sociale në komunën në të cilën pala e mbrojtur dhe personat tjerë të përmendur në urdhër për mbrojtje emergjente jetojnë përherë ose përkohësisht

10.6 Urdhri për mbrojtje emergjente hyn në fuqi menjëherë pas lëshimit nga ana e gjykatës dhe fillon të zbatohet ndaj të pandehurit pasi t'i jetë dorëzuar personalisht atij në bazë të ligjit mbi procedurën kontestimore.

10.7 Gjatë dëgjimit për vërtetimin e urdhrin për mbrojtje emergjente, gjykata duhet të vazhdojë punën në bazë të nenit 7. Në fund të dëgjimit, gjykata mund:

(a) Të jep urdhër për përfundimin e urdhrin për mbrojtje emergjente ose

(b) Të lëshojë urdhrin për mbrojtje në bazë të nenit 8. Sipas nevojës, ky urdhër për mbrojtje mund t'i ndryshojë kushtet e urdhrin për mbrojtje emergjente.

Neni 11

Ankesat

11.1 Ankesa kundër vendimit përkitazi me kërkesën e urdhrin për mbrojtje ose vendimit për vërtetimin e urdhrin për mbrojtje emergjente duhet të parashtrohet brenda tetë (8) ditëve nga dita kur është lëshuar urdhri.

11.2 Parashtrimi i ankesës nuk e ndalon ekzekutimin e urdhrin për mbrojtje.

Neni 12

Ndryshimi, ndërprerja dhe vazhdimi

12.1 Nëse rrethanat kanë ndryshuar rrënjësisht, pala e mbrojtur ose i pandehuri mund të parashtrijë kërkesë për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrin për mbrojtje.

12.2 Pas marrjes së kërkesës për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrin për mbrojtje, gjykata vazhdon me shqyrtimin e kërkesës në bazë të nenit 7. Në fund të shqyrtimit, gjykata mund:

(a) Të vendosë që urdhri për mbrojtje të mbetet në fuqi;

(b) Të vendosë që urdhri për mbrojtje të ndryshohet, nëse kjo kërkohet nga rrethanat që kanë ndryshuar rrënjësisht ose

(c) Të vendosë që urdhri për mbrojtje të ndërpritet, nëse kriteret e përcaktuara në nenin 8.1 nuk vlejné më për shkak të ndryshimit rrënjësor të rrethanave.

12.3 Parashtrimi i kërkesës për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrin për mbrojtje nuk e pezullon ekzekutimin e urdhrin për mbrojtje.

12.4 Pesëmbëdhjetë (15) ditë para skadimit të urdhrin për mbrojtje, pala e mbrojtur ose përfaqësuesi i autorizuar i tij a i saj mund të parashtrijë kërkesën për vazhdimin e urdhrin për mbrojtje. Nëse nuk parashtrohet lutja për vazhdimin e urdhrin për mbrojtje, ai ndërpritet automatikisht në ditën e skadimit.

12.5 Pas marrjes së kërkesës për vazhdimin e urdhrin për mbrojtje, gjykata vazhdon me shqyrtimin e kërkesës në bazë të nenit 7. Në fund të shqyrtimit, gjykata mund:

- (a) Të vërtetohet ndërprerjen e urdhrin për mbrojtje në datën e skadimit të tij ose
- (b) Të vendosë që të vazhdohet urdhri për mbrojtje, nëse vlejné kriteret e përcaktuara në nenin 8.1

12.6 Përkitazi me urdhërat e lëshuar në bazë të këtij neni do të vlejné nenet 8.4 deri 8.6. Nëse gjykata vendos për ndryshimin ose vazhdimin e urdhrin për mbrojtje në bazë të neneve 12.2(b) ose 12.5(b), do të vlejë po ashtu neni 8.3.

KAPITULLI III: Kompetenca dhe përgjegjësitë e organeve për zbatimin e ligjit

Neni 13

Urdhrat për mbrojtjen e përkohshme emergjente

13.1 Jashtë orarit të punës së gjykatave, kërkesa për urdhër të mbrojtjes së përkohshme emergjente mund t'i paraqitet organeve të zbatimit të ligjit nga:

- (a) Pala e mbrojtur;
- (b) Përfaqësuesi ligjor i palës së mbrojtur;
- (c) Personi me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare;
- (d) Përfaqësuesi i qendrës për punë sociale në komunën ku banon përherë ose

përkohësisht pala e mbrojtur ose

(e) Personi i cili është në dijeni të drejtpërdrejtë për një vepër ose më shumë vepra të dhunës në familje ndaj kërkuesit.

13.2 Komandanti kujdestar ose ushtruesi i detyrës së komandantit të njësitit rajonal të policisë së UNMIK-ut për dhunë në familje mund të lëshojë urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente dhe të caktojë një ose disa prej masave të përmendura në paragrafët (a) – (c) të nenit 2.1 të kësaj Rregulloreje, nëse ai ose ajo vërteton se:

(a) Ekzistojné baza për të besuar se i pandehuri ka kryer ose është kërcënuar se do të kryejë ndonjë vepër të dhunës në familje;

(b) I pandehuri paraqet kërcënim të drejtpërdrejtë dhe të atypëratyshëm për sigurinë, shëndetin a mirëqenien e palës së mbrojtur ose të personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare, të cilët duhet të mbrohen me anë të urdhrin për mbrojtje dhe

(c) Lëshimi i urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente është i domosdoshëm për të siguruar shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur ose të personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare, e që duhet të mbrohen me anë të urdhrin për mbrojtje.

13.3 Në urdhrin për mbrojtje duhet të ceket:

(a) Masa e caktuar nga komandanti kujdestar ose ushtruesi i detyrës së komandantit rajonal të njësitit të policisë së UNMIK-ut për dhunën në familje;

(b) Kohëzgjatja e urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente, e cila skadon në fund të ditës së ardhshme gjatë të cilës gjykata punon;

(c) Vërejtja se shkelja e urdhrin për mbrojtje emergjente të përkohshme është vepër penale dhe

(d) Njoftimi se të pandehurit mund t'i ofrojë ndihmë përfaqësuesi ligjor në procedurën ligjore dhe

(e) Shpjegimi se pas kalimit të afatit për mbrojtje të përkohshme emergjente, pala e mbrojtur mund të paraqesë kërkesë për urdhërmbrojtje emergjente, e cila nëse lejohet, do t'i nënshtrohet mbajtjes së një seance apo paraqitjes së kërkesës për urdhërmbrojtje kundër së cilës mund të bëhet ankesë, nëse lejohet.

13.4 Urdhri për mbrojtje të përkohshme emergjente i lëshuar nga komandanti kujdestar ose ushtruesi i detyrës së komandantit rajonal të njësitit të policisë së UNMIK-ut për dhunën në familje duhet t'i dërgohet menjëherë të pandehurit në pajtim me ligjin e procedurës kontestimore.

13.5 Organet e zbatimit të ligjit u dërgojnë personave në vijim nga një kopje të urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente:

(a) Palës së mbrojtur dhe personave të tjerë, emrat e të cilëve janë shënuar në urdhrin për mbrojtje emergjente;

(b) Kërkuesit;

(c) Stacionit lokal të policisë në lokalitetin ku jetojnë përherë ose përkohësisht pala e mbrojtur dhe personat tjerë të përmendur në urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente;

(d) Qendrës për punë sociale në komunën ku jetojnë përherë ose përkohësisht pala e mbrojtur dhe personat e tjerë të përmendur në urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente dhe

(e) Gjykatës kompetente komunale.

13.6 Urdhri për mbrojtje të përkohshme emergjente hyn në fuqi menjëherë pas lëshimit nga ana e komandantit kujdestar ose ushtruesit të detyrës së komandantit rajonal të njësitit të policisë së UNMIK-ut për dhunë në familje dhe fillon të zbatohet ndaj të pandehurit pasi t'i jetë dorëzuar personalisht atij në bazë të ligjit për procedurën kontestimore.

Neni 14

Përgjegjësitë e organeve për zbatimin e ligjit

14.1 Organet për zbatimin e ligjit duhet t'i përgjigjen secilit njoftim për veprat ose kërcënimet e dhunës në familje ose shkeljes së urdhrin për mbrojtje apo të urdhrin për mbrojtje emergjente pa marrë parasysh se kush e bën njoftimin.

14.2 Nëse ekziston dyshimi i bazuar se është kryer vepra që ka të bëjë me dhunën në familje, organet për zbatimin e rendit e arrestojnë kryerësin e supozuar dhe e paraburgin sipas ligjit të procedurës kontestimore.

14.3 Organet për zbatimin e ligjit përdorin mjetet e arsyeshme për të mbrojtur viktimën dhe për të parandaluar vazhdimin e dhunës, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në:

(a) Informimin e viktimës ose përfaqësuesin ligjor të viktimës për të drejtat e tij në përputhje me këtë Rregullore, por edhe me të drejtën për të kërkuar urdhrin për mbrojtje të përkohshme sipas nenit 13 dhe të drejtat e parapara sipas këtij neni;

(b) Informimin e viktimës lidhur me shërbimet e ndihmës ligjore, psikologjike dhe

ndihmave të tjera në dispozicion nga institucionet qeveritare si dhe prej rrjetit të autorizuar të organizatave joqeveritare të cilat ofrojnë shërbime për viktimat;

(c) Informimin e ofruesve përkatës të shërbimeve të përmendura sipas nenit 14.3(b) lidhur me ndonjë rast të dhunës në familje dhe mundësimin e kontaktit mes ofruesit të shërbimit dhe viktimës me kërkesën e viktimës;

(d) Sigurimin ose aranzhimin e transportimit të viktimës dhe vartësve të saj nëpërmjet një agjencie tjetër deri në objektin e duhur mjekësor për trajtim ose kontrollim mjekësor;

(e) Ofrimin dhe ndihmën e viktimës për ta larguar vetëm pronën e nevojshme personale nëse viktima zgjedh të largohet nga banesa familjare që përdoret bashkarisht;

(f) Sigurimin ose aranzhimin e transportimit të viktimës, e sipas nevojës edhe vartësve të saj nëpërmjet një agjencie tjetër deri në një vendstrehim apo venqëndrim tjetër të përshtatshëm dhe të sigurt, me kërkesën e viktimës;

(g) Nëse paraqitet nevoja, sigurimin e mbrojtjes për atë që ka lajmëruar dhunën në përputhje me obligimet përkatëse ligjore lidhur me mbrojtjen e dëshmitarëve;

(h) Largimin e të pandehurit nga banesa e përhershme ose e përkohshme e palës së mbrojtur apo ndonjë pjese të saj në rastin kur me anë të urdhrit për mbrojtje ose urdhrit për mbrojtje emergjente caktohet masa e paraparë në nenin 2.1(f) ose

(i) Sigurimin e kontaktit zyrtar për viktimën ose përfaqësuesin e saj ligjor me nëpunësin hetues në kuadër të organeve për zbatimin e ligjit nëse kërkohet ndihma e mëtejshme. Nëse mungon nëpunësi hetues, atëherë ndonjë nëpunës tjetër i organeve për zbatimin e ligjit duhet t'i ndihmojë viktimës.

14.4 Organet e zbatimit të ligjit e përpilojnë raportin lidhur me rastin pavarësisht se a është kryer vepra apo jo, a është arrestuar dikush apo jo dhe një kopje të këtij raporti ia japin viktimës ose përfaqësuesit të saj ligjor.

14.5 Nëse viktima është e moshës nën tetëmbëdhjetë vjet (18) ose nuk ka zotësi të plotë juridike, apo kur veprat e dhunës në familje janë aq të rënda sa ndikojnë në qetësinë a sigurinë e personit të moshës nën tetëmbëdhjetë vjet (18), ose që nuk ka aftësi të plotë juridike dhe jeton në banesën e njëjtë, organet e zbatimit të ligjit duhet të raportojnë për rastin menjëherë në qendrën për punë sociale të komunës ku jeton ai person përherë ose përkohësisht.

14.6 Nëse ekziston dyshimi i bazuar se është kryer një veprë që ka të bëjë me dhunën në familje pavarësisht se a është arrestuar kryerësi i supozuar ose është gjetur vendndodhja e tij, organet e zbatimit të ligjit duhet ta njoftojnë rregullisht viktimën apo përfaqësuesin ligjor të viktimës për statusin e hetimeve, duke përfshirë informatat lidhur me vendndodhjen e kryerësit të supozuar ose lirimin e tij a të saj nga burgimi.

KAPITULLI IV: Veprat penale dhe procedurat

Neni 15

Shkelja e urdhrave për mbrojtje, e urdhrave për mbrojtje emergjente dhe urdhrave për mbrojtje të përkohshme emergjente

Kush e shkel në tërësi ose pjesërisht urdhrin për mbrojtje, urdhrin për mbrojtje emergjente ose urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente kryen veprë penale që dënohet me gjobë prej 200 euro deri 2000 euro ose me burgim deri në gjashtë muaj.

Neni 16
